





Abdullah ibn Sebe

mes realitetit dhe imagjinatës

Tiranë, 2018



Abdullah ibn Sebe – mes realitetit dhe imagjinatës

Titulli: Abdullah ibn Sebe - *mes realitetit dhe imagjinatës*

E përktheu: **Haxhi Selim Stafa** (*Allahu e mëshiroftë!*)

Recensent: **Vullnet Merja**

E redaktoi: **Jerida Kulla**

E korrektoi: **Vjollca Karaj**

Përgatiti për shtyp & Kopertina: **Sabrie Feza**

Botoi: **Shoqata "FLLADI"**

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!**

FJALA E QENDRËS

Pa dyshim që prej llojeve të vështirësive më të mëdha, me të cilat janë ndeshur popujt e kombet, në periudhat e fanatizmit e të gjendjeve të rënuara në jetën e tyre, është urrejtja e ndërsjellë ndaj opinioneve ideore e doktrimore. Kjo urrejtje ka arritur majat më të larta, duke prishur baraspeshën e shoqërisë, madje duke paralizuar edhe lëvizjen e saj, sepse, në një shoqëri të tillë, rëndohet shumë gjendja e individëve të shoqërisë, sa arrin kufirin e mendimit të kriminalitetit, që praktikon njëra palë kundër tjetrës, për rrjedhojë “dhuna” bëhet mjeti i vetëm për të nënshtruar të tjerët.

Çdo njeri e ka të lehtë të përfytyrojë se si do të jetë katastrofa në një gjendje të tillë.

Të mposhturit, shumë shpejt, do të pëlqejnë të tërhiqen prapa dhe të hyjnë në një botë, e cila, më e pakta, mund të cilësohet rënie shpirtërore dhe moskokëçarje ndaj vrasësve, kurse triumfuesit bëhen skllevër të forcës së tyre, e cila i drejton ata drejt një bote krenarie e një bote lodhëse, e mbushur me shqetësime e mërzi. Në këtë gjendje, pozicionet mbeten pa burra dhe e gjithë shoqëria s'ka një forcë që ta mbrojë dhe ta çojë drejt tokës së sigurt.

Në këtë rrjedhë hyn edhe çështja e “studimit” dhe e “shikimit” të ngjarjeve të individëve, si dhe e historisë sonë të gjatë islame, si dhe ndjekja e ndikimeve që ata kishin mbi ngjarjet që kanë ndodhur në të kaluarën, pastaj shpallja e rezultateve të studimit, pa i shpjeguar ato qartë e pa i bërë të kuptueshme.

Vetëkuptohet se paraqitja e ngjarjeve, baza e një studimi të këtillë, do të shkaktojë te të tjerët ngurrim, madje edhe zemërimin e tyre. Më pas, prej saj lindin tensione e urrejtje dhe, për rrjedhojë, e gjithë shoqëria, patjetër që do të preket prej rrënimit e bllokimit të veprimtarive.

Por, a do të thotë kjo se duhet të shtetëzohen penat dhe të ndalohej trajtimi i studimeve?

Është e qartë se nuk ka dalë asnjë reformator ose ideolog që të pretendojë këtë mendim. Madje të gjithë ndajnë një fjalë të përbashkët për kryerjen e studimeve historike mbi ngjarjet historike dhe mbi individët që kanë pasur rol në histori. Por ka pasur kundërshtime për këndvështrimin mbi ngjarjet historike.

Pikëpamja e shenjtërisë nuk e pranon trajtimin e ngjarjeve historike, përveçse me fjalë lavdëruese. Të tjerë mendojnë se nuk është e domosdoshme të trajtohet një ngjarje e caktuar, sepse do të pengonim vendosmërinë e reformatorëve. Të tjerë mendojnë se, në studimet historike, të ndiqet parimi i afrimit. Ka edhe të atillë që shprehen se duhet të interesohemi për ndikimet e skllavërisë, që kanë ndodhur në rrugëtimin e ymetit dhe shtojnë se, në këto çështje, nuk do të shihet gjë tjetër veçse një grumbull gabimesh, që ne duhet t'i ndreqim, për shkak të ndikimit që ato kanë, edhe ashtu siç janë, të përgjumura. Prandaj është shumë negative, nëse do t'u hiqet pluhuri që i ka mbuluar.

Natyrisht që ka edhe një opinion optimist, që e merr objektivitetin si mjet për zgjidhjen e kësaj urrejtjeje e kontradikte dhe punon shumë për afrimin e “zemrave” para afrimit të “mendimeve”, duke u nisur prej parimit “të respektimit të tjetrit” dhe përpiqen që pretendimin e tjetrit

ta kundërshtojnë vetëm me argument, nëse ka argument. Ndryshe s'ka asnjë dobi prej asaj që dëshirohet të arrihet.

S'ka asnjë popull e asnjë komb që, në historinë e tij, të mos ketë gabime. Dikush mund të ushqejë iluzione dhe të mendojë se epërsia e popujve dhe përparimi i kombeve ka ndodhur për shkak se e kaluara e tyre është pa gabime e pa fatkeqësi, ose përparimi i tyre ka ardhur në një pjatancë floriri, pa bërë asnjë lloj pune e mundimi, ose pa pasur asnjë vështirësi prej trajtimit të historisë së tyre me rrugën e kritikës dhe të diskutimit.

Patjetër që e kaluara e kombeve perëndimore ka qenë e mbushur me gabime e urrejtje të ndërsjellë dhe natyrisht që, këto dy elemente, kanë prodhuar vetëm fatkeqësi për shekujt që erdhën më pas, madje në shumë raste, gabimet dhe urrejtja e ndërsjellë, ka arritur deri në kufirin e destabilizimit e të turpit, për shkak të krimeve e delikteve të tjera që janë praktikuar. Është derdhur gjaku i shumë njerëzve dhe me shumë ashpërsi janë ndaluar mendje të mëdha.

Nuk mendojmë se rruga që ndoqën gjykatat e inkuizicionit të frikshëm në Evropë dhe krimet që u bënë prej vendimeve të atyre gjykatave janë të panjohura për ndonjë njeri. Të gjithë e dinë se si i mblidhnin njerëzit në grupe të mëdha dhe si i vinin në rresht në sheshet, ku do të kryheshin ekzekutimet me vdekje. Natyrisht që kjo bëhej,

me qëllim që njerëzit të shihnin si vriteshin kundërshtarët, me gjakftohtësi të plotë dhe jo për ndonjë gjë tjetër, por vetëm për shkak se kishin kundërshtuar kthimin e tokave të tyre në ferma, me të cilat fabrikat e tjerres dhe të endjes të plotësonin nevojat që kishin për leshin e bagëtive.

Gjithashtu, të gjithë kanë dijeni për historinë e jetës së Galileut dhe për teorinë se Toka ka formë sferike, prandaj s'është nevoja që ky tregim të përmendet e të komentohet.

Pavarësisht nga ato tmerre që duken të pabesueshme, këta popuj kurrë nuk u dorëzuan para fatit që u ishte caktuar, në të kundërt, vazhduan të rezistojnë me kryelartësi, derisa arritën mundësinë të dalin shëndoshë e mirë prej atyre tmerreve dhe të marrin në dorë frerët për drejtimin e punëve dhe, krahas punëve, të administrojnë edhe mendjet studiuese e reformatore, mendje që ishin larg frymës së hakmarrjes e të fanatizmit, ose mendjeve që përhapnin akuza fals. Ato ishin mendje që filluan të studiojnë të gjitha opinionet, të analizojnë të gjitha problemet me frymë të mirëfilltë shkencore e objektive dhe pastaj, prej studimeve të nxirrnin mësimet e koncepte. Të gjitha këto ua paraqitën brezave të ardhshëm, të cilët i përvetësuan mësimet deri në imtësi dhe punuan në anën që e kërkonte interesi i tyre, për rrjedhojë ndikimi i tyre u përhap në të gjitha anët e botës.

Këta popuj e kuptuan se e kaluara e çdo shoqërie është si e tashmja e saj, është pjellë e një mjedisi shoqëror kompleks dhe e lindur nën hijen e kushteve politike dhe ekonomike të ndryshueshme. Megjithëkëtë ishte e pamundur që këtu e atje të mos kishte gabime dhe devijime sa në njërën anë, po aq edhe në anën tjetër. Por kjo nuk do të thotë se ndikimi i gabimeve detyrimisht do të ketë rezultat negativ dhe dëmi i gabimeve të bëra do të bjerë mbi të gjithë njerëzit, ose mbi vetë fenë. Pikërisht kjo është ajo që e hedhin poshtë interesat e larta të Islamit.

Përsa u përket atyre që mendojnë ndryshe nga kjo që u tha, ata me të vërtetë janë mendjelehtë.

Është e vërtetë se nuk është e drejtë orvatja e atij që përpiqet të bëjë që anija e Islamit të lëvizë larg bregut të sigurisë e të shpëtimit. Gjithashtu është e vërtetë se nuk ka interes të shtyhen të tjerët që të kërcejnë mbi tryezat për të kapur atë grusht fukarenjsh injorantë, për t'i dëmtuar e për të ndezur zjarrin në mesin e tyre dhe të harrojnë se të gjithë janë në të njëjtën anije.

Përmirësuesi xheloz dhe thirrësi fetar, pavarësisht se cilit medh'heb i përket, para se t'i futet punës së tij, ka detyrë parësore të ketë parasysh dy gjëra:

E para, çdo medh'heb dhe çdo grupim ka një histori të gjallë, që i kërkon rrënjët e veta në thellësi, madje deri në

atë shkallë sa na bën të besojmë se është e vështirë shuarja e atij medh'hebi apo grupimi. Çdo njeri dëshiron që tjetri ta respektojë dhe që të tjerët të mos vazhdojnë të japin ndihmën e tyre për të pakësuar e për të ulur pozitën dhe shenjtërinë e sukseseve të tij, duke u kapur pas mendimeve e pretendimeve që orvaten ta zhveshin atë prej të gjitha hulumtimeve të tij ideore, letrare e humane që ai ka bërë në rrugën e lartësimit të kësaj feje dhe ngritjen sa më lart të këtij ymeti të madh.

E dyta, e kaluara jonë islame, me të gjitha nuancat e saj, me sukseset dhe me dështimet, është pronë e çdo individi të këtij ymeti dhe asnjë prej nesh s'ka të drejtë të lavdërohet me të mirën dhe të ndahet prej të keqes.

Kjo pronësi mbi historinë vjen prej mendimit se asnjë individ s'ka mundësi të vërtetojë se të parët e tij gjendeshin në njërën anë dhe nuk ishin në anët që ishin kundër njëra-tjetrës.

Bazuar mbi të gjitha këto që u thanë, mendojmë se nuk është në interesin e asnjë individi të mençur të trajtojë historinë e çdo grupimi prej grupimeve më të përhapura, nisur prej këndvështrimeve “mashtuese” e dashakeqe, ndryshe ky studiues do të ishte si ai që merr në trajtim vetveten dhe pështyn mbi fytyrën e vet. Natyrisht që këtë punë nuk e pranon askush veç të çmendurve.

Për të gjitha këto, mendojmë se leximi i së kaluarës patjetër dhe domosdoshmërisht duhet të jetë i stolisur vetëm me objektivitetin shkencor, të zhveshur krejtësisht prej shtysave, për të mbajtur vetëm njërin prej anëve, ndryshe do të shkactohej zemërimi i të tjerëve. Vetëm rruga e leximit të ngjarjeve e fakteve me objektivitet shkencor është rruga e vetme që siguron ecurinë e procesit plotësues të ymetit tonë të lavdishëm dhe rruga e vetme që i shtyn të gjitha grupimet të marrin pjesë në mënyrë efektive për të ngritur sa më lart fjalën e Islamit.

Libri që kemi në dorë, numërohet ndër librat që i përshkruan kohët me guxim dhe problemet më të ndjeshme i trajton me objektivitetin që ato meritojnë të vlerësohen. Këtë libër e ka shkruar me mjeshtri njohëse profesori e përmirësuesi i mirënjohur Sej'jid Hadij Khasrushahij. Në këtë libër autori trajton studimin, analizën dhe diskutimin, në njërin prej qëndrimeve më të rëndësishme të historisë së Shi'izmit. Libri është shkruar me një logjikë të shëndoshë shkencore, me një gjuhë të lartë, që ngrihet mbi metodologjinë e cekët dhe me një mënyrë të përpiktë e objektive që, si bazë, ka respektimin ndaj tjetrit.

Ky libër është ndikues, sepse trajton një anë shumë të ndjeshme, sa herë që atë e kanë ngacmuar armiqtë e fesë dhe të Ehli Bejtit, por autori ka fituar një ndikim akoma më

të madh me mënyrën e mbrojtjes që ka përdorur dhe në përgjigjet që ka dhënë me penën e tij, e cila ka aftësinë të bëjë që zemrat të pulsojnë para se mendjet të reagojnë me respekt e gjallëri.

Shkrimtari përqendrohet rreth aksit kryesor që mban titulli i librit dhe punës së madhe, në sajë të së cilës mundësohet të bëhen sa më të dallueshme rrënjët historike të kësaj “legjende”, edhe pse çështja është paraqitur në mënyrë të shkurtër. Libri shpalos edhe disa anë të tjera që kanë lidhje me aksin kryesor, si një studim i shkurtër rreth unitetit dhe afrimit dhe si një orvatje për t’u njohur me hapin e parë në rrugën e vëllazërimit të ngrohtë. Më pas vjen seria e përgjigjeve të shkurtra, që autori i këtij libri ka dhënë ndaj disa dyshimeve të ngritura nga disa gazeta. Këto përgjigje ai i ka vënë si shtojcë në këtë libër, por që janë shumë tërheqëse e të dobishme në vendet përkatëse, duke shtuar edhe rrugën elegante me të cilën janë paraqitur.

Me këtë libër lexuesi kalon nga njëri vendqëndrim në një tjetër, duke përshkuar ngjarje që i takojnë kohëve shumë të largëta, por që për një pjesë të madhe lexuesish, mund të jenë shumë të reja.

Autori ka përdorur mënyrë elegante në shkrimin e studimit të tij, të këndshëm e të mbushur me ngrohtësinë e dashurisë për të tjerët. Ai “troket” në teorinë e afrimit dhe

nënvizon dëshirën e tij për forcimin e lidhjeve të gjakut në mesin e këtij ymeti, me gjithë grupimet e tij, veçanërisht tani që ymeti po kalon në një etapë shumë të rrezikshme me ndikime të mëdha.

Kjo është edhe ajo për të cilën bën thirrje Asambleja Botërore për Afrim mes Medh'hebeve Islame, e cila, në mënyrë të veçantë, i drejtohet kujtdo që ka dëshirë të furnizojë ymetin me studime e dashamirësi, duke e ndihmuar kështu ymetin me forcën që rezulton prej qëndrimit në krah të njëri-tjetrit dhe forcimin e unitetit në radhët e ymetit tonë të mëshiruar.

S'na mbetet gjë tjetër veçse të falënderojmë autorin dhe të lutemi që Allahu ta bëjë sa më të gjatë vlerësimin për punën e tij. Duhet të theksojmë edhe një pikë shumë të rëndësishme, të cilën, për nga rëndësia e madhe që ka, ne myslimanët duhet ta ruajmë me qetësinë tonë, pasi jemi ne ata që ndeshemi me lloje të shumta pretendimesh prej çdo ane që na vijnë. Prandaj të përpiqemi që mendjet tona të punojnë e të diagnostikojnë me hollësi akuzat që lëshohen kundër nesh, por që prekin dinjitetin e çdo njërit prej medh'hebeve islame që gëzojnë respekt dhe vlerësim të ndërsjellë. Gjithashtu, të përpiqemi të nxjerrim mësim prej pësimeve dhe të veprojmë ashtu siç kanë vepruar kombet e tjera, të cilat e kapërcyen me sukses këtë etapë dhe

hordhëm një hap madhor në fushën e përparimit. Vetëm Allahu sjell mbarësi dhe vetëm Allahu është Ndihmuesi.

Qendra e Vërtetimit dhe e Studimeve Shkencore

Pranë Asamblesë Botërore për Afrimin mes Medh'hebeve Islame.

PARATHËNIA E AUTORIT

Mendësia e kaluar që vazhdon të jetë sunduese në imagjinatën e myslimanëve në ditët e sotme, përbën një krizë të madhe, që nuk i le ata të trajtojnë në mënyrë të drejtë e të saktë konceptet e Islamit e studimin e tij dhe bazat e historisë islame. Mendësia e kaluar përbën një krizë tjetër nga ana e bashkëpunimit të ndërsjellë me “tjetrin”, domethënë, e pranimi të tjetrit dhe e bashkëjetesës me tjetrin.

Në ditët e sotme, kjo krizë është plotësisht e dukshme në përplasjen e stisur ndërmjet Shi’ave dhe Ehli Syneetit, përplasje e ndërtuar mbi çështje të pretenduara që kanë të bëjnë me njerëzit e kohës së kaluar e që s’kanë asnjë lidhje me të tashmen. Vendin kryesor në këto çështje e zë çështja e Abdullah ibn Sebes dhe e gjithçkaje që ka lidhje me këtë person, përfshin ngjarje, koncepte e konsiderata, që në vërtetë janë mite dhe s’kanë asgjë të përbashkët me realitetin.

Shumë prej studiuesve bashkëkohorë, prej atyre që ia kanë dorëzuar veten mendësisë së të kaluarës kanë rënë viktimat të këtij personi të pretenduar, mbi të cilin kanë

ndërtuar një kështjellë me koncepte e konsiderata, por, që në të vërtetë, ngrehina e tyre rezultoi një kështjellë prej rëre, që nuk i qëndroi gjatë erërave të realitetit.

Personi i Abdullah ibn Sebes është prej stisjeve të librave të grupeve të dala pas vitit 310 të Hixhretit, ashtu siç do të bëhet e qartë për lexuesin gjatë leximit të këtij libri.

Duke u mbështetur në mendësinë e së kaluarës, studiuesit nuk e derdhën sasinë e mjaftueshme të punës shkencore e metodologjike rreth këtij personi të pretenduar, por e kapërdijnë atë me shpejtësi prej së kaluarës, sikur të ishte një tekst i qartë, hartuar mbi bazën e njoftimeve të ardhura prej përcjellësve me varg të pashkëputur. Do të ishte shumë më mirë që ata të niseshin prej objektivitetit e drejtësisë, që, në fakt, është shpirti i Islamit dhe baza e tij, para se të merreshin me konstruktimin e këtij personi mitik e të dilnin në mbrojtje të tij. Pikërisht ky qëndrim ka shkaktuar daljen e dyshimeve rreth një pjese të madhe të myslimanëve, madje ka shkaktuar edhe dyshime në konsideratat e tyre, për rrjedhojë dolën grupet e u shkaktua çarja mes kësaj pjese të myslimanëve, të përfaqësuar prej shi'ave dhe mes grupeve të tjera të myslimanëve.

Bashkëkohësit që marrin përsipër të bëjnë thirrje për në Islam, kanë detyrë të kuptojnë rëndësinë e madhe të

koncepteve, konsideratave dhe fakteve që ata përhapin për legendën e Abdullah ibn Sebes, njëkohësisht ata kurrë nuk duhet të shprehen rreth këtij personi pa argumente logjike, të bazuara mbi tekste të qarta, sepse një veprim i tillë do të thotë shpallje e luftës kundër shi'ave, të cilët janë një pjesë, që nuk mund të mos merren në konsideratë prej tërësisë së myslimanëve. Për më tepër, tani që jemi në një kohë, kur lufta kundër Islamit është shpallur në të gjitha vendet.

Unë nuk e di, a është padituria ndaj armiqve të Islamit që na kanë rrethuar me planet e tyre, apo është shkujdesje nga ana jonë që të stisim këtë person mitik në kohën e tashme, kohë që na e bën të detyrueshme të armatosemi me ndërgjegjësim, me unitet dhe të qëndrojmë krah për krah në ballafaqimin me komplotet që kanë rrethuar Islamin e myslimanët, komplete që kanë si objektiv përçarjen dhe dobësimin e myslimanëve.

Nëse ata, që herë pas here “shpërthejnë” çështjen e Abdullah ibn Sebes, do të tregonin kujdesin e duhur ndaj Islamit, përse nuk trajtojnë çështje të tjera, që të sjellin lidhjen mes myslimanëve, që lartësojnë simbolin e Islamit në botë dhe të përhapin doktrina, koncepte e dispozita që sjellin dashuri e pajtim mes myslimanëve?! Këto elemente, në ditët e sotme, forcojnë lidhjet mes shtresave të njerëzve.

Padyshim që prej kërkesave të dashurisë e të devotshmërisë duhet të themi: Shkrimtarët e studiuesit, në

ditët e sotme, kanë për detyrë të mbajnë qëndrim të prerë dhe të tregojnë kujdes të veçantë ndaj çdo botimi që ka lidhje me Abdullah ibn Seben, apo të ngjashëm me të dhe të shikojnë të vërtetat, në mënyrën më të mirë, para se ato të përhapen në mesin e myslimanëve.

Të armatosurit me mendësinë e së kaluarës njaftohen me burimet e së kaluarës, edhe pse rreth atyre burimeve ka pasur shumë polemikë. Prandaj do të ishte më mirë që ata të mbanin qëndrim edhe ndaj burimeve bashkëkohore që trajtojnë personin e Abdullah ibn Sebes, si për shembull libri “Ngatërresa më e madhe” - “El fitnetul-kubrâ”, e autorit dr. Taha Husejn dhe të ngjashëm me të, prej kolosëve të letrave e të mendimit arab islam.

Kush mund të bashkëpunojë më mirë se dijetarët e fesë, intelektualët e shkrimtarët tanë për të larguar konfliktet mes myslimanëve, për të forcuar unitetin, pajtimin mes tyre, si dhe për të respektuar simbolet e grupeve të myslimanëve dhe gjërat e tyre të shenjta?

Është për të ardhur keq, kur disa burra të fesë marrin pjesë në ndezjen e zjarrit të ngatërresave mes myslimanëve dhe punojnë jo vetëm për ringjalljen e mendimeve seb’iste, mendime që kanë lidhje me Abdullah ibn Seben, por përpiqen të lidhin dashurinë ndaj Ehli Bejtit me thënien se kjo dashuri i ka rrënjët në judaizëm.¹

Këtu shtrohet pyetja: Si do të jetë baraspesha islame, sikur Islami të jetë ndërtuar mbi ndarjen në grupe, mbi luftën mes grupeve dhe mbi kontradiktat?

Pastaj, si do të ishte puna, sikur në vend të anomalive që u thanë më sipër, të ishte pajtimi, uniteti dhe afrimi?¹

¹ Një prej studiuesve të universitetit të Ez'herit ka botuar kohët e fundit një punim për gradën "Magjistër" me titull: "Es'sun'netu-n'nebevij'jetu fij kitàbati a'dàil-Islàm"- "Rruga profetike në shkrimet e armiqve të Islamit". Ky punim është një studim kundër shi'ave. Gjithashtu, ka dalë edhe një libër tjetër "El xhudhùrul-jehùdij'jetu lish'shij'ati"- "Rrënjët judaike të Shi'izmit" e dr. Abdul-mun'im Elberr'rrij, punonjës në universitetin e Ez'herit. Pena të ndryshme kanë botuar herë pas here libra të tjerë në fushën e rigjallërimit të ndarjes mes myslimanëve syni dhe shi'a. E bukura e kësaj pune është se këta autorë e quajnë veten "selefi", ose përkrahës të rrugës së Muhamedit.

AFRIMI DHE UNITETI

Dukuritë e përmirësimit dhe të shkatërrimit, që vërehen në rrafshin shoqëror, janë gjendje të lëvizshme e të ndryshueshme, që kanë lidhje me vullnetin e njeriut dhe që zakonisht janë të nënshtruara prej vendimeve e faktorëve ideologjikë, ose prej faktorëve doktrinarë, që sjellin pasoja e shkaqe themelore. Janë pikërisht këto të fundit, që kanë prodhuar një dukuri, ose një dukuri tjetër, kanë prodhuar konfliktin, armiqësinë, ndarjen në grupe, ose unitetin, ose shtypjen, ose afrimin. Të gjitha këto përbëjnë një dukuri të dallueshme qartë në jetën e ymetit, dukuri që janë të afta për të çartur gjallërinë dhe mesazhin që mbart ky ymet, ose vënë në dukje kotësinë e boshllëkun e tij. Natyrisht që këto dukuri nuk janë përjashtime në jetën e njeriut. Në të kundërt, ato padyshim kanë lidhje me ligjet që Allahu ka vënë për shoqërinë dhe për jetën e të gjitha kombeve.

Islami bën thirrje për ndërtimin e një shoqërie që beson se Allahu është Zoti Një e i Vetëm, bën thirrje për ndërtimin e një shoqërie që vepron me drejtësi, shoqëri që s'ka asgjë të përbashkët me injorancën, shoqëri që ka besim të plotë se injoranca prodhon vetëm konflikte e kontradikta, prish unitetin e konstruktivitetin. E kundërta

e injorancës është kultura dhe dituria, që janë dy qëllime të Islamit. Kultura dhe ditura janë dy faktorë që përbëjnë një element shumë të rëndësishëm në jetën e ymetit dhe të ecurisë së tij integruese.

Kultura dhe dituria çojnë në plotësimin e në zhvillimin e shoqërisë, prandaj Islami e thekson në mënyrë të veçantë strukturën e ideve, e cila prodhon për ne dukuritë e unitetit, të dashurisë e të vëllazërisë dhe e pajis myslimanin me ndërgjegjësim e largpamësi, e armatos atë me shikimin diagnostikues të punëve, faktorë këto që e bëjnë myslimanin të mbajë qëndrim ndaj trashëgimisë kulturore dhe ndaj dukurive negative, të lëna prej kushteve të degradimit e të prapambetjes. Është detyrë e myslimanit që, ndaj të gjitha këtyre dukurive, jo vetëm të mbajë qëndrim ndikues, por edhe t'i përvetësojë ato, me qëllimin që t'i shohë nën prizmin e një trajtimi të vërtetë hyjnor dhe me kuptimin e përpiktë të mesazhit.

Nëse uniteti, nga këndvështrimi islam, është vetë Islami dhe fuqia e tij, ose është Islami gjithëpërfshirës, atëherë afrim do të thotë: një hap i vetëm, ose një shprehje e vetme, ose disa shprehje islame, të formulara në mënyrë shkencore, të cilat përgatisin terrenin që të ekzistojë uniteti. Pikërisht kjo vetëdije për unitetin e për afrimin pa asnjë kompleks e bën studiuesin që ka dëshirë t'i futet studimit të këtyre shprehjeve, me qëllim që të theksohet se çdo

shprehje e vërtetë ka lidhje me çështjen e unitetit, ashtu si bleta kur thith nektarin e luleve, të cilin e përvetëson në mënyrën më të mirë, pa lënë në të asgjë të huaj. Vetëm në sajë të kësaj rruge, për studiuesin do të jetë fare e qartë se cila është ajo shprehje që thellon kontradiktën mes myslimanëve, që ai të punojë me ngulm për ta larguar atë shprehje. Pastaj studiuesi shejh cila është gjendja shpirtërore e myslimanëve, qoftë politike, qoftë emocionale, që s'ka lidhje me doktrinën, por bën që kapacitetet islame të shkojnë kot e të humbin.

Por, që studiuesi të ecë në këtë drejtim, patjetër duhet të dallojë ndryshimin mes fjalës *“kasvetun”*-*“egërsi”* dhe fjalës *“gildhatun”*-*“ashpërsi”* ndaj armiqve dhe kuptimit të qenies së armiqve të poshtëruar. Njëkohësisht të dallojë qartë se ata që ecin në këtë drejtim, janë të mëshirshëm ndaj myslimanëve dhe besimtarëve.

Pastaj studiuesi duhet të dallojë e të ndajë me imtësi mes punëve që janë në interesin e Islamit e të ymetit islam dhe mes problemeve që sjellin dëm për myslimanët e besimtarët.

Por çështja nuk mbaron deri në këtë cak, në të kundërt, çështja kërkon njohjen e kriterit islam, kriter që, në bazën e tij, ka balancimin e shprehjeve dhe të faktorëve, me të cilët detyrimisht duhet punuar në këtë fushë, apo në

një fushë tjetër, gjithnjë me dëshirën për të shpëtuar prej dukurive negative.

Ky kriter konkretizohet me bazën ideore, për të evidentuar koncepte nën dritën e të cilave myslimanët takohen në mendimet e tyre, siç janë besimi se Allahu është Zoti Një e i Vetëm (teuhidi), profetësia, ringjallja pas vdekjes me të gjitha degët e këtyre besimeve, si: namazi, agjërimi, zekati, Haxhi, lufta në rrugën e Allahut dhe shprehje të tjera që kanë lidhje me këto koncepte.

Nisur nga sa u tha, s'ka asgjë që na ndalon të shohim edhe disa kontradikta, duke i konsideruar ato veçanti të sekretuara prej mendjes dhe prej këndvështrimit shkencor; ose nëse dëshiron, thuaj: një qëndrim mbi bazën e të cilit vihet në rregull mendimi, në kuadrin e kushteve dhe të kohës nëpër të cilat ka kaluar ymeti. Mbi këtë bazë ne pranojmë tezën: "Uniteti absolut në lëvizjen e mendjes nuk realizohet në nivelin e të gjitha detajeve të mendimeve e të qëndrimeve, sepse s'ka asnjë rregull që të mos ketë përjashtim, në bazë të të cilit kontradikta në disa fusha të përgjithshme interpretohet si përjashtim i lejuar, në kuadrin e hulumtimit shkencor. Për rrjedhojë, çështja merr një dimension me shumë pjesë, në të cilën s'ka unitet përfundimtar, veçanërisht kur ballafaqohemi me gjëra të vogla në fusha të shumta përkatëse.

Kjo çështje na bën thirrje të mos lejojmë që pjesët e shumta në mendimet ndryshe ideologjike të mos shndërrohen në mure ndarëse që çojnë në ndërprerjen e lidhjeve me të gjithë dhe me shembjen e unitetit të idesë. Disa njerëz kanë rënë pre e këtij mendimi, atëherë kur ata, pjesën e vogël, ose qëndrimin në gjendje emergjence që ka adaptuar njëri medh'heb, ose një medh'heb tjetër, e bënë rregull në të gjitha punët dhe kundërshtuan e nuk pranuan çdo pjesëz që te tjetri është ndryshe, madje edhe atëherë kur ajo pjesëz s'ka asnjë kuptim e asnjë ndikim.

Si përfundim, mendimi, i shoqëruar me qëndrimin ndaj pjesëzave, ka rezultuar për ne një Islam shumëngjyrësh dhe me grupime të ndara, në vend të një Islami të vetëm dhe të një ymeti të vetëm.

Në të vërtetë, problemi, në dimensionin e tij kulturor, është ai që e përcakton qëndrimin shkencor. Kultura e Kur'an Kerimit bën thirrje për unitet dhe e konsideron unitetin parimin bazë. Kur'an Kerimi përdor shprehje shkencore dhe shpalos shprehjet e përbashkëta mes feve të ndryshme. Këto shprehje, Kur'an Kerimi i ka bërë bazë në trajtimin e pikave të kundërta, të cilat kanë ndikim negativ mbi ndijimet e ndjenjat dhe bëhen pengesë që nuk lejon realizimin e unitetit, nuk lejon as krijimin e një atmosfere dashamirëse dhe çiltërie ndaj opinionit të tjetrit.

Shprehjet e përbashkëta mes feve janë trajtuar që të jenë një element për afrim. Këto shprehje të përbashkëta kanë të bëjnë me tregimet rreth profetëve dhe thirrjes së tyre madhore.

Në përputhje me këtë bazë, ne s'kemi qëllim t'i bëjmë thirrje ndonjërit prej shi'ave, ose ndonjërit prej synive, që, çdo njëri prej tyre, të shkrihet në doktrinat e palës tjetër dhe të bëjë lëshime në të vërtetat që i beson, ose në veçantitë që e dallojnë atë. Këtë thirrje ne as nuk e bëjmë e as nuk e dëshirojmë, por vetëm themi që ky është një studim rreth bazave që janë të përbashkëta në të dyja palët dhe të punohet sipas këtyre bazave të përbashkëta, ashtu siç porositi Allahu i Lartësuar me fjalën e Tij:

فَإِنْ تَنَزَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ إِنْ كُنْتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ
وَالْيَوْمِ الْآخِرِ²

"...fein tenàza'tum fij shej'in ferud'dùhu ile-ll'llàhi uerr'rresùli in kuntum tuëminùne bil'làhi uel-jeumil-àkhiri..."

"... kur keni kundërshtime për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë te Allahu (te libri i Tij) dhe te i Dërguari, nëse me të vërtetë besoni në Allahun e në Ditën e fundit..."²

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar urdhëron:

² Sure "En Nisa", ajeti 59.

وَأَعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا³

“Ua' tesimù bihabli-l'lâhi xhemij'an ue là teferr'rrekù...”

“dhe të gjithë ju kapuni pas litarit të Allahut dhe mos u përçani...”³

Qëllimi me fjalën *“litar”*, në këtë ajet të Kur'an Kerimit, sipas shumicës së tefsireve, është Islami dhe imani. Këtë kuptim Imam Aliu e ka konkretizuar në mënyrë praktike, kur pati kundërshtime me të tjerët për hilafetin (udhëheqësinë): *“Patjetër që unë do të dorëzohem para punëve që janë dorëzuar myslimanët. Në ato punë s'ka mëkat dhe në veçanti për mua.”⁴*

Imam Aliu i mbajti lidhjet e dashamirësisë edhe me sahabët që pati kundërshtime. Ai ishte i çiltër me ta dhe kurrë nuk lejoi të ngrihej një mur ndarës mes tij e mes atyre që pati kundërshtime për sloganet e Islamit e dispozitat e tij, sepse në ato kishte një element të përbashkët gjithëpërfshirës, në sajë të të cilit ruhej Islami. Në sinqeritetin ndaj Islamit e në faktin që ai nisej prej parimit të ruajtjes së interesave të larta të Islamit, qëndron sekreti që e shtyu Imam Aliun të mbajë këtë qëndrim.

³ Sure “Ali Imran”, ajeti 103.

⁴ “Nehxhul Belâgah”, Hytbeja 74.

Gjithashtu, singeriteti i Imam Aliut ndaj interesave madhore të Islamit del qartë edhe në qëndrimin që mbajti ndaj halifes së dytë, kur ai u këshillua me Imam Aliun, nëse të shkonte apo jo së bashku me ushtrinë në tokat e Persisë. Imam Aliu iu përgjigj: *“Mos shko, sepse ti je kreu dhe maja e punëve.”*

Me këtë përgjigje Imam Aliu nuk e mendoj halifen e dytë si një person të zakonshëm. Ai nuk mendoj as për përfitimet e tij politike, por në këshillën e tij të sinqertë u nis vetëm prej interesave të Islamit.

Kjo ishte në rrafshin e qëndrimit, kurse në rrafshin e mendimit, sikur Ehli Syneti të thotë se disa shi’a besojnë se Kur’ani është i reformuar dhe pastaj shi’at të drejtonin të njëjtën akuzë kundër Ehli Synetit, a nuk gjen vend të lirë që të vijë dikush prej jomyslimanëve e të thotë se myslimanët nuk besojnë që Kur’ani është i paprekur dhe se myslimanët nuk besojnë që fjalët e Kur’anit janë taksative. Këtë fjalë ata e argumentojnë duke thënë se të dyja krahët e myslimanëve akuzojnë njëri-tjetrin për reformimin e Kur’anit.

Pikërisht këtë ka bërë enciklopedia islame britanike dhe disa orientalistë. Ata e kanë përdorur këtë akuzë të trilluar për qëllime të këqija, për të shtrembëruar Islamin dhe për të atakuar bazat e qarta të Kur’anit.

Atëherë çështja duhet diskutuar mbi bazën e pjesëve të përbashkëta. Imamët e shi'ave dhe imamët e Ehli Syneetit, si dhe dijetarët e të dy krahëve, në mënyrë të prerë nuk besojnë se Kur'ani është i reformuar dhe nuk mund të merren në konsideratë fjalët jonormale, të lëshuara prej disa shi'ave e prej disave të Ehli Syneetit, pasi ata janë vetëm një pakicë, fjala e të cilëve, në asnjë rast, nuk merret në konsideratë. Rezultati është: dijetarët e të dyja shkollave islame, në mënyrë absolute nuk besojnë se Kur'ani është i revizionuar.

CILI ËSHTË QËLLIMI I AFRIMIT TË MEDH'HEBEVE?

Kur flasim për unitetin mes grupeve islame, në radhë të parë, kundërshtojmë të ngrihet dora mbi pikat dalluese mes medh'hebeve, qofshin ato çështje parësore, siç është çështja e njohjes së imamatit e të imamit, qofshin çështje dytësore, siç janë dallimet ekzistuese në rrafshin e degëve të fik'hut, si dhe disa dallime që ekzistojnë për mënyrën e marrjes abdes, për mënyrën e jashtme të faljes së namazit, me mënyrën e plotësimit të ritualeve të Haxhit dhe të disa punëve të tjera. Kur ne theksojmë domosdoshmërinë e unitetit, me këtë nuk kemi qëllim domosdoshmërinë për heqjen e këtyre dallimeve prej Islamit, sepse kjo do të thotë fshirje e identitetit të medh'hebit.

Në radhë të dytë, ne nuk pranojmë të ndalohej studimi mbi të vërtetën e këtij apo të atij medh'hebi, ose të ndalohej studimi për vërtetësinë e këtij mendimi ose të një mendimi tjetër prej dy mendimeve të ndryshme që janë në bazat e medh'hebit, si imamati, ose në degët e përfaqësuara me namazin e me agjërimin, etj. Por themi se

duhet të mbahet e hapur plotësisht porta e diskutimit të lirë, objektiv e të shëndetshëm në rrafshin e të gjitha medh'hebeve, ashtu siç është gjendja e diskutimit që bëjnë shumë dijetarë në kuadrin e të njëjtit medh'heb, sepse rruga e zhvillimit shkencor dhe rruga e zbulimit të së vërtetës kalon nëpërmjet diskutimit dhe studimit të çështjeve të ndryshme, kurse mbyllja e portës së diskutimit dhe e studimit do të thotë mbyllje e portës për të arritur te e vërteta dhe ndalim i zhvillimit shkencor. Ky është një gabim i pafalshëm.

Krahas kësaj, ne shprehemi për domosdoshmërinë e bashkëpunimit, qëndrimit krah për krah, ndihmës së ndërsjellë, jetës vëllazërore, shtrëngimit të radhëve, mëshirë e dashamirësi të ndërsjellë, mbrojtje të njëri-tjetrit, mes grupeve e shtresave të ndryshme dhe të medh'hebeve të copëtuara. Të gjitha i bashkon besimi në tri baza: Allahu është Zoti Një e i Vetëm, profetësia dhe ringjallja. Me këtë besim ata cilësohen se i përkasin një feje të vetme dhe të gjithë përfshihen në tekstin e transmetuar prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!*): *“Myslimanët janë vëllezër, gjaku i tyre është i barabartë. Në mbrojtje të tyre nxiton ai që është më afër tyre. Ata janë një dorë e vetme kundër të tjerëve.”*⁵

⁵ Shejkh El Hurr El Amilij, “El Uesàil”, vëll. 31, K. “Prej dënimeve për vrasjen e njeriut”, f. 11.

Është domosdoshmëri të besojmë fenë e Allahut, unitetin në mesin tonë, pavarësisht se vëllezërit e tjerë e njohin, ose e kundërshtojnë këtë. Domosdoshmërinë për unitet ne na e argumentojnë disa punë:

SHERIATI DHE THIRRJA PËR UNITET

Sheriati islam, të gjitha grupet islame, i shikon të barabarta në rrafshin e të drejtave: një shi'a trashëgon një syni, ashtu si edhe një syni trashëgon një shi'a. Të drejtat e burrit mbi gruan nuk janë të ndryshme, kur ata të dy i përkasin ose jo dy medh'hebeve të ndryshme, madje si bazë në martesën e tyre nuk është kusht që burri e gruaja të jetë i të njëjtit medh'heb.

Në fushën e dënimeve fizike dhe në fushën e shlyerjeve të krimit me pagesë, s'ka asnjë dallim mes një shi'iti dhe një syniu. Të gjithë myslimanët, në këto të drejta dhe të drejta të tjera, nga këndvështrimi i ligjit të fesë islame, janë të barabartë. Kështu janë shprehur dijetarët më në zë, të cilët pohojnë se myslimanët janë të barabartë, siç janë të barabartë dhëmbët e krehrit. Kjo tregon se sheriatu islam të gjithë myslimanët i do si një trup i vetëm, si një ymet i vetëm dhe kurrë nuk i do të përçarë, të shpërndarë dhe në armiqësi me njëri-tjetrin.

Shprehjet e qarta, që gjenden në transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit, e theksojnë fuqishëm unitetin mes myslimanëve, nëpërmjet lidhjeve të fisit, lidhjeve të gjakut, përzierjes mes njerëzve, vizitën e të sëmurëve të tyre, marrjen pjesë në varrim, plotësimi i amaneteve që ata lënë dhe të tjera sjellje të lavdëruara që shpalosin myslimanët mes tyre, pavarësisht se ndryshojnë në medh'heibn që ndjekin.

Ja edhe hadithi i gradës “Sahijh”, i transmetuar në librin “El Kàfij” të autorit, shejhut El Kulijnij, sipas përcjelljes së Muavijeh ibn Vehbit: I thashë atij: “Si duhet të veprojmë me njerëzit e tjerë, me të cilët jemi përzier, dua të them me njerëz që nuk ecin në drejtimin tonë?”

Ai më tha: “Shikoni imamët tuaj, merrini ata si shembull, veproni ashtu siç kanë vepruar ata. Pasha Allahun, ata i vizitonin të sëmurët, merrnin pjesë në varrimin e tyre, dëshmonin në favor të tyre, dëshmonin edhe kundër atyre dhe i dorëzonin atyre gjërat e lëna amanet.”⁶

Kur njeriu arrin te e vërteta, si rezultat i ndjenjës ndaj përgjegjësisë ligjore dhe njerëzore nëpërmjet vëllazërisë, dashurisë e dhembshurisë, kjo është shumë më e sigurt për vazhdimësinë e për vijimësinë e tij dhe, është e

⁶ “El Kafij”, vëll. 2, f. 636, prej kreut “Miqësia”, K. “Çfarë është detyrë në miqësinë e ndërsjellë?”, vëll. 4.

kundërta e asaj që vjen me rrugën e sfidës, të forcës së kamxhikut. Në një gjendje të tillë, për ne mbetet detyrë të presim humbjen e së drejtës, derisa të humbë kamxhiku e të marrë fund forca.

Qetësim e trajtim me butësi do të thotë shkalla më e lartë e drejtësisë, sepse qetësimi e trajtimi me butësi, në shumicën e rasteve, nënkupton këshilla të shumta për të mirën e të tjerëve dhe heqje dorë prej shumë përfitimeve vetjake, e cila, nga ana e saj, e kthen të drejtën te ai që i takon.

Me rrugën e trajtimit me butësi, ymeti ka mundësi të përballojë kushtet e jashtëzakonshme dhe pakësimin e pasojave negative që vijnë prej ngjarjeve të jashtëzakonshme. Gjithashtu, me rrugën e trajtimit me butësi ymeti ka mundësi të përballojë të gjitha format e presionit që mund të ushtrojnë armiqtë e ymetit, përfshirë presionet nëpërmjet politikave ekonomike, ushtarake etj, me qëllim eliminimin e ymetit, ose thithjen e kapaciteteve të besimit të ymetit.

UNITETI ËSHTË DOMOSDOSHMËRI NJERËZORE

Uniteti është domosdoshmëri njerëzore dhe ardhmëri për ymetin islam. Por uniteti ka nevojë për shumë kohë e për shumë punë, ka nevojë për studime të shumta, për të diagnostikuar të vërtetat, që më pas të kalohet në rrafshin shpirtëror të njerëzve, deri në atë gradë sa i bën ata të përgatiten e të jenë në atë shkallë lartësie që u mundëson njerëzve të realizojnë unitetin.

Por, derisa ky unitet të bëhet realitet, ymeti as nuk mund të lejojë të asgjësohet prej rrezikut që i vjen prej armiqve të tij dhe as nuk mund të lejojë që armiq të gjëllisin kapacitetet e ymetit. Dihet se armiq të synojnë të shkulin rrënjët e Islamit dhe të myslimanëve. Prandaj ymeti islam ka nevojë të ngutshme për bashkëpunim e për unitet të plotë mes myslimanëve.

Ky bashkim, ose nëse dëshiron thuaj: ky bashkëpunim i ndërsjellë nën çadrën e unitetit, është një kërkesë e Islamit, unitet në të gjitha dimensionet, në të gjitha shkallët e tij të ndryshme dhe në të gjitha nivelet. Megjithatë, uniteti nuk është gjithçka që kërkohet. Në të

vërtetë, kërkesa për unitet zë vendin e një domosdoshmërie të përkohshme, që patjetër duhet pranuar për të qenë i kënaqur me pritjen, derisa uniteti i vërtetë të bëhet realitet mbi themelet e veta islame dhe konkrete.

Në rrugën e gjatë të unitetit e të bashkimit, në mesin e myslimanëve bëhet nevojë e ngutshme afrimi, njohja e kuptimi i ndërsjellë, shkëmbimi i pikëpamjeve, informimi i ndjekësve të çdo medh'hebi prej ndjekësve të medh'hebit tjetër për burimet e tij, bazuar në fjalën e dijetarëve të medh'hebit përkatës, si dhe informimi për krijimtarinë e dalë prej penave të dijetarëve, larg komplikimit të mureve ndarëse.

Dijetarët e ideologët e sinqertë gjatë shekujve kanë bërë përpjekje të shumta në këtë rrugë. Ne kemi mundësi të përmendim një shembull shumë të rëndësishëm. Është fjala për nismën e ndërmarrë prej Ajetullah Es'sej'jid Husejn El Buruxherdij për themelimin e Shtëpisë së Afrimit, në bashkëpunim me dijetarët e universitetit të Ez'her Sherifit. Gjithashtu kemi edhe fetvatë e shejhut Mahmud Sheltut, në lidhje me lejimin e adhurimit sipas medh'hebit shi'it. Duhet theksuar se ky dijetar i madh është prej pionierëve të afrimit mes medh'hebeve islame në Kajro, Egjipt. Një ndër themeluesit e kësaj shtëpie është

edhe dijetari i dëgjuar iranian, shejhu Muham' med Tekij El Kummij, miku i shejkhëve të universitetit të Ez'her Sherifit.

Patjetër duhet të përmendim edhe punën e madhe që ka bërë Ajetull'lah Es'sej'jid Abdulhusejn Sherefud'dijn El-Amilij, i cili ka shkruar libra shumë të rëndësishëm, si "El Muràxheàt"- "Referime", "El Fusùlul Muhim'metu fij te'lijfil-um'meti"- "Kapituj të rëndësishëm në unifikimin e ymetit". Në librin e dytë ai ka prekur shumë tema e shembuj që ndihmojnë realizimin e afrimit dhe kuptimin e ndërsjellë mes myslimanëve.

Edhe në rrafshin e mendimeve, përpjekjet janë të shumta e të shumëllojshme, siç është organizimi i disa konferencave, shkrimi i shumë studimeve shkencore, botimi i revistës "Risàletul-Islàm"- "Mesazhi Islam", që del në Kajro dhe i revistës "Risàletu-t'takrijb"- "Mesazhi i afrimit", që del në Teheran, si dhe shumë botime të tjera.

Sa mirë është që dijetarët islamë kanë marrë nisma për formimin e komisioneve të përbashkëta për studimin e temave, që paraprakisht janë marrë vesh. Pastaj klasifikojnë temat. Në fund, studimi me frymë shkencore i çështjeve të kundërshtueshme. Në radhë të parë, me këto studime synohet fitimi i kënaqësisë së Allahut të Gjithëfuqishëm, për t'i shërbyer njeriut e njerëzimit, pasi ato janë studime të mbështetura mbi besueshmërinë e

ndërsjellë dhe të kryera me ndjenjën e përgjegjësisë ligjore e me vetëdije.

Bazuar mbi këto që u thanë, detyra jonë është të trajtojmë e të njohim shkaqet e kundërshtimeve. Ky është hapi i parë dhe më kryesori për shërimin e gjendjes, ashtu siç veprohet edhe me të sëmurin, për të cilin diagnostikimi i sëmundjes përbën hapin e parë shumë të rëndësishëm për shërimin e tij.

Por, ka mundësi që shkaqet kryesore të kthehen në dëshira, në fanatizëm të urryer, në prapambetje morale, në rrafshin e trajtimit të problemeve, në aktivitet armiqësor ndaj Islamit, aktivitet që punon rrënimin e myslimanëve dhe shpartallimin e radhëve të tyre nëpërmjet nxitjes së ngatërresave, ose nëpërmjet blerjes së atyre me zemra të sëmura, që t'i vënë ata të kryejnë punën e rrënimit të myslimanëve, ose me rrugën e mospasjes dijeni për gjendjen e myslimanëve dhe besimeve të tyre. Natyrisht që për këto punë të mbrapshta armiq të Islamit mbështeten në njohjen e mirë që kanë rreth akuzave të përhapura dhe për transmetimet e për thëniet jonormale të këtij apo atij medh'hebi. Jo vetëm kaq, por armiq të dijeni të shumta edhe për rrugët e vërtetimit të tekstit ligjor të treguar prej Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ose prej imamëve, ose prej dijetarëve të njërit medh'heb apo të një medh'hebi tjetër.

Ky është shkaku që studimet e armiqve të Islamit janë të maskuara me rrobën e karakterit objektiv e shkencor. Natyrisht që kundërshtimi në këtë fushë vjen për shkak të largësisë së madhe në kohë, që nga dalja e tekstit deri në ditët e sotme. Gjatë kësaj kohe, në lidhje me tekstet, kanë ndodhur kundërshtime e janë bërë falsifikime, por ka edhe gabime e dyshime për përcjelljen e tekstit, për rrjedhojë ka kundërshtime në kuptimin e tekstit dhe në fushën e krahasimit të një teksti me tekstet e tjera, sepse në Kur'anin Kerim, (tekst i vërtetuar hap pas hapi) ka ajete *muhkemât-të padiskutueshme* dhe *muteshâbihât-të diskutueshme*, ka ajete anuluese e ajete të anuluarâ-nâsikhun ue mensûkhun; ka ajete përgjithësuese e specifike-âmetun ue khâs'satu. Këto i mësojmë prej atyre që quhen *esbâbu-n'nuzûli-shkaqet e zbritjes së ajeteve*. Janë këto shkaqe të zbritjes që hedhin dritë për kuptimin e për interpretimin e Kur'an Kerimit. E njëjta gjendje është edhe për tekstet e transmetuara prej *Sun'netiat-Praktikës e fjalës së Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Padyshim që edhe trajtimi i këtyre shkaqeve ndryshon për nga rrugët e nga mënyra e trajtimit, prandaj patjetër duhet të studiohet çdo shkak: edukimi moral i lartë, devotshmëria, besimi me përkushtim të plotë në Allahun e Lartësuar, kujdesi për ruajtjen e interesave të Islamit, dallimi i qartë i armiqve, ruajtja prej kompleteve të armiqve dhe prej punëve e aktivitetit të tyre, studimi rreth

doktrinave e adaptimeve të medh'hebeve islame prej burimeve të fik'hut që ata zbatojnë, duke u mbështetur në fjalët e imamëve të medh'hebeve përkatëse të njohura.

Padyshim që imamët dhe dijetarët, në fjalët e tyre për vërtetimin e teksteve janë nisur vetëm prej vëllazërisë islame, mirëbesimit, frymës së mirëkuptimit, dashurisë, vënies së rregullave dhe kriterëve të duhura, të nxjerra prej Kur'an Kerimit dhe prej Synetit të Profetit. Gjithashtu, ndjekja e një programi dialogimi shkencor konkret dhe diskutimi të qetë, shoqëruar me argumente logjike e ligjore, është rruga më e mirë e më e preferuar për shërimin e gjendjes dhe për trajtimin e problemeve.

KY LIBËR

Metodologjinë për shkrimin e librit që kemi në dorë, me titull “Abdullah ibn Sebe, mes realitetit dhe fantazisë” e kemi shpjeguar më sipër dhe kemi theksuar se për shkrimin e këtij libri nuk jemi mbështetur në copëtimin e elementeve të shëndoshë të këtij individi historik dhe nuk e kemi trajtuar atë si një element negativ, që dëmton gjendjen e Islamit dhe trashëgiminë islame.

Në të vërtetë, kemi treguar shumë kujdes për ta trajtuar këtë person historik nëpërmjet anëve të tij të ndryshme. Në studimin e kësaj figure jemi nisur prej interesave të larta të Islamit, por duke ruajtur edhe besnikërinë ndaj historisë, pavarësisht nga identiteti i medh’hebit, syni apo shi’i. Në këtë libër biseda zhvillohet nëpërmjet logjikës islame, të llogaritur mbi Islamin, mbajtësit të telasheve të shqetësimeve, që paraqet mbajtja e mesazhit. Për të gjitha këto shihen qartë karakteristikat që e dallojnë këtë libër prej librave të tjerë. Ndër këto karakteristika rendisim:

E para: natyra e përzgjedhjes së origjinës së subjektit, pastaj llojshmëria e deduksioneve në lidhje me subjektin e

librit. Në këtë rrugëtim nuk kemi ndjekur vetëm një rrugë, por kemi ndjekur rrugën e dr. Tàhà Husejn dhe rezultatin përfundimtar që ai arriti kur studioi Abdullah ibn Seben në rrafshin historik. Gjithashtu, ne kemi marrë edhe prej studimit të dr. Ali Elverdiç, studim me orientim shoqëror, por që e pasuron studimin tonë me një rezultat tjetër. Në studimin tonë kemi marrë për model rrugën që ka ndjekur El Alammeh Es'sej'jid Murtedà El Askerij dhe studiuesit e tjerë. Të gjitha këto studime i kemi kaluar në rrjedhën e krahasimit shkencor, që na ka çuar drejt të njëjtit rezultat, edhe pse autorët e lartpërmendur ndryshojnë nga ndjekja e rrugës për studimet e tyre.

E dyta: Kam mënjanuar gjuhën e zvogëlimit, gjuhën e impresionit e të zemërimit, si dhe lëshimin pa doganë të akuzave e sharjeve. Natyrisht këtë e kam bërë me qëllim që gjuha e këtij libri të jetë gjuha e dialogut, e diskutimit dhe e argumentimit shkencor.

E treta: Lexuesi i nderuar të jetë pjesëmarrës në studim, pa e kuptuar as vetë këtë gjë. Edhe këtë e kemi bërë me qëllim që lexuesi të gjykojë dhe të mbajë po vetë përgjegjësinë për gjykimin që jep ndaj çështjeve të ndryshme. Natyrisht që me këtë ne nuk e kufizojmë përgjegjësinë vetëm mbi veten tonë si studiues e si specialistë në këtë fushë.

Mendo për specialistët, për dijetarët e për punonjësit shkencorë e përmirësuesit që janë në Ez’her Sherifin dhe në të gjitha rrethet shkencore të ymetit islam, të cilët i kapin të gjitha këto shprehje, duke i konsideruar elemente islame, që japin ndihmën e tyre në procesin e afrimit midis medh’hebeve islame, thjesht duke u nisur prej përgjegjësisë për mesazhin, për hir të interesave të Islamit dhe për t’i shërbyer objektivave të larta hyjnore të Islamit.


Dhe, në mbyllje, ky punim⁷ nuk është më shumë se një hyrje për një studim të madh rreth subjektit Abdullah ibn Sebe, që, me lejen e Allahut, do ta botojmë në të ardhmen e afërt, sepse fusha e mendimeve dhe e kulturës vazhdon të ketë nevojë për studime serioze, që japin ndihmesën e tyre për formimin e mendësisë së myslimanit bashkëkohës, që ai të luajë rolin e tij me efektivitet në shërbim të kësaj feje dhe në shërbim të mbarë unitetit të ymetit islam.

⁷ Këtë studim të shkurtër e kam shkruar për të sqaruar njërin prej studimeve të librit “Esh’shi’atu uet’teshe’jeu” – “Shi’at dhe Shi’izmi”, vepër e profesorit tonë Es’së’jîd Muham’med Husejn Et’tabâtâij. Këtë studim e solli në gjuhën arabe prof. Khàlid Teufijk (Xhev’vâd Ali Kes’sâr), në kuadrin e përkthimeve të tij prej trashëgimisë së shejhut Et’tabâtâij dhe është botuar në Kum, Iran. Sot po e botojmë këtë studim me shtesa dhe të përpunuar, si një punim më vete, më qëllim që përfitimi të jetë gjithëpërfshirës.

Dhe, lutja jonë e fundit: *“Elhamdu lil’lâhi rab’bil-àlemijn!- Falënderimi është vetëm për Allahun, Zotin e botëve!”*.

Sej’jid Hâdij Khasrûshâhij

Kajro, Ramazan, viti 1424 Hixhreti



KAPITULLI I PARË

KUSH ËSHTË ABDULLAH IBN SEBE?

**SI ËSHTË E VËRTETA E
ISLAMIT TË TIJ?**

**E VËRTETA E ABDULLAH IBN SEBES
DHE ISLAMI I TIJ**

Nuk janë të pakta akuzat, me të cilat armiqtë e Islamit qëllojnë shi'at e Shi'izmin. Në fakt, këto akuza janë aq të shumta, sa mbledhja dhe përgjigjja ndaj këtyre akuzave do të kërkonte jo vetëm që të shkruheshin shumë libra, por këto libra patjetër duhej të ishin edhe të shumëllojshme.

Për disa prej këtyre akuzave kryesore, që kanë hedhur armiqtë e Islamit u theksua se karakterizohen për anët historike. Përveç kësaj, këto akuza nuk kanë dalë vetëm prej anës së myslimanëve fanatikë. Në të vërtetë, shi'at, gjatë një apo dy shekujsh, janë bërë tabelë qitjeje, ku gjuhen shigjetat e akuzave të orientalistëve qëllimkëqij jehudi e kristianë, përfshirë edhe të tjerë që kanë dëshirë të përhapin ngatërresa e të shkaktojnë ngacmime. Këta janë gjithmonë të gatshëm të hedhin akuza të ndryshme e të shpifin jo vetëm për shi'at, por edhe për doktrinat e tyre. E gjithë kjo valë akuzash bëhet në realizim të kërkesave të politikës kolonialiste.

Por është për të ardhur keq, se edhe disa prej shkrimtarëve shi'i shkojnë pas asaj që kanë shkruar të tjerët. Kjo mosnjohje, i ka shtyrë ata të ecin pas këtyre shkrimeve, pa i parë me kujdes dhe pa bërë një studim të plotë mbi to, por i citojnë këto akuza me pretekstin se ato përfaqësojnë një studim historik.

Natyrisht që çështja e lëshimit të akuzave nuk ka mbetur vetëm në tregimin për Abdullah ibn Seben, por ka kaluar në tema të tjera, siç janë faktorët që i shtynë iranienët të kalojnë në Shi'izëm, duke rënë kështu në humnerën e gjykimeve që janë në kundërshtim me realitetin, pa bërë ndonjë studim të mirëfilltë mbi të tilla opinione dhe pa i parë ato në imtësi, madje pa kuptuar se ata, në të vërtetë, përsërisin dëshirat e tyre, me ato që kanë thënë e kanë shkruar armiqtë e shi'ave dhe patjetër që janë botuar me motive të qëllimshme, jo të pastra.

Në pararojë të akuzave të tilla, që lëshohen pa asnjë lloj burrërie, është pretendimi se Shi'izmi është prej adaptimeve të jehudiut të njohur Abdullah ibn Sebes. Mbi këtë akuzë kanë ndërtuar dhjetëra akuza të tjera.

Ka më shumë se dhjetë shekuj që disa historianë e shkrimtarë bëjnë studime rreth Abdullah ibn Sebes, madje shkruajnë edhe rreth një grupi të quajtur seb'ij, duke i atribuuar këtij grupi doktrina e mendime aq sa kanë dashur dhe ashtu siç kanë dashur, pa bërë asnjë studim mbi subjektin, për zbulimin e së vërtetës së "studimeve" që kryejnë.

Dr. Ali Elverdi, në librin e tij "Vua'adh-u-s'selâtijn"- "Këshilltarët e mbretërve", thotë: "Ata nuk tuten t'i atribuojnë Abdullah ibn Sebes mëkatet e të gjitha botëve dhe të gjitha këto mëkate t'ia varin atij në qafë, pa marrë

mundimin për të bërë ndonjë studim për origjinën e tij, por vetëm studiojnë çështjen, pa bërë asnjë kërkim mbi të.”⁸

Historianët e studiuesit, në të kaluarën, me shkrimet e tyre flasin fare shkurt e në përgjithësi për legjendën e pretenduar, për Abdulla ibn Seben. Gjatë dy shekujve të fundit kjo çështje ka marrë një karakter krejtësisht të kundërt me rrjedhën e historisë së trashëguar. Gjatë kësaj kohe nuk gjejmë një libër që të trajtojë historinë e Islamit e të sahabëve, por gjejmë vetëm faqe të nxira me bojë rreth tregimit të këtij personi fantastik dhe legjende të rreme.

Tani do të shpalojmë, në mënyrë të shpejtë, në përgjithësi dhe shkurt, të vërtetën rreth Abdullah ibn Sebes, gjithashtu do të shohim se ç’kanë shkruar historianët e studiuesit rreth të quajturit ibn Sebe, gjatë shekujve, deri në ditët tona dhe se çfarë doktrinash e mendimesh i kanë atribuar atij.

Pastaj me një analizë të shkurtër, do të shpjegojmë origjinën e kësaj legjende historike dhe të këtij personi të trilluar, që sipas asaj që ne besojmë, ai s’ka ekzistuar, duke i lënë vendin një analize të zgjeruar për një rast tjetër që, me lejen e Allahut, do ta trajtojmë në të ardhmen.

⁸ “Vua’adhū-s’selātijn”, f. 113.

KUSH ËSHTË ABDULLAH IBN SEBE?

Për ibn Seben kanë thënë: “Ai është një jehudi që përqafoi Islamin, me qëllim që të bëjë mashtrime në Islam, sepse ndihej shumë keq prej përhapjes që kishte marrë Islami. Veç kësaj, fushatat e njëpasnjëshme islame e mbushnin atë me mllef e zemërim, prandaj ai filloi të lëvizë kundër Islamit. Ky burrë, i quajtur Abdullah ibn Vehb ibn Sebe, njihet edhe me emrin Ibn Seuda, i biri i zezakes, është prej jehudive të Jemenit dhe, sipas thënieve të ndryshme, është banor i San’as, ose i Hijrehit, ose i Humrit.⁹

Më tepër se kaq nuk dimë rreth origjinës së fisit të ibn Sebes dhe të paraardhësve të tij, pasi edhe “librat e burrave” - librat me jetëshkrimin e personave, si dhe librat e historisë, nuk kanë përmendur për ibn Seben më shumë hollësi se kaq.

Me sa duket, i pari që ka shkruar se Abdullah ibn Sebe ishte jehudi, është Esh’sherstànij, në librin e tij

⁹ Shiko “Mekâlâtul-islami’jijne ue ikhtilâful-musallijne”, Ebu Hasen El-esh’arij (vdekur në vitin 330 të Hixhretit), f. 11, Parathënia e vëllimit të parë, Botimi i parë. Shiko librin “Meshijkhatul-Ez’her”, autori Abdullah Es’sëbijtij, f. 122, Botuar në Bagdad. Ali Elverdi, “Vua’adhusselâtijn”, f. 111, Botuar në Bagdad.

“Elmilelu uen’nehalu”-“Rrugët dhe pretendimet”, në një kohë që historianët e tjerë kanë heshtur rreth origjinës së fisit të tij, ose ata e kanë përmendur atë duke thënë se ai ishte me origjinë arabe.¹⁰

¹⁰ Referoju librit “El-imàmul-ev’velu”, i autorit Hidàjetu-ll’lilàh Hakijm Ilàhij, f. 42, Botuar në Teheran, në vitin 1329 të Hixhretit.

TREGIMI RRETH ISLAMIT TË TIJ

Kanë thënë: “Përsa u përket jehudive, ata kishin qëllim shuarjen e dritës së Islamit me anë të përhapjes së bidateve (risive) në fenë islame dhe prishjen e unitetit të myslimanëve, përfshirë edhe ato që bëri Abdullah ibn Sebe, me stisjen e Shi’izmit ndaj Aliut (Allahu i ndriçoftë fytyrën!), duke zmadhuar figurën e tij, si dhe duke futur frymën e përçarjes në mesin e myslimanëve, për çështjen e hilafetit.”¹¹

Gjithashtu kanë thënë: “Esh’shaëbij’ji ka përmendur se Abdullah ibn Seuda bashkëpunonte në doktrinën që ai shfaqte së bashku me lëvizjen seb’ij. Ai është jehudi prej Hijrehit, u hoq sikur përqafoi Islamin, me qëllim që të arrinte një vend ndër dijetarët e Kufes, të quajturit “kufij’jùn”, që të kishte një pozitë në mesin e tyre. Shpesh Ibn Seuda thoshte: “Teurati shprehet se për çdo profet ka një të porositur dhe se Aliu është i porosituri i Muhamedit.” Pastaj shtonte se Aliu është më i miri i të porositurve, ashtu siç është edhe Muhamedi (*Paqja dhe*

¹¹ Tefsiri “El Menâr”, i autorit Sej’jid Muham’med Reshijd Ridà, vëll. 10, f. 386.

bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!) më i miri e më i nderuari i profetëve.”

Disa prej shkrimtarëve selefij kanë përmendur se Ibn Seuda ishte prej dashamirësve të jehudive, kishte qëllime të këqija ndaj Islamit dhe lakmonte të prishte Islamin, me anë të interpretimeve që bënte për Aliun e për djemtë e Aliut. Ai shprehej se do të vazhdonte në këtë drejtim, derisa myslimanët të thoshin për Aliun, ashtu siç thonë kristianët për Isain.

Gjithashtu kanë thënë: “Rafiditë u zhytën në mohim më shumë se sa të tjerët që ndiqnin dëshirat. Rafiditë morën anën e Ibn Seudas dhe shkarjet e tyre në rrugën e humbjes u përzier me interpretimet e tij.”¹²

Gjithashtu kanë thënë: “Në të vërtetë, atyre u thuhet “rafidij”, sepse refuzuan Ebu Bekrin dhe Omerin.” Më pas, në lidhje me rafiditë, kanë shtuar: “Të paralajmëroj që të ruhesh prej dëshirave të rrugës së gabuar. Më të këqijtë e kësaj rruge janë rafiditë. Ata janë jehuditë e këtij ymeti. Ata e urrejnë Islamin, ashtu siç urrejnë jehuditët Kristianizmin. Ata nuk kanë hyrë në Islam as prej dëshirës e as se kishin frikë Allahun. Ata hynë në Islam, sepse i urrenin

¹² “Elferku bejnel-fireki”, autori Ebu Mensur Abdulkahir Elbagdadij (vdekur në vitin 1429 të Hixhretit), K. 4, f. 241, Botuar në Tabriz, në vitin 1333 të Hixhretit, përkthim prej gjuhës perse.

myslimanët dhe dëshironin të fusnin degjenerimin midis tyre. Ali ibn Ebu Talibi i dogji ata në zjarr dhe i shporri prej vendeve. Prej këtyre jehudive është edhe Abdullah ibn Sebe, të cilin ai e internoi në Sabat, kurse Abdullah ibn Seb'babî e internoi në Elxhazir.¹³

Disa prej tyre, nëpërmjet fjalës së tij, stisën një kuptim tjetër për ndjekësit e rafidive. Pastaj flitet për ndihmë të ndërsjellë mes Abdullah ibn Sebes dhe zjarradhuruesve persianë, me qëllim prishjen e Islamit, me pretendimin e rremë se çdo gjë që ishte e lejuar për Ibn Seben, ishte vetëm prej rafidive e zjarradhuruesve.

Ai thotë: “Shi’itët ekstremistë e refuzuan Imam Zejdin, kur ai pranoi atë që i kishin vënë si kusht për ndjekësit e tij. Kushti ishte se ata s’kishin përgjegjësi për Ebu Bekrin e për Omerin, prandaj edhe u quajtën *rafidij-refuzues*. Përse ata vunë kusht mospasjen përgjegjësi ndaj Ebu Bekrit e Omerit, por jo ndaj Uthmanit, madje edhe ndaj Muavijes e Jezidit? Shumica e shi’ave të sinqertë, të mëparshmit e të mëvonshmit, nuk e njihnin këtë gjë. Sikur të mendonin për këtë, me siguri që do ta njihnin dhe, në sajë të kësaj njohjeje, do të mësonin si i mori rryma e

¹³ Shiko parathënien e librit “Es’savàikul-muhrikatu”, (botim i ri), f. 6; “Muhàdaràtun fîj tàriikhil-umemil-islamij’jeh”, vëll. 2, f. 97.

“El-akdul-ferijd”, autori Ibn Abd Rab’beh El-endulusij (vdekur në vitin 328 të Hixhretit), vëll. 1, f. 350 dhe f. 353, Botim i dytë, Egjipt.

intrigave të zjarradhuruesve anëtarët e shoqatave sekrete islame, të quajtura “bàtinijeh”, shoqata që vepronin për t’u hakmarrë kundër zjarradhuruesve. Zjarradhuruesit përhapën intrigat e tyre te Shi’izmi, me qëllim që të përçanin myslimanët dhe të zhduknin bashkimin, themelet e të cilit u ndërtuan mbi lavdinë e Islamit.”

Më pas ai shton: “Në të gjithë botën nuk gjenden shoqata me organizim më të përpiktë e me objektiva aq të qarta sa shoqatat e fshejta që themeloi jehudiu Abdullah ibn Sebe dhe zjarradhuruesit (mexhuxhët) për të shkatërruar fenë islame e për të zhdukur sundimin e thirrësve arabë. Janë pikërisht këta, Abdullah ibn Sebe dhe zjarradhuruesit, që kanë futur intrigat për përkrahësit e familjes së të Dërguarit.”¹⁴

Më poshtë, kur do të flasin për luftën e Ebu Dherrit kundër sundimtarëve të fisit beni Umej’jeh¹⁵, do të shikojmë se ky sahab i nderuar mendohej të vinte bazat e drejtësisë shoqërore, në kuptimin e saj të vërtetë.

¹⁴ Tefsiri “El Menar”, vëll. 8, f. 225. Prej kuptimit të saktë të fjalës “rend”-“refuzim” dhe të fjalës “ràfidij”-ndjekës të shkollës së rafidive, mundësohet kthimi në kumtesën me titull “Cilët janë rafiditë?”, përkthyer prej Ali Rida Khasravanij, Botuar në Teheran.

¹⁵ Shiko librin “Esh’shijatu uet’teshej’juë”, autori Et Tabàtài, Botuar në Kum, Iran, prej Qendrës së Studimeve Islame, Sektori i Shpjegimeve; Subjekti “Beni Umej’jeh”, përgatiti dhe paraqiti Sej’jid Hadij Khasrushahij.

Gjithashtu, do të shikojmë se ai ishte një zë jehues kundër shpërdorimeve të sundimtarëve të fisit beni Umej'jeh dhe kurtheve që ata ngrinin kundër zotëruesve të thesareve dhe pasanikëve të mëdhenj të kohës së tyre. Të tjerë kanë shkuar deri aty sa të thonë se ishte Ibn Sebe ai që e vuri në lëvizje Ebu Dherrin të ngrihej hapur kundër sundimtarëve të fisit beni Umej'jeh.

Në veprën “Tarijkhu Tabarij” thuhet: “Shuajbi ka transmetuar prej Sejfit, prej Atij'jeh, prej Jezid Elfak'asij: “Kur Ibn Seuda erdhi në Sham, aty u takua me Ebu Dherrin, të cilit i tha: ‘O Ebu Dherr, a nuk çuditesh me Muavijen, kur thotë: ‘Pasuria, pasuria është e Allahut?’ A nuk është çdo send i Allahut? Me këtë fjalë ai sikur ka qëllim ta mbajë pasurinë për vete dhe të mos i japë asgjë myslimanëve, madje ai dëshiron ta fshijë fare emrin e myslimanëve.”¹⁶

Në librin “Fexhrul Islàm”, autori Muham'med Emijn citon tekstin e treguar prej Taberijit. Do të shikojmë se askush përveç Taberijit nuk e ka përmendur ndodhinë e Ibn Sebes, domethënë se për asnjë tjetër nuk thuhet se ka dhënë njoftim për atë ngjarje, ose të kundërtën e asaj dhe se të gjithë historianët këtë lajm e kanë marrë vetëm prej Taberijit.

¹⁶ “Tarijkhu-t'taberij”, vëll. 3, f. 335, ngjarjet e vitit 30 të Hixhretit; Referohu në “Dàiretul-meàrif”, Ferijð Vexhdij, vëll. 6, f. 160.

Më pas ai citon prej Taberijit: “Ibn Seuda u takua me Ebu Dherrin, të cilin e nxiti, por atë e mori Ubadehin dhe e çoi te Muavija, të cilit i tha: “Pasha Allahun! Ky është ai që e ngriti Ebu Dherrin kundër teje.”

Më pas Ahmed Emijn komenton: “Ne e dimë se me epitetin ibn Seuda është quajtur Abdullah ibn Sebe, i cili ishte prej jehudive të San’asë, i cili në kohën e Uthmanit u hoq se kishte pranuar Islamin. Gjithashtu dimë se ky person është munduar t’u prishë fenë e tyre myslimanëve.”

Më pas ai shton këto fjalë: “Mundësia më e afërme është se ai këtë ide e ka marrë prej ndjekësve të muzdakizmit të Iranit ose të Jemenit. Këtë musdakizëm e përqafoi Ebu Dherri, me qëllimin më të mirë. Duke besuar në këtë ide, ai formuloi përkohshmërinë e tij, duke shkatërruar vetveten, në një kohë që ai ishte njeriu më i pastër dhe njeriu më i përkorë në këtë botë, ishte prej personaliteteve më të dashura që kanë ndikuar te Sufizmi.”

Ç’THUHET PËR DOKTRINAT E IBN SEBES DHE PËR AKTIVTETIN E TIJ?

Një grup, shkrimtarë e studiues jo korrektë, kanë përmendur tregime e legjenda rreth ibn Sebes dhe grupit të sebive e doktrinëve të tyre. Disa prej doktrinëve të tyre do t’i paraqesim shkurtimisht, pastaj do të përmendim titujt e librave, ku shpjegohen tregime që kanë lidhje me ibn Seben.

Ata thonë: “Padyshim se stisësi i Shi’izmit është pikërisht Abdullah ibn Sebe.”¹⁷

¹⁷ “Fexhrul-Islàm”, f. 110-111; lexo “Tàrijkhul-Islàm”, autori, dr. Husejn Ibrahim Husejn, vëll. 1, f. 270 e më poshtë; “Fàrisul-Islàm”, autori, anglezi Gabriel, f. 184, Botuar në Teheran; Përgjigja për këtë fjalë do të vijë prej studiuesve dhe redaktorëve më në zë në fundin e këtij studimi.

Shiko librin “Fexhrul-Islàm”, autori Ahmed Emijn, f. 277, Botimi i dhjetë, Kajro; Shiko “Es’sun’netu uesh’shi’atu”, f. 4-6, autori Sej’jid Muham’med Reshijid Ridà, autori i tefsirit “El Menàr”. Është një kumtesë që ai e shkroi në përgjigje të librit “Elhusùnul-munijatu”, autori, i ndjeri Ajetull’llàh Es’sej’jid Muhsin El-Emijn El-àmili, në këtë kumtesë shton përgjigjet e dhëna prej shejhut Abdulhusejn El-Emijn,

Gjithashtu, ata kanë përmendur se Sebizmi është një prej grupeve shi'ite më të hershme, grupi më original në rrugëtimin e formimit të Shi'izmit dhe shfaqjes së shi'ave në historinë islame.¹⁸

Ata kanë përmendur se Abdullah ibn Sebe ka përhapur në mesin e myslimanëve tri punë që ata nuk i njihnin më parë dhe asnjë prej tyre nuk besonte në ato punë. Tri punët që ai përhapi janë:

1- Ai është i pari që tha: “Për çdo profet ka një të porositur (sipas tekstit të Taberijit) dhe se i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e bëri Aliun të porositur dhe imam.”

2- Ai është i pari që shfaqti besimin se Muhamedi (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) do të kthehet. Më pas e shohim se ai ndryshon fjalën, sipas tekstit të Ahmed Emijnit dhe tha se Aliu do të kthehet.

3- Ai është i pari që ka thënë se Aliu as nuk ka vdekur e as nuk është vrarë, por është gjithmonë gjallë.

në vëllimin e tretë të enciklopedisë së tij me vlera të larta “El Gadijr”, Botuar në Bejrut, f. 266 e poshtë.

¹⁸ Shejhu Sad Muham’med Hasan, “El Jehudij’jetu fil-Islàm”, Botuar në Kajro, cituar prej librit “Meshijkhatul-Ez’her” të Abdullah Es’sebijtij, f. 115-115, Botuar në Bagdad.

Vendbanimi i tij është te retë, bubullima është zëri i tij dhe vetëtima është buzëqeshja e tij. Siç shihet, me këto fjalë ai futi te Aliu një pjesë hyjnore, të cilën e bëri një me trupin e tij, duke thënë se do të vijë një kohë, kur ai do të shfaqet dhe do të mbushë botën me drejtësi, ashtu siç ishte ajo e mbushur me arbitraritet e tirani.¹⁹

Për ibn Seben ata thonë: “Ai lëvizte nëpër vendet e myslimanëve dhe përpiquej t’i çonte ata në rrugën e humbjes. Ndër të tjera, ai thoshte: “Çudi me atë që pretendon se Isai do të kthehet.” dhe përgënjeshtroi thënien se Muhamedi do të kthehet. Pastaj ai u thoshte myslimanëve: “Ka pasur një mijë profetë, çdo profet ka pasur një të porositur dhe Aliu është i porosituri i Muhamedit.”²⁰

Ata kanë përmendur se Abdullah ibn Sebe e hyjnzoi Aliun (*Allahu i ndriçoftë fytyrën!*) dhe se Aliu e largoi atë në vendet e largëta.

¹⁹ Tekstet janë shkëputur prej burimeve vijuese: “Mekālātul-islamij’jin”, f. 11, Parathënia e vëllimit të parë; Sad Muham’med Hasan, “El Mehdevij’jetu fil Islām”, f. 76; Muham’med Ferijd Vexhdij, “Dàiretul-meàrifi”, f. 6, Botuar në Egjipt, në vitin 1356 të Hixhretit; Ahmed Emijn, “Fexhrul-Islām”, vëll. 1, f. 310 e në vijim; “Tàrijkhu-T’taberij’ji”, vëll. 3, f. 378 (ngjarjet e vitit 35 të Hixhretit).

²⁰ Shiko: “Muhàderàtun fij tarijkhil-Islām”, autori, shejhu Muham’med Elkhidrij bek, vëll. 2, f. 97-98, Botim i dytë; “Tàrijkhul-Islām”, autori, dr. Hasan Ibràhijm Hasan, vëll. 2, f. 1-2; Teksti i librit është marrë prej Taberijut vëll. 3, 378, ngjarjet e vitit 35 të Hixhretit.

Ndër të tjera, ata kanë përmendur se Ibn Sebe, për të drejtën e Aliut, ka thënë se Ibn Sebe ishte jehudi, që akoma nuk e kishte pranuar Islamin, madje ai nuk besonte as te Musai e as te Jusha ibn Nunin.

Ata thonë se Ibn Sebe thoshte: “Aliu (*Allahu i ndriçoftë fytyrën!*) as nuk ka vdekur e as nuk është vlarë dhe se Ibn Mulxhemi, në të vërtetë, vrau një shejtan me fytyrën e Aliut dhe se Aliu (*Allahu i ndriçoftë fytyrën!*) është te retë. Bubullima është zëri i tij dhe vetëtimja është drita e tij, ose buzëqeshja e tij. Ata, sebijtë-ndjekësit e Ibn Sebes, kur dëgjojnë bubullimën, thonë: ‘Alejkes selamu ja emijrel muëminijne’-‘Paqe e shpëtim për ty, o Prijës i besimtarëve!’”²¹

Ata kanë thënë: “Më pas puna u zgjerua në kohën e udhëheqjes së Aliut, kur doli sheshit grupi i sebive, të cilët shanin, me përjashtim të një pakice prej tyre, sahabët e të Dërguarit të Allahut, duke thënë se ata ishin mohues e hipokritë, prandaj ata s’mbanin asnjë përgjegjësi ndaj tyre. Natyrisht që Imam Aliu nuk mban asnjë përgjegjësi për fjalët që thoshin sebijtë.

²¹ Niëmetu-ll’Ilàh El-xhezàirij (dijetar i njohur në fushën e hadithit), “El-envàru-n’nuëmànij’jetu”, vëll. 2, f. 234, Botuar në Tabriz, Iran; “El-Ensàb là Sem’ànij”, vëll. 2, f. 209, Botim i parë, Shtëpia botuese “Dàrul-xhinàn”, viti i botimit 1408 të Hixhretit.

Padyshim që Ibn Seben, në thirrjen e tij, e kanë ndihmuar edhe të tjerë prej ndjekësve të rrymës që ai stisi, por është ndihmuar edhe prej udhëheqësve kristianë, udhëheqësve idhujtarë e udhëheqësve adhurues të engjëjve. Më pas kjo punë erdhi duke u zgjeruar, derisa prej tyre doli një grup që pretendoi hyjninë për zotërinë tonë, Aliun (*Allahu i ndriçoftë fytyrën!*). Aliu kishte dijeni për punën e tyre dhe për këtë i luftoi ata. Por pas kalimit të zotërisë sonë, Aliut, puna u zgjerua, derisa grupet e shi'ave, ndjekës të Aliut, u ndanë në njëzet e katër grupe. Sipas asaj që ka përmendur El-adhedij'ji, zejditë dhe imamitë janë të moderuar dhe nuk janë ekstremistë.²²

Ata kanë përmendur se Abdullah ibn Sebe, ose Ibn Seuda, është jehudi, me origjinë prej jehudive të Jemenit, përqafoi Islamin dhe hiqej se ishte me besim të thellë, lëvizte shumë dhe ka parë vendet e Azisë së Vogël dhe një pjesë të vendeve të Afrikës, që ishin të mbuluara me dritën e Islamit. (Mendoj se do plotësohej fjalja me fjalën Islamit. Pasi me lart, me fjalën dritë, përshkruante Islamin.) Ai filloi të zgjojë njerëzit dhe t'i bëjë ata të lëvizin. Më vonë aktiviteti i tij fitoi një natyrë politike të ashpër. Gjatë qëndrimit të tij në Egjipt, filloi të flasë kundër punëve të halifes dhe në fjalimet e tij filloi të paralajmërojë halifen

²² "Parathënia" e botimit të ri të librit "Es'savàikul-muhrikatu firr'rredi alà ehlil-bidei uez'zendekati", shkruar prej Ibn Haxher Elhejtemij; "Parathënia" e shkruar prej Abdulveh'hàb Abdul'letijf, f. 6, Botuar në Egjipt, në vitin 1375 të Hixhretit.

Uthman, që të mos vazhdonte të mbante postin e halifes, pasi këtë post duhet ta mbajë vetëm Ali ibn Ebu Talibi dhe askush tjetër.

Oratoria e Ibn Sebes luajti rolin e saj në tërheqjen e njerëzve dhe në shtrëngimin e radhëve rreth tij. Njerëzit u mblodhën rreth tij, filluan të shenjtërojnë doktrinën e tij dhe, kur Ibn Sebe e ndjeu veten të sigurt për statusin e tij dhe për pozitën që arriti, filloi të heqë maskën e të zbulojë fytyrën e tij të vërtetë. Nëpërmjet fjalimeve ai shpalosi para njerëzve të vërtetën e doktrinës së tij, doktrinë, që, në të vërtetë, ishte një amalgamë mes bazave të doktrinës jehude, mendimeve të jehuditëve dhe mes bazave të Islamit e dispozitave islame. Kështu ai filloi të propagandojë idenë e “ritrupëzimit” të shpirtave.

Më pas, gjatë kohës që predikonte në xhaminë e madhe të qytetit Fustat, ai filloi të atakojë doktrinën kristiane për rikthimin e Mesihut, duke shprehur habinë e tij ndaj kujt do që vërteton se Mesihu do të rikthehet në kohën e fundit dhe se do të shtrijë ndikimin e tij mbi të gjithë njerëzit. Ibn Sebe e përgënjeshtroi kthimin e Mesihut dhe foli hapur se Mesihu nuk do të rikthehet, por ai që do të rikthehet është Muhamedi.

Ibn Sebe tejkaloi të gjitha caqet e rregullat dhe shpalli se Muhamedi është prej esencës së hyjnisë. Ajo që e ndihmoi Ibn Seben të dalë si individ unik dhe të izolonte të

tjerët, ishte kultura e gjerë që kishte në çështjet e Judaizmit, Islamit e Kristianizmit, si dhe njohuritë që kishte për fetë e Iranit e të Indisë, madje edhe për fenë në Egjiptin e lashtë. Brenda një kohe të shkurtër Ibn Sebe u bë njeriu me më shumë ndikim në Egjipt, aq sa qeveritari filloi të ketë frikë e të dridhet prej tij.

Në të vërtetë, Sebizmi u nda në grupe të shumta. Disa prej tyre shkuan deri atje sa të besojnë se Aliu përdor retë për mjet hipjeje dhe se ai do të kthehet në tokë për herë të dytë. Disa të tjerë, prej sebive, besonin se Aliu lëshon rrufetë e bubullimat mbi kokat e njerëzve të këqij.

Të tjerë prej atyre pretenduan se Aliu është dielli, disa të tjerë pohonin se figura e hënës është e përfaqësuar në figurën e Aliut.²³

Ata kanë përmendur se kryengritja kundër Uthmanit erdhi në sajë të lëvizjes që organizoi Ibn Sebe dhe se ai ishte personi që u thoshte me ngulm njerëzve se Uthmani e mori postin padrejtësisht. I nxiste njerëzit të

²³ Libri “Shejhsivà Islām”- “Kalorësi i Islamit”, autor, anglo-francezi Gabriel, përkthyer prej Kadhim Imadijit, Botuar prej Enxhemen tebliğât Islāmij, Teheran, viti 1326 Hixhreti, f. 76-78 dhe 185, teksti është përkthyer dhe është botuar prej shkrimtarëve të Komisionit të Studimit të Historisë Arabe në Kajro.

ngriheshin për këtë punë, të lëviznin dhe të fillonin të godisnin sundimtarët e tyre.²⁴

Gjithashtu ata kanë thënë se Abdullah ibn Sebe pengoi arritjen e paqes mes Aliut e Aishes, kur ajo ishte në krye të ngjarjeve që ndodhën në Luftën e Devesë.²⁵

Përveç këtyre fjalëve që i atribuohen atij, ka edhe thënie të ardhura prej autorëve të tjerë, të cilët i kanë mbledhur thëniet e tyre në formën e tregimeve, mendimeve e doktrinave të tjera. Ne nuk do t'i përmendim, duke pasur kujdesin që të mos zgjatemi me të tilla thënie. Megjithëkëtë kjo nuk na ndalon të tregojmë titujt e librave që ata kanë shkruar, me qëllim që personat që dëshirojnë më shumë hollësi, mund t'i referohen librave të mëposhtëm:

²⁴ Lexo librin "Uthmà ibn Af'fàn" i Sàbir Abdeh Ibràhijm, f. 56 e në vijim, Botim i dytë, Botuar në Bagdad; Gjithashtu lexo librin "Zubejr ibn El-av'vàm" i të njëjtit autor, f. 31058, Botim i parë; Lexo librin ""Elkàmil" të Ibn Kethijrit, vëll. 3, f. 77, Botim i vitit 1356 Hixhreti; Ferijd Vexhdij, "Dàiretul-Meàrifi", vëll. 6, f. 163.

²⁵ Sàbir Abdeh Ibràhijm, "Am'màr ibn Jàser", f. 58; "Zubejr ibn El-Av'vàm", f. 50-51; Shiko edhe librin "Vua'adhu-s'selàtijn" të Ali Elverdij, f. 111, marrë prej të tjerëve, Botuar në Teheran.

1. Ibn Kethir, “Elbidàjetu uen’nihàjetu” – “Fillimi e mbarimi”, vëll. 7, f.167.
2. Mijr Khuvàned, “Reudatu-s’safà” – “Kopshti i kulluar”, f. 721, Botim i ri, Botuar në Kom, Iran, në vitin 1379 të Hixhretit.
3. Elbustànij, “Dàiretul-Meàrifi” – “Rrethi i diturive” vëll. 11, f. 506, Botuar në Liban.
4. Prof. Nikolson, “Et’tàrijhkhul-arebij” – “Historia arabe”, f. 215.
5. Duajt M. Donaldson, “Akijdet-sh’shi’ati” – “Doktrina shi’ite”, f. 85.
6. Ibn Hazm Edh’dhàhirij El-Endulusij, “Efaslu bejnel-mileli uel-ehvài uen’nehali” – “Ndarja mes feve, dëshirave e pretendimeve”, Botim i parë, vëll. 2, f. 33 dhe vëll. 4, f. 138.
7. Mbreti i këshilluesve, Shirazi, libri në gjuhën perse “Shubhàj Bijshàver”, në gjuhën arabe “Lejàlij Bijshàver” – “Netët e Bishaverit”, f. 171 e në vijim.
8. Pjesa e fundit e librit “El-islàmu bejne-s’su’neti uesh’shi’ati” – “Islami ndërmjet Sunetit dhe Shi’izmit”, me

autorët Hàshim Defterdàr Elmedenij dhe Muham' med Ali Ez'zaëbij.

9. "Lisànul-mijzàn" – "Gjuhëza e peshores", autori Shihàbu-d'dijn ibn Ebul-fadl Ahmed ibn Ali ibn Haxher El-Askalànij (vdekur në vitin 725 të Hixhretit), f. 289-290, Botim i tretë, Botuar në Hajdar Abàd Deken, Hindi, në vitin 1330 Hixhreti.

10. Ibn Ebul-Hadijd, "Sherhu Nehxhul-Belàgah" – "Komenti i Nehxhul Belagah", vëll. 2, f. 485-486.

11. "Fireku-sh'shijati" – "Grupet e shi'ave", autori i këtij libri thuhet se është Muham' med Hasen ibn Mùsà En'nubekhtenij, f. 22-23, Botuar në Nexhef Eshref.

12. Esh'shejherstànij, "Elmilelu uen'nehalu" – "Grupe dhe pretendime", vëll. 1, f. 289-290, Botim i parë në gjuhën arabe, në vitin 1368 Hixhreti.

13. Dr. Husejn Ali Mahfùdh, "Tàrijkhu-sh'shij'ati" – "Historia e shi'ave", f. 39, Botuar në Irak, në vitin 1377 Hixhreti.

14. El-Esferàijijnij, "Et'tebsijr" – "Ndriçimi", f. 71-72.

15. Err'rràzij, "Iëtikàdàtu firekil-muslimijne" – "Besimet e grupeve islame", f. 57.

16. Ebul-Hasen Elmeltij, “Et’tenbijhu” – “Tërheqja e vëmendjes”, f. 25 dhe f. 148.

17. Xherxhànij, “Et’taërijfàt” – “Tabelë njoftimesh”, f. 79.

18. Muham’med Kurd Ali, “El-Islàmu uelhadàretul-arebij’jetu” – “Islami dhe qytetërimi arab”, vëll. 2, f. 60.

19. Orientalisti gjerman, Fon Floten, “Tàrijkhu-sh’shijati, eu Esbàbu sukùti benij umej’jeh” – “Historia e shi’ave, ose shkaqet e rënies së beni Umej’jeh”, libri është në gjuhën perse, përkthyer prej Es’selj’jid Murtedà Elhàshimij Elhàirij, f. 96 e në vijim, Botuar në Teheran, në vitin 1325 të Hixhretit.

20. Ali Asgar Muaz’zezij, “Teëthijrul-khilàfeti fij ibnàil-Islàm” – “Ndikimi i hilafetit në strukturën e Islamit”, f. 160, libri është në gjuhën perse, Botuar në Teheran, në vitin 1337 Hixhreti.

21. Prof. Xhorxh Xhordak, “El-imàmu Ali sautul-adàletil-insànij’jeti” – “Imam Aliu, zëri i drejtësisë njerëzore”, vëll. 4, f. 894 e në vijim, K. “Aliu dhe koha e tij”, Botuar në Liban.

22. Përkthim prej gjuhës perse i librit “Elferku bejnel-fireki” – “Dallimi ndërmjet grupeve”. Ky libër është

botuar me titullin “Historia e medh’hebeve islame”,
përkthyer nga dr. Muham’med Xhev’vâd Meshkûr,
pedagog në universitetin e Tabrizit, f. 17, 32, 41 dhe f. 240 e
në vijim, Botuar në vitin 1333 të Hixhretit.

RRËNJËT HISTORIKE TË LEGJENDËS

IBN SEBE

PIKËPAMJET E STUDIUESIT ES'SEJ'JID MURTEDA EL-ASKERIJ

Dijetari bashkëkohës, Es'sej'jid Murteda El-Askerij, është prej studiuesve investigues, që ka trajtuar këtë çështje dhe ka vërtetuar se tregimi rreth legjendës Ibn Sebe është thjesht fantazi, që s'ka asgjë të përbashkët me realitetin.

Këtë investigim gjithëpërfshirës, Es'sej'jid El-Askerij e ka bërë në bazë të një studimi të zgjeruar rreth tregimit të Ibn Sebes dhe rezultatet e studimit kanë ardhur në një libër voluminoz, në dy vëllime, të botuara me titull: "Abdullah ibn Sebe dhe legjenda të tjera."²⁶

²⁶ Botimi i parë i vëllimit të parë të këtij libri ka dalë në vitin 1375 Hixhreti në Nexhefi Eshref në Irak. Më pas është ribotuar në Kajro, kurse vëllimi i dytë ka dalë në Teheran dhe më vonë në Bejrut. Në

Ky studiues i dëgjuar ka vërtetuar me argumente historike të padiskutueshme se burimi i kësaj legjende iluzionare është “Historia e Taberijit”, histori të cilën Taberiji e ka marrë prej një burimi që reduktohet me përcjellësin Sejf ibn Omer Et’temijmij Elkùfij, rreth ngjarjeve të viteve 30-36 Hixhreti.

shumicën e rasteve kemi ndjekur Taberijin për emërtimin “tregim” të fjalëve të Sejfit.

TABERIJI DHE KU ËSHTË MBËSHTETUR AI

Kemi gjetur të gjitha librat që i referohen Taberijit, kur prej tij shkruhet për Abdullah ibn Seben dhe për sebijtë. Këtu lind pyetja: Cili është burimi ku është bazuar Taberiji, që ka sjellë këtë tregim në “historinë” e tij?

Imam Ebu Xhafer Muhamed ibn Jezid ibn Khalid ibn Xherijr Et’taberij El-Amilij, vdekur në vitin 310 Hixhreti, e ka sjellë tregimin rreth sebijve në librin e tij me titull “Historia e kombeve dhe e mbretërve”, duke u kufizuar vetëm në burimin e përcjellë prej Sejf ibn Omer Et’temijmij dhe, duke folur për ngjarjet e viteve 30 Hixhreti, thotë: “Në këtë vit, domethënë në vitin 30 Hixhreti, kanë ndodhur edhe ato që përmenden për punën e Ebu Dherrit e Muavijes, sidomos veçimi vetëm i Muavijes në ato punë të shumta, të cilat kam neveri t’i përmend. Ata që përligjin Muavijen në këto punë, kanë përmendur fjalën “tregim”, të cilin ma dërgoi të shkruar Siriu.

Në atë shkrim ai përmend se Shuajbit i ka folur Sejfu-d’dijn ibn Omerit prej Atij’jeh, prej Jezid Elfak’asij dhe ka thënë: “Kur Ibn Seuda erdhi në Sham, u takua me

Ebu Dherrin, të cilit i tha: ‘O Ebu Dherr, a nuk të çudit Muavija?’

Transmetimi vazhdon.

Më pas Taberiji sjell në “historinë” e tij tregimin për takimin e Ibn Sebes me Ebu Dherrin vetëm me rrugën e përcjelljes sipas Sejfit, pastaj e mbyll jetëshkrimin e Ebu Dherrit, duke thënë: “Të tjerët, në të vërtetë, për shkakun e kësaj ndodhie kanë treguar shumë gjëra e shumë punë të lemerishme, që unë kam neveri t’i përmend.”

Duke folur për ngjarjet e viteve 30-36 Hixhreti, ai sjell edhe tregimin për rolin e Ibn Sebes e të sebijve në vrasjen e Uthmanit e të Luftës së Devesë, të nxjerra gjithnjë vetëm me rrugën e përcjelljes prej Sejfit. Për këto tregime, Taberiji s’ka burim tjetër përcjellësish. Meriton të theksohet se për Taberijin, përveç përcjelljeve, sipas Sejfit, ka edhe dy burime të tjera përcjelljeje njoftimesh. Këto dy burime janë:

a) Ubejdu-ll’lloh ibn Sejd Ez’zehrij, prej xhaxhait të tij, Shuajb ibn Ibrahim, prej Sejfit. Ajo që ka nxjerrë Taberiji, prej bisedave të Sejfit, me këtë burim përcjellje, është thjesht një bisedë gojore.

b) Sirij ibn Jahja, prej Shuajb ibn Ibrahimit, prej Sejfit. Edhe me këtë varg përcjellësish Taberiji i sjell bisedat e përcjella prej Sejfit, në librin e tij “Elfutuhu

uerr' rred'detu" - "Luftërat çlirimtare dhe renegatizmi" dhe në librin tjetër të tij me titull "Deveja dhe jetëshkrimi i Aishes". Në këto dy libra, për përcjelljen prej Sejfit, ai thotë: "Më shkroi mua." Por edhe me këtë rrugë përcjellësish, që përfundon te Sejfi, Taberiji përsëri ka nxjerrë vetëm biseda gojore dhe asgjë më shumë.

Përcjellja e Sejfi ibn Omerit, ashtu siç thuhet në "historinë" e Taberijit, është transmetimi i vetëm, i përcjellë për tregimin për Ibn Seben, prandaj është rasti të bëjmë një vëzhgim të shpejtë mbi këtë person, të quajtur Sejfi dhe mbi vlerën e transmetimeve të ardhura sipas përcjelljes së tij. Këtë vëzhgim do ta bëjnë nën dritën e asaj që kanë përmendur dijetarët biografë.

CILI ËSHTË SEJFI?

Ai është Sejf ibn Omer Et'temijmij Elkùfij. Kështu është shprehur për këtë person autori i librit “Elfutùhul-kebijr uerr’rred’detu”-“Luftërat e mëdha çlirimtare dhe renegatizmi”, si dhe autori i librit “Elxhemelu ue mesijru Àishete ue Alij”-“Deveja dhe jetëshkrimi i Aishes e i Aliut”. Ky autor ka vdekur në vitin 170 të Hixhretit, në kohën e sundimit të Harun Err’rreshijdit.

Ne njohim atë që dihet se çdo përcjellës transmetimesh konsiderohet i plotësuar, duke iu referuar librave të burrave (librat me jetëshkrimin e burrave) dhe vetëm me këtë rrugë del qartë personaliteti i përcjellësit të transmetimit, gjithashtu bëhet e qartë edhe vlera e transmetimeve që ai ka përcjellë.

Dijetarët, autorë të jetëshkrimeve, ashtu siç e ka cituar këtë Ibn Nedijmi, në “Elfihreset”-“Përmbajta e lëndës”, f. 137 dhe Edh’dhehebij’ji në “Mijzànul-iëtidàli”-“Peshorja e maturisë”, vëll. 1, f. 438, nr. 3581, si dhe në librin “Tehdhijbu-t’tehdhijb”-“Edukimi i edukimit”, vëll. 4, f. 298, thuhet qartë se transmetimet e përcjella prej të quajturit Sejf, janë të gradës “Daijf” dhe si përcjellës

njoftimesh ai është i lënë. Për rrjedhojë, atij nuk i kushtohet asnjë rëndësi, sepse ka përcjellë prej personave të panjohur. Prandaj, si përcjellësh njoftimesh, Sejfi s'ka asnjë peshë dhe në përgjithësi transmetimet e përcjella prej tij s'kanë asnjë vlerë. Ai ka përcjellë punë të urryera dhe është akuzuar për vënie të qëllimshme dhe për herezi.²⁷

Në librin “El-Isàbetu” – “Zgjidhja” dhe në librin “El-Istij’ab” – “Përvetësimi”, thuhet se Sejfi, si përcjellësh njoftimesh, është klasifikuar i shkallës “Daijf” – “Dobët”, prandaj njoftimet e përcjella prej tij janë të lëna dhe konsiderohen se nuk janë asgjë.²⁸

Gjithashtu edhe ajo që ka bërë Xhelàlu-d’dijn Es’sejùtij në librin e tij “El’leàlil-masnùatu fil-ehàdijthil-meudùati” – “Perla të rreme në hadithet e vëna”, f. 233, thuhet se prej tij është përcjellë vetëm një njoftim. Më pas thotë: “Por edhe ky njoftim është i vënë, gjithashtu edhe përcjellësit e vargut të këtij njoftimi janë të gradës “Daijf” – “Dobët” dhe më shumë i dobët prej atyre është vetë Sejfi.²⁹

Edhe ne, nga na jonë, në mënyrë të shkurtër, nxjerrim si përfundim se Sejfi, sipas pikëpamjes së

²⁷ Shiko librin “Abdullah ibn Sebe”, vëll. 1, f. 17 dhe në librin “Elgadijr”, vëll. 8, f. 84-85.

²⁸ Lexo librat “El-Isàbetu”, vëll. 3, f. 230 dhe “El-Isàbetu”, vëll. 3, f. 252.

²⁹ Shiko librin “Abdullah ibn Sebe”, vëll. 1, f. 18, 140 dhe 141 dhe në librin “Elgadijr”, vëll. 8, f. 84-85.

dijetarëve biografë prej Ehli Syneetit që kanë shkruar jetëshkrimet e burrave, akuzohet si mohues dhe vënës i haditheve. Kjo është arsyeja që njoftime të përcjella prej tij nuk janë transmetuar në asnjë libër që mund të merret në konsideratë. Megjithëkëtë, vetëm Taberiji ka dashur të citojë prej tij në “Historinë” e vet. Në të vërtetë, tregimi për Ibn Seben, tregim të cilin e vërtetoi vetëm Taberiji, u shndërrua në burim për historianë jo investigues, që erdhën pas Taberijit.

Në vijim do të shikojmë tabelën që shpjegon qartë vargun e atyre që kanë përcjellë legendën për sebijtë dhe që ndryshon prej tregimit të Sejf Et’temijmij.

VARGU I PËRCJELLËSVE TË LEGJENDËS SË SEBIVE DHE STISËSIT E SAJ

Sejf ibn Omer Et'temijmij, vdekur pas vitit 170

Ata që kanë transmetuar sipas përcjelljes së tij

Ibn Asàkir (571)	Taberiji (310)			Edh' dhehebij (748)
	Ibn Ethijr (630)	Ibn Kethijr (774)	Orientalistët	
Ibn Ebu Bekr (741)	Ebul-Fidaë (732)	Ibn Khaldun (808)	Fon Floten Volhausen Ferijð Vexhdij	
Ibn Bedran (1346)	Reshijð Rida (1356)	Mijr Khavaned (903)	Rrethi i diturive Islame	
Seijð El-Efganij	Hasen Ibrahijm	Gaj'jathu- d' dijn (940)	Nikolson Duajt M. Donaldson	

Në këtë tabelë datat janë sipas kalendarit Hixhri

KAPITULLI I DYTË

ABDULLAH IBN SEBE NË MENDIMIN SYNI

Gjatë këtij rrugëtimi në histori, u bë e qartë se burimi i vetëm për tregimin rreth Abdullah ibn Sebes është “Historia” e Tabrijit, i cili e ka vërtetuar këtë tregim vetëm me rrugën e përcjelljes prej Sejf ibn Omer Et’temijmijit. Vepra “Historia” e Taberijit konsiderohet burimi i vetëm prej të cilit janë bazuar studiuesit e historianët.

Më sipër pamë se Taberiji ka folur në mënyrë të përgjithshme për Ibn Seben. Dihet se shkrimtarët e autorët që erdhën pas Taberijit shtuan mbi këtë tregim, duke bërë komente të ndryshme. Ata janë zgjeruar, pa u mbështetur në asnjë burim historik që mund të merret në konsideratë.

Është fakt se këto shtesa, me kalimin e kohëve, erdhën duke u shtuar. Nëse duam të flasim me një gjuhë më të qartë, mund të themi se shkrimtarët e autorët e

teksteve kanë përdorur gjuhën e akuzave e të shpifjeve, duke u shtuar pak e nga pak gjatë viteve, derisa historia e Abdullah ibn Sebes arriti në ditët tona. Ne shohim se disa prej shkrimtarëve, të gjitha doktrinat e shi'ave dhe mendimet e tyre ia atribuojnë Abdullah ibn Sebes, sa herë që lëshojnë akuza kundër shi'ave dhe Shi'izmit, pa pasur asnjë argument që të vërtetojë deri vetë ekzistencën e Abdullah ibn Sebes.

Më sipër vumë në dukje ato që thuhet për aktivitetet e tij të rreme në shumë treva të mëdha të shtetit islam, shtet të cilin, si bazë, ai e përshkruante si një lojë në shumë prej ngjarjeve që kanë ndodhur në historinë e këtij ymeti.

Krahasimi mes burimit të tregimit, ashtu siç ka ardhur në "Historinë" e Taberijit dhe mes formës që mori ky tregim në burimet e tjera pas Taberijit, për autorin vërtetojnë në një mënyrë që nuk lënë vend për dyshim se të gjitha doktrinat e shi'ave që i atribuohen Abdullah ibn Sebes, nuk janë gjë tjetër veçse akuza e shpifje të propaganduara prej liderëve të fanatizmit, me qëllim që të ushqejë politikën e përçarjes.

Por e drejta na detyron të themi: Shumë historianë e studiues prej vëllezërve tanë të Ehli Syneetit, me studimet e tyre kanë hequr maskën e lojërave të qëllimkëqijve, që lëshojnë vetëm sharje. Këta dijetarë e studiues nuk kanë

rënë pre e traditës së verbër të trashëguar dhe mjaft të përhapur. Në të kundërt, objektiviteti ka qenë qëllimi i tyre, për të evidentuar të vërtetën e rrugës së humbjes ku ranë akuzuesit e shpifësit. Këta dijetarë e studiues janë udhëhequr gjithmonë prej studimit shkencor e objektiv, të zhveshur prej të gjitha mendimeve të kohës së shkuar. E gjithë kjo punë e tyre ka dhënë rezultate të sakta. Në sajë të kësaj rruge studimi, ata kanë vërtetuar shterpësinë e opinioneve, me të cilat është rrethuar figura e Abdullah ibn Sebes, me të cilën stisësit kishin qëllim të mbillnin farën e përçarjes në ymetin islam.

Në vijim do të shpalosim mendimet e disa dijetarëve e studiuesve më në zë prej Ehli Syneetit, prej atyre dijetarëve që nuk kanë rënë nën ndikimin e propagandës së thurur rreth këtij të huaji, të quajtur Abdullah ibn Sebe. Në pararojë të këtyre dijetarëve islamë qëndron prof. dr. TaHa Husejn, prof. Hamid Hanefij dhe të tjerë. Po fillojmë me shpalosjen e mendimit të prof. dr. TaHa Husejn:

MENDIMI I PROF. DR. TAHA HUSEJNIT

Studiuesi e letrari prof. dr. TaHa Husejn, konsiderohet i pari që ka dyshuar për Abdullah ibn Seben, si dhe për rolin e rremë që i është mveshur atij në histori. Profesori arriti në këto përfundime, duke u nisur prej argumenteve të padiskutueshme, logjike e historike, për të cilët nuk mund të dyshohet.

Në vëllimin e parë të librit të tij “Elfitnetul-kubrà”- “Ngatërresa e madhe”, profesori fillon të hedhë pluhurin e dyshimit rreth Ibn Sebes. Më pas, në vëllimin e dytë, ai i rikthehet edhe një herë kësaj figure dhe e mohon ekzistencën e tij.

Ai thotë: “Disa janë shprehur se Ibn Sebe e përsosi mashtrimin e tij, ka lëvizur shumë nëpër territoret islame, ku organizoi grupe të fshejta, me qëllim që të fshihte mashtrimin dhe se këto grupe bashkëpunonin për të përhapur ngatërresa. Këto grupe të fshejta, të themeluara prej tij, e vazhduan përhapjen e ngatërresave, derisa arritën të ngrenë njerëzit kundër halifes. Rezultati i kësaj ngritjeje qe rrethimi i halifes e më në fund edhe vrasja e

Imamit të myslimanëve. Të gjithë ata, që me fanatizmin e tyre zmadhojnë punën e Ibn Sebes në librat e tyre, e dinë mirë se kanë vepruar shumë ashpër kundër vetes dhe kundër historisë.

Gjëja e parë që vërejmë në burimet e rëndësishme të historisë, që i përkasin punës së hilafetit e të kohës së Uthmanit, është se në këto burime nuk gjejmë të përmendet emri i Ibn Sebes, me përjashtim të Ibn Sadit, i cili e përmend Ibn Seben, kur tregon ngjarjet që ndodhën në kohën e hilafetit të Uthmanit dhe kryengritjen e njerëzve kundër tij. As Beladheriji nuk e ka përmendur Ibn Seben në veprën “Gjenealogjinë e burrave të nderuar”.

Për të gjitha këto që u thanë, unë mendoj se burimi më i rëndësishëm për historinë e Ibn Sebes dhe ai që ka dhënë më shumë hollësi për këtë person të kritikuar është Taberiji, i cili e ka cituar njoftimin për Ibn Seben sipas përcjelljes së Sejfi ibn Omerit. Duket qartë se historianët e mëvonshëm këtë tregim e morën prej Taberijit.

Unë nuk mendoj se një i huaj, i quajtur Ibn Sebe, përbënte rrezik në kohën e Uthmanit. Edhe sikur ai të përbënte rrezik, rreziku prej tij ishte fare i parëndësishëm. Veç kësaj, myslimanët në kohën e Uthmanit nuk ishin në atë gjendje sa mendjet e mendimet e tyre, në lidhje me pushtetin e tyre, t’i përpunonte një i huaj prej ithtarëve të librave të mëparshëm dhe që kishte pranuar Islamin në

kohën e Uthmanit. Për më tepër, ky i huaj nuk ishte i njohur si mysliman me influencë, që kishte mundësi të përhapte ngatërresa e të thurte kurthe në të gjithë anët e shtetit islam. Veç kësaj, sikur ky person i huaj e i rrezikshëm të ekzistonte, nuk ishte e vështirë që atë ta kapte Abdullah ibn Amiri, ose Muavija, të cilët natyrisht duhej të dinin se ai ishte jehudi dhe se Islamin e kishte përqaftuar, me qëllim që të dëmtonte myslimanët, patjetër që çdonjëri prej atyre të dyve, ose edhe të dy së bashku, do ta kapnin këtë person të rrezikshëm dhe do ta dorëzonin te Uthmani.”

Më pas ai shton: “Ai i shkroi Uthmanit që të kapte Ibn Ebu Bekrin, Ibn Ebu Hudhejfeh dhe Amar ibn Jaserin. Sipas disa njoftimeve, është një sajese e pafalshme, pasi nuk mund të lihej pa u dënuar një burrë i huaj prej ithtarëve të librave të mëparshëm, i cili hiqej se kishte pranuar Islamin, por që në të vërtetë punonte për të shkaktuar përçarjen në mesin e myslimanëve, të hidhte dyshime mbi imamin e tyre, madje të hidhte dyshime edhe në fenë e tyre.

Guvernatorët e krahinave e kishin fare të lehtë të ndiqnin këtë të huaj të rrezikshëm, ta kapnin dhe ta dënonin atë, pa harruar se ata ishin të përsosur në ndjekjen e kundërshtarëve. Dihet se guvernatorët e asaj kohe i kishin të gjitha mundësitë për t’i nxjerrë të huajt e

rrezikshëm jashtë vendbanimit, ose t'i dërgonin te Muavija apo te Abdurrahman ibn Khalid ibn Velijd.

A mund të këtë njoftim më të habitshëm se njoftimi që flet për këtë person, Abdullah ibn Sebe, që i foli Ebu Dherri për sjelljet e Muavijes, i cili, sipas këtij personi, kishte thënë se pasuria është e Allahut, madje u mundua të mësojë Ebu Dherrin se për Muavijen do të ishte më mirë të thoshte: "Pasuria, është pronë e myslimanëve."³⁰

Veç kësaj, thuhet se ai është përpjekur t'i mësojë Ebu Dherri rrugën e tij të kritikës, drejtuar personave me pasuri të madhe dhe të pasurve, në përgjithësi. Jo vetëm kaq, por të njoftonte Ebu Dherrin se të gjithë ata që mbanin thesare prej floriri e argjendi të groposura në tokë, e kishin vendin në Xhehenem dhe se me thesaret që kishin, atyre do t'u digjej balli, lëkura e shpina.

Unë nuk di të ketë ndonjë teprim të ngjashëm me teprimin se Ebu Dherri të kishte nevojë që një person i huaj, i sapo hyrë në Islam, t'i mësonte atij se të varfrit kishin të drejta për të marrë prej të pasurve dhe se Allahu i Lartësuar njoftonte për ndëshkimin e dhimbshëm që i priste ata që kishin thesare floriri e argjendi të groposura

³⁰ Lexo "Tàrijkhu-t'taberij", vëll. 3. f. 378, Botuar në Bejrut, në vitin 1418 të Hixhretit, prej shoqatës shkencore.

në tokë dhe nuk e shpenzonin atë pasuri në rrugën e Allahut.

Gjithashtu, Ebu Dherri nuk kishte nevojë që ky i huaj t'i mësonte atij këto të vërteta parësore të Islamit. Dihet se Ebu Dherri është i pari ndër të gjithë ensarët që kishte pranuar Islamin, madje ai e kishte pranuar Islamin edhe më parë se shumë prej muhaxhirinëve. Nuk duhet harruar se ai është personi që ka shoqëruar më gjatë të Dërguarin dhe se ai e mësoi Kur'anin përmendësh në mënyrën më të bukur. Gjithashtu, ai ka përcjellë në mënyrë të përsosur shumë hadithe.

Ata që mashtrojnë dhe thonë se Ibn Sebe është takuar me Ebu Dherrin dhe se i ka dhënë mësimë atij, në radhë të parë, bëjnë padrejtësi ndaj vetes dhe pastaj ndaj Ebu Dherrit.

Përcjellësit e njoftimeve thonë se Ebu Dherri, pasi ishte kthyer në Medinë prej Shamit, i tha një ditë Uthmanit: "Ai që e ka dhënë zekatin, nuk duhet të mjaftohet vetëm me kaq, por duhet t'i japë edhe lypësit që shtrin dorën, të ushqejë të uriturin dhe të shpenzojë prej pasurisë së tij në rrugën e Allahut."

Thuhet se në këtë bisedë u ndodh edhe Kab el-Ahbar, i cili e ka përqaftuar Islamin shumë kohë para Ibn Sebes. Veç kësaj, Kab el-Ahbar ishte banor i Medines dhe

gdhihej e ngrysej në mesin e sahabëve të Profetit. Gjithashtu, Kab el-Ahbar ka bashkëpunuar me Omerin e me Uthmanin, prandaj nuk kishte nevojë të merrte prej Abdullah ibn Sebes ndonjë bazë prej bazave të Islamit, ose ndonjë dispozitë prej dispozitave të Kur'anit. Është e çuditshme që një burrë prej sahabëve të Profetit të mohojë për Kab el-Ahbarin, diskutimin për çështje të fesë dhe pastaj vetë të marrë mësimë feje prej Abdullah ibn Sebes.

Profesori vazhdon: “Gjithashtu, mendja anon më shumë kah fakti se armiqtë e shi’ave, gjatë kohës së sundimit të dinastisë së emevitëve dhe dinastisë së abasitëve, kanë thënë gjëra të zmadhuara për Abdullah ibn Seben, me qëllim që, nga njëra anë, të ngjallnin dyshime në disa punë që ai i atribuonte Uthmanit e qeveritarëve të tij të krahinave dhe, nga ana tjetër, të ishin të ashpër ndaj Aliut e ndaj atyre që shprehnin simpati për Aliun. Në këtë fushatë shpifjesh ata, për disa punë të shi’ave, thoshin se shi’at i kanë marrë prej një jehudiu, i cili pranoi Islamit, me qëllim që të dëmtonte myslimanët. Janë të shumta e të lemerishme ato që janë thënë prej armiqve kundër shi’ave e kundër Shi’izmit.

Është shumë më mirë që ndaj këtij tregimi të stisur të mbajmë një qëndrim të rezervuar dhe le të zmadhojmë myslimanët e brezit të parë, në vend që të themi se një i huaj i ardhur prej San’aë, me baba jehudi dhe me nënë

zezake, një jehudi, që e pranoi Islamin jo ngaqë kishte dëshirë e as që kishte frikë, por vetëm që të përhapte punë e fjalë të urryera dhe të kurdiste kurthe e mashtrime. Por, si ka mundësi të thuhet që një person i tillë të jetë në gjendje të trazojë fenë e myslimanëve, politikën, mendjet dhe shtetin e tyre dhe se, më pas, këtij njeriu t'i jepej suksesi për punët që ai kishte qëllim?! Apo të thuhet se ai nxiti myslimanët të ngrihen kundër halifes së tyre, derisa e vranë atë, pastaj arriti të përçajë myslimanët dhe, se para këtyre punëve, ai kishte krijuar ndjekës besnikë e grupe.

Të gjitha këto janë punë që as mendja nuk i pranon e as nuk i qëndrojnë dot kritikës, prandaj historia nuk duhet të shkruhet mbi të tilla dëshmi.³¹

* * *

Më pas dr. Taha Husejn, në vëllimin e dytë të librit të tij, i rikthehet subjektit Ibn Sebe dhe ndër të tjera shkruan:

“Interesant është fakti se historianët e kanë përmendur shumë Ibn Seudan, Abdullah ibn Seben dhe shokët e tij kur kanë treguar për çështjen e ngatërresave që

³¹ “Elfitmetul-kubrâ”, vëll. 1, 131-137, Botimi i tetë, Shtëpia botuese “Dàrul-meàrif”, Egjipt.

ndodhën në kohën e Uthmanit. Ata vazhduan ta përmendin shumë Ibn Seben, edhe pas vrasjes së Uthmanit, para se Aliu të takohet me Talhanë, Zubejrin dhe me nënën e besimtarëve, Aishen, në Medinë. Pas kësaj ngjarjeje, historianët i përmendin shumë këta të fundit, kur Aliu mori rrugën në drejtim të Talhait, Zubejrit e nënës së besimtarëve, për të lidhur paqen me ta. Më pas historianët pretendojnë se personat e lartpërmendur drejt të cilëve u nis Aliu t'i takonte, përfituan nga një çast shkujdesje nga ana e Aliut dhe shokëve të tij, komplotuan kundër Aliut dhe ndezën zjarrin e luftës. Por akoma më e çuditshme është se këta historianë i harruan fare sebijtë, madje nuk i përmendin fare kur rrëfejnë ngjarjet që kanë lidhje me Betejën e Sifijnit.”³²

Më pas ai shton: “Historianët nuk e preken çështjen e sebijve dhe të Ibn Seudas në ngjarjet që kanë lidhje me Betejën e Sifijnit. Kjo ka ndodhur, sepse puna e sebijve dhe e liderit të tyre, Ibn Seudas, si person që mban përgjegjësitë qytetare, është vetëm një trillim. Gjithashtu, është trillim edhe ajo që thuhet se, kur u ndez polemika mes shi'ave e grupeve të tjera islame, Ibn Sebe filloi nga sajemat e tij, me qëllim që armiqtë e shi'ave të fusnin në bazat e këtij medh'hebi një element jehudi, duke bërë kujdes që ndër

³² Lexo “Ensàbul-eshràf”, f. 383, botimi i për, shtëpia botuese “Mues’setul-Aëlemij”, Bejrut.

muslimanët të zinin vend mashtrimet e tij dhe me anë të mashtrimeve ai të arrinte qëllimin e vet.

Sikur puna e Ibn Seudasë të mbështetej mbi ndonjë bazë të vërtetë, në historinë e mirëfilltë do të ishte normale që ai të shfaqte ndikimin e mashtrimit e tij në luftën komplekse e krejtësisht të gabuar që u zhvillua në Sifijn. Atëherë, si mund të shpjegohet kjo shkujdesje, ose si mund të shpjegohet mungesa e Ibn Sebes në Betejën e Sifijnit? Nga ana ime, unë i shpjegoj të dy variantet vetëm me një shkak dhe ky shkak është se Ibn Seuda s'është gjë tjetër veçse një trillim."

Më pas autori shton: "Në të vërtetë, ai është një person i stisur, të cilin armiqtë e shi'ave e ruajtën që ta përdorin vetëm kundër shi'ave."

* * *

Në një anë tjetër të diskutimit të tij, dr. TaHa Husejn shkruan: "Përsa i përket Elbeladherijit, më sipër kemi parë se ky autor nuk e përmend as Ibn Seudan e as përkrahësit e tij në punën e Uthmanit. Gjithashtu, ky autor nuk e përmend atë as në punën e Aliut, me përjashtim të një rasti kur thotë se Ibn Sebe nuk ishte person i rrezikshëm dhe se, kur ai, me disa të tjerë, shkoi te Aliu dhe e pyetën për Ebu Bekrin, Aliu iu përgjigj ashpër atyre dhe i qortoi për zellin e tepruar që tregonin për të tilla gjëra, në një kohë që

Egjipti nuk ishte nën pushtetin e qeverisë së Medines dhe në Egjipt ishin vrarë përkrahësit e Aliut.

Aliu shkroi një letër, në të cilën ka përmendur se ku e çuan atë punët, pasi e braktisën banorët e Irakut. Gjithashtu, Aliu kishte urdhëruar që kjo letër të lexohej para njerëzve, me qëllim që njerëzit të përfitonin prej saj.

Gjithashtu Elbeladheriji ka thënë: “Ibn Sebe kishte një kopje të asaj letre, por ai e dogji atë.”¹ Te Elbeladheriji Ibn Sebe nuk është Ibn Seuda, por është Abdullah ibn Vehb Elhemedanij.

Elbeladheriji e tregon këtë njoftim duke qenë shumë i rezervuar, për të qenë sa më kërkues ndaj vetes, për të thënë të vërtetën me aq mundësi sa ka pasur. Elbeladheriji citon edhe shumë hadithe. Më pas ai vetë shfaq dyshim për saktësinë e haditheve të cituara prej tij, duke thënë se janë prej stisjeve të banorëve të Irakut.”

Pasi flet me fjalë të shpejta rreth gjendjes së haditheve dhe njoftimeve, dr. TaHa Husejini i rikthehet çështjes së Ibn Sebes për të thënë: “Nëse Ibn Sebe do të kishte ndonjë rol në ngjarjet me rëndësi, Elbeldheriji nuk përmend asgjë për Ibn Seudan e për ndjekësit e tij në punët e ngatërresave që ngjanë në kohën e Uthmanit e të Aliut. Taberiji dhe historianët që kanë cituar prej Taberijit pas kalimit të këtij të fundit, e përmendin Ibn Seudan dhe

shokët e tij në ngatërresën që ngjau gjatë kohës së Uthmanit e në vitin e parë prej viteve të sundimit të Aliut. Pas kësaj kohe, historianët i harrojnë ata.

Mbledhësit e hadithit dhe mjeshtrit e polemikës ndajnë një mendim të përbashkët me Taberijin e me shokët e tij për të gjitha sa kanë thënë për Ibn Seben. Por mbledhësit e hadithit dhe mjeshtrit e polemikës dallohen për një gjë tjetër, që nuk e ka thënë as Taberiji e as historianët e tjerë. Ata pretendojnë se Ibn Seudan e ndjekësit e tij e hyjnizuan Aliun dhe se Aliu i ka djegur ata në zjarr. Kushdo që studion librat e historisë, nuk gjen që djegia e njerëzve me zjarr të përmendet në ato libra. Gjithashtu, edhe ne nuk njohim se në cilin vit prej viteve të pakta që Aliu ishte në krye të hilafetit, u shfaq ngatërresa e atyre ekstremistëve. Djegia e njerëzve me zjarr s'ka ekzistuar në brezin e parë të myslimanëve, as në ndonjë grup prej sahabëve të Profetit e as ndër myslimanët e mirë. Asgjë e tillë s'ka ndodhur, që historianët të jenë kaq të shkujdesur sa të mos e përmendin e të mos caktojnë datën kur ka ndodhur, por të gjithë e kalojnë këtë periudhë kohe pa thënë asgjë për këtë punë.³³

³³ "Alijun ue benùhu", autori, dr. Taha Husejn, f. 43, 90 dhe 152, Botim i shtatë, Egjipt, Kajro.

MENDIMI I PROF. HAMID DAUD ELHANEFIJ

Mbetet detyra jonë të citojmë disa radhë prej atyre që ka shkruar rreth këtij personi imagjinar e mitik³⁴ egjiptiani, prof. Hamid Hanefij Daud.

Prof. Hanefij thotë: “Kaluan trembëdhjetë shekuj prej historisë së Islamit dhe gjatë kësaj kohe dijetarët “më të paanshëm e më të drejtët” vazhdojnë të nxjerrin dispozita islame për shi’at, të mbushura me ndjenjat e me dëshirat e tyre. Është e qartë se kjo rrugë shterpë u bë shkak që të hapet kjo gropë e madhe ndërmjet grupeve islame. Veç kësaj, për shkak të këtyre dispozitave pa asnjë vlerë, bota islame humbi shumë prej diturive të dijetarëve të mëdhenj të këtyre grupeve. Gjithashtu, bota islame humbi shumë edhe prej mendimeve të tyre të rralla dhe talenteve të tyre.

Humbja që pësoi dituria ishte shumë më e madhe se humbja që pësuan shi’at dhe Shi’izmi, për shkak të punëve

³⁴ Prej parathënies së librit “Abdullah ibn Sebe”, autori Es’sej’id Murtedà El-askerij.

të kota që kanë hedhur mbi shi'at personat që i kanë urryer ata. Natyrisht që shi'at s'mbajnë asnjë përgjegjësi për punët që ata i akuzojnë. Sikur këta "dijetarë të paanshëm" të kishin ngritur veten mbi fanatizmin kur kanë shkruar për shi'at, ose kur kanë marrë prej shi'ave dhe të kishin ndjekur një rrugë studimi shkencor të shëndoshë, rrugë që i jep përparësi gjykimit të mendjes mbi gjykimin e zemrës, patjetër që do të kishin dhënë mendime që qëndrojnë mbi dëshirat dhe te ne do të kishte ardhur shumë dituri për shi'at dhe do të kishim përfituar shumë prej trashëgimisë së këtij medh'hebi.

Studiuesi i paanshëm, në fushën e të vërtetave shkencore, merr prej shi'ave aq sa merr edhe prej medh'hebeve të tjera islame. Nëse me të vërtetë është i paanshëm, ai patjetër duhet të studiojë edhe fik'hun e shi'ave, kur studion fik'hun e katër medh'hebeve të Ehli Synetit, pa harruar se Imam Xhafer Sadiku, i vdekur në vitin 148 Hixhreti, ngriti flamurin e fik'hut shi'i dhe, pa harruar, se Imam Xhafer Sadiku ka qenë mësuesi i dy imamëve prej medh'hebeve të Ehli Synetit, Imami Ebu Hanijfeh Nuëman ibn Thabit, vdekur në vitin 150 të Hixhretit dhe Imami Ebu Abdullah Malik ibn Enes, vdekur në vitin 179 Hixhreti.

Imami Ebu Hanijfeh, duke pohuar meritën e mësuesit të mëparshëm, ka thënë: "Sikur të mos ishin dy

vjetët, Numani do të ishte shkatërruar.” Me numrin *dy* ai thekson dy vjetët gjatë të cilëve mori dituri prej Xhafer ibn Muhamedit.

Kurse Imam Malik ibn Enesi ka thënë: “Nuk kam parë më të ditur në çështjet e fik’hut se Xhafer ibn Muhamedin.”

Katastrofa që më e madhe atëherë kur disa nxjerrësh hadithesh, që i atribuojnë vetes cilësinë e ditorisë dhe vetëvishen me rrobën e dijetarit, sikur të ishin treguar të thjeshtë dhe të kishin pastruar veten nga vesi i ngritjes së vetes më lart nga sa ishin në të vërtetë, kurrë nuk do të kishin shpallur revoltën kundër grupeve islame dhe, në mënyrë të veçantë, kundër grupit të shi’ave. Është pikërisht kjo kategori prej mbledhësve të hadithit, të cilët, me ato që shkruan nëpër librat e tyre, i prenë rrugët studimit shkencor dhe mbyllën për veten e tyre portat e ditorisë.

Është për të ardhur keq kur shikojmë se edhe profesori ynë, Ahmed Emin, është një prej atyre personave që i kanë mbuluar vetes dritën e ditorisë ndaj një ane të madhe prej anëve të kulturës islame. Në këtë anë, pararojë e të gjithëve, ecën jo vetëm shi’at, por edhe të tjerë prej ndërtuesve të kulturës islame e të trashëgimisë islame. Kështu kanë bërë edhe të tjerë, që kanë ecur në rrugën e tij, prej profesorëve të universiteteve, të cilët i kanë dhënë

përparësi fanatizmit më të verbër ndaj lirisë së mendimit. Për rrjedhojë, mendimet e tyre kanë mbetur të ngurtësuara vetëm në njërin medh'heb.

Natyrisht që kjo nuk është rruga e drejtë që ndjekin studiuesit e mirëfilltë. Këto gabime të mëdha historike kanë dalë jashtë kontrollit “të frerëve” të këtyre studiuesve, u mbuluan jo vetëm nga errësira, por mbuluan edhe punën e tyre, të cilën ata as nuk e kanë kuptuar e as nuk e kanë studiuar. Këto gabime që errësuan punën, janë shpifjet që ata stisën kundër shi'ave, kur thurnin kundër tyre tregimin për Abdullah ibn Seben. Këto shpifje ata i thurën në formë tregimesh, disa prej të cilave unë i kam theksuar në veprat e mia. Në ato tregime ata pretendojnë, pa asnjë bazë, se të gjitha mitet, ose rrenat, ose legjendat kanë ardhur prej agimeve të historisë islame dhe të gjitha janë prej pëlhurës që ka endur fantazia e dijetarëve të shi'ave dhe që ata i kanë konsideruar cene, por që me kalimin e kohës, këto cene atyre u ishin bërë vese e të meta.

Studiuesi i nderuar, Nurteda El-Askerij, ka shkruar librin me titull “Abdullah ibn Sebe”. Në këtë libër ai shpjegon se personi Ibn Sebe s'ka dalë dot prej qenies së tij si person mitik dhe se ajo që kanë thënë historianët për këtë person, është prej tregimeve që qarkullojnë në propagandën e drejtuar kundër Shi'izmit. Të gjitha sa kanë thënë përcjellësit e njoftimeve për këtë person, nuk janë më

shumë se një rrenë e regjistruar prej treguesve të njoftimeve rreth këtij personi imagjinar. Edhe kjo natyrisht është bërë me qëllim që të hedhin kundër shi'ave ato që kanë dashur të hedhin dhe që të vënë në dukje për shi'at atë që kanë dashur.

Ky studiues krahasues, vërtetimet dhe studimet e tij shkencore, shumë të bukura, i ka mbledhur prej librave të ndryshëm, prej burimeve të botuara në fushën e trashëgimisë dhe prej brendësisë së teksteve. Ai kapërcen e shëtit prej një fushe në fusha të tjera të historisë islame, derisa ka arritur në këtë të vërtetë që shkëlqen me kaq qartësi. Profesori, në të gjitha studimet që ka sjellë në këtë libër, është munduar të ndërtojë argumentet e formës së prerë kundër armiqve të shi'ave. Prandaj shikojmë që mendimet e tij shkencore janë të mbështetura me tekste të vërtetuara prej vetë fjalëve të armiqve të shi'ave. Në këtë mënyrë ai e ngre argumentin kundër tyre me rrugën më të afërt.

Duke lexuar këtë libër, lexuesi e ka të lehtë e të thjeshtë të qëndrojë mbi vërtetimet shkencore që ka sjellë autori për njoftimet e përcjella prej Sejf ibn Omerit, njoftime që kanë zënë vend në trurin e historianëve që prej kohëve kur ka filluar të shkruhet historia islame deri në kohët e afërta me ne. Për historinë, Allahu i Lartësuar ka përcaktuar studiuesit më të talentuar, prej atyre që në

rrugën e Allahut të Lartësuar s'kanë frikë prej baltës që mund të hedhin mbi ta personat që e kanë të lehtë baltosjen e të tjerëve.

Profesori i nderuar është në pararojë të këtyre historianëve, që kur ai pati mundësi të shtyjë studiuesit që të rishikojnë ato që ka thënë Ebu Xhafer Taberiji në librin e tij "Tarijkhul-umemi uelmulùk"- "Historia e kombeve dhe e mbretërve". Gjithashtu, ai me fjalën e tij bindëse, mundi të shtyjë studiuesit të rishikojnë edhe kritikën historike, për të gjitha ato që thuhet në këtë libër dhe në libra të tjerë. Autori bën thirrje që studiuesit të shikojnë ngjarjet historike në ato gjëra të shenjta që as nuk mund të ndryshohen e as nuk mund të tjetërsohen.

Në sajë të shembujve krahasues historikë, autori mundi të heqë maskën prej shumë ngjarjeve historike dhe me rrugët më të afërta t'i bëjë të vërtetat sa më të qarta për studiuesit, edhe pse vetë autori i ka sjellë disa prej të vërtetave në një mënyrë që duken të çuditshme e jo shumë të qarta. Në të vërtetë, ato duken të tilla për shkak se mënyra se si ai i shpalos ato, është në kundërshtim me rrugën me të cilën njerëzit janë mësuar të lexojnë dhe janë edhe në kundërshtim me ato që ata kanë trashëguar në besimet e tyre. Por e vërteta ka më shumë të drejtë të ndiqet.

Nëse dëshiron të mësosh me sinqeritet rreth kësaj fjale, s'ke nevojë për gjë tjetër veçse të lexosh ngjarjet historike që autori ka sjellë në librin e tij. Në këtë libër do të gjesh se njoftimet rreth atyre ngjarjeve janë të ndryshme.³⁵

³⁵ “Nedharàtun fil-kutubil-khàlideti”, f. 101-105, Botim i shtëpisë botuese “En’nexhàh”, Kajro, 1982.

MENDIMI I DR. ABDUL-AZIJZ ELHILALIJ

Doktori i nderuar, në librin e tij “Abdullah ibn Sebe”, që ne e kemi subjekt të studimit, thotë: “Padyshim që Ibn Sebe është person imagjinar, ai nuk ka ekzistuar dhe, nëse gjendet ndonjë person me këtë emër, me siguri që nuk e ka pasur rolin që i kanë atribuuar atij Sejfi dhe autorët që kanë shkruar për grupet islame, as nga ana politike e as nga ana e doktrinës.”³⁶

³⁶ “Abdullah ibn Sebe”, studim rreth ngjarjeve historike për rolin e tij në ngatërresën, f. 71.

MENDIMI I PROF. AHMED AB'BAS SALIH:

Profesori Ahmed Ab'bas Salih thotë: “Këtu përsëritet emri i Abdullah ibn Sebes dhe thuhet se ai ishte një jehudi që kishte pranuar Islamin. Këtë person librat e historisë e përshkruajnë si shejtan, që qëndronte prapa ngatërresës në të cilën u vra Uthmani, madje ishte shejtani që qëndronte prapa të gjitha ngjarjeve. Ndaj këtij personi autorët e librave mbajnë qëndrime të kundërta. Ka autorë që e mohojnë ekzistencën e tij, autorë të tjerë e konsiderojnë atë shkakun e të gjitha ngjarjeve të rënda që ndodhën, madje e konsiderojnë themelin e çdo devijimi që hyri në Islam, përfshirë edhe daljen e medh'hebeve të çuditshme.

S'ka dyshim që Abdullah ibn Sebe është person mitik. Ku është ai ndaj të gjitha ngjarjeve? Ku është ai ndaj luftërave të ndryshme që janë bërë në këtë botë të madhe? Sa mundësi ka një person i vetëm, sado e madhe të jetë vlera e tij që të ketë rol në këto rryma që përleshën njëra me tjetrën me egërsi?

Ngjarjet e shpejta, të ashpra e të njëpasnjëshme nuk kishin nevojë vetëm për një person, qoftë ai edhe vetë

shejtani, sepse bazat e ngjarjeve shtriheshin në largësi të mëdha dhe ishin shumë të thella, gjithashtu edhe fuqinë e vrullit të atyre ngjarjeve është e pamundur ta vërë nën kontroll ose ta orientojë vetëm një person, pa folur se ato ngjarje ishin të gërshetuara njëra me tjetrën dhe ishin aq të shumta, sa asnjë lloj force nuk i bënte dot më të komplikuar nga sa ishin.

Padyshim që është shumë naiv mendimi që synon të krijojë një person mitik dhe pastaj t'i japë këtij personi çdo lloj roli në ngjarjet që kanë ndodhur, por akoma më naiv është ai që mendon se ky burrë kishte një lloj ndikimi edhe mbi sahabët e mëdhenj, ndër të cilët mbi vetë Ebu Dherr Elgaf'farijin, i cili nuk pranoi as diskutimin e përcjellësit të njohur të haditheve, Ebu Hurejre dhe jo më të pranonte fjalët e një personi, të quajtur Abdullh ibn Sebe, të cilin, sipas tregimeve të Ebu Dherrit, e goditi dhe madje i shkaktoi edhe një të çarë, duke i thënë me përçmim: "Ti do të na e mësosh fenë tonë, o biri i çifutes?!"

Nuk ka asnjë dyshim se tregimet që janë thurur rreth Abdullah ibn Sebes, të gjitha janë fjalë të vëna prej të mëvonshmëve, për faktin e thjeshtë se në burimet e vjetra s'ka asnjë argument që vërteton se ai person ka ekzistuar, duke shtuar edhe sa mendjelehtësi është të mendohet se ai ka ekzistuar me të vërtetë.³⁷

³⁷ "Eljemijnu ueljesàru fil-Islàm" – "E djathta dhe e majta në Islam", f. 95.

KAPITULLI I TRETË

QËNDRIMI I DIJETARËVE SHI'I

NDAJ ABDULLAH IBN SEBES

Mendimet e dijetarëve dhe e studiuesve shi'i janë të ndryshme ndaj Abdullah ibn Sebes. Ka prej atyre që mendojnë se ai ishte një person anësor, nuk ka luajtur atë rol të rrezikshëm, ishte i devijuar në mendime e në besim dhe ishte ekstremist. Për shkak të mendimeve që mbarte, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu, e kundërshtoi ashpër dhe e dogji atë në zjarr. Sipas transmetimeve të ndryshme, të ardhura nga librat që kanë shkruar dijetarët për Abdullah ibn Seben, ata e kanë mallkuar atë dhe e kanë shpallur mohues. Bazuar në transmetimet e ardhura me rrugët e Ehli Bejtit, dijetarët besojnë se është detyrim që ndaj tij të mos mbahet asnjë përgjegjësi. Meriton të theksohet se këtë

mendim të fundit të dijetarëve, autorë librash që kanë shkruar për Abdullah ibn Seben, e ka adaptuar një grup dijetarësh të mëparshëm dhe disa prej të mëvonshmëve.

Disa prej tyre mendojnë se figura e Abdullah ibn Sebes është thjesht një legjendë mitike dhe se shkak u që e ka shtyrë imagjinatën për stisjen e kësaj figure është vetëm gjuetia në ujë të turbullt dhe kapërcimi i të vërtetave historike për qëllime të këqija. Në këtë mendim kanë shkruar edhe disa prej dijetarëve e studiuesve të mëvonshëm.

Në vijim do të shpalosim shkurtimisht disa prej thënieve të të dyja grupeve.

Në fillim le të shohim ata që janë shprehur për mendimin e parë:

1. EL-ESH'ARIJ SEIJD IBN ABDULLAH ELKAMIJ (299 ose 301 Hixhreti)

Ai ka thënë: “Grupi ‘sebi’, është ndjekës i Abdulla ibn Sebes, i cili është Abdullah ibn Vehb Errasibij Elhemedanij, të cilin e ka ndihmuar në punën e tij Abdullah ibn Haresij dhe Ibn Esved. Këta dy të fundit janë prej ndjekësve të tij më të dalluar. Abdullah ibn Sebe është i pari që u shpreh hapur, me fjalë fyese kundër Ebu Bekrit, Omerit, Uthmanit e sahabëve dhe pohoi para njerëzve se ai nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj tyre.”³⁸

2. HASEN IBN MUSA EN'NUBEKHTIJ (310 Hixhreti):

Ai ka thënë: “Sebijtë janë ndjekësit e Abdullah ibn Sebes, i cili ishte prej atyre që u shpreh hapur, me fjalë fyese, kundër Ebu Bekrit, Omerit, Uthmanit e sahabëve. U shfajësua prej tyre dhe tha: “Për këtë ka urdhëruar Aliu.” Kur Aliu e pyeti për këtë fjalë, ai e pohoi dhe Aliu urdhëroi ekzekutimin e tij. Por njerëzit ngritën zërin kundër këtij vendimi dhe i thanë: “O Prijës i besimtarëve, si do të

³⁸ “Elmekâlātu uelfireku”, f. 20.

ekzekutosh një burrë dashamirës ndaj Ehli Bejtit dhe që mbështet faktin se hilafeti të takon ty dhe që është shfajësuar prej armiqve tuaj?”

Aliu urdhëroi që ai të degdisej në vende të largëta.”

Në vijim, En’nubekhtij thotë: “Kur te Abdullah ibn Sebe arriti lajmi për vrasjen e Aliut, ai pa njërin prej banorë të atij vendi të qante për vdekjen e Aliut dhe i tha: “Po gënjen, sikur të vije te ne me shtatëdhjetë enë të mbushura me trurin e tij dhe, sikur, për të vërtetuar vrasjen e tij, të sillje shtatëdhjetë dëshmitarë të drejtë, ne e dimë mirë se ai as nuk ka vdekur e as nuk është vrarë dhe se ai nuk do të vdesë, derisa të sundojë mbi të gjithë tokën.”³⁹

3. ELKESHIJ (360 Hixhreti)

Ky dijetar e ka përmendur Abdullah ibn Seben dhe ka sjellë pesë njoftime prej Imamëve për shfajësimin e tyre prej Abdullah ibn Sebes, të cilin ata e kanë mallkuar. Ata janë shprehur për të me fjalë që i meriton vetëm një njeri i ulët. Ja disa prej njoftimeve të sjella prej tij:

Domethënë: lajmin për rënien dëshmor të Ali ibn Ebu Talibit.

³⁹ “Fireku-sh’hsij’ah”, f. 22.

* Më ka folur Muhamed ibn Kulujeh, më ka folur Sad ibn Abdullah: “Ne na foli Jakub ibn Jezidi dhe Muhamed ibn Isa. Prej Ali ibn Mehzejarit, prej Fedaleh ibn Ejub El-Ezedijit, prej Eban ibn Uthmanit, transmetohet: “Kam dëgjuar Ebu Abdullahun (Imam Xhafer Sadikun) të thotë: “Allahu e mallkoftë Abdullah ibn Seben! Ai ka pretenduar hyjninë për Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun. Pasha Allahun! Prijësi i besimtarëve ishte një rob i bindur ndaj Allahut të Lartësuar. Mjerim për atë që thotë gënjeshtër për ne. Ka njerëz që thonë për ne gjëra që nuk i kemi thënë për veten tonë. Ne jemi të pastër para Allahut prej fjalëve që ata thonë.”

* Sipas këtij vargu përcjellësish: prej Jakub ibn Jezidit, prej ibn Ebij Omejrit dhe Ahmed ibn Muhamed ibn Isa, prej babait të tij dhe Husejn ibn Sejdit, prej ibn ebu Omejrit, prej Hisham ibn Salimit, prej Ebu Hamza Ethemalijit transmetohet: “Ali ibn Husejni ka thënë: “E mallkoftë Allahu atë që thotë gënjeshtër për ne! Kur përmend Abdullah ibn Seben, më ngrihen të gjitha qimet e trupit. Ai ka pretenduar një gjë shumë të rëndë. Çfarë ka ai? Allahu e mallkoftë! Pasha Allahun! Aliu ishte një rob i Allahut, shumë i mirë. Ai ishte vëllai i të Dërguarit të Allahut. Pozitën që ai gëzon te Allahu, e ka arritur në sajë të bindjes së tij të plotë ndaj Allahut dhe ndaj të Dërguarit të Tij. Edhe i Dërguari i Allahut e ka arritur pozitën e tij të

lartë te Allahu vetëm në sajë të bindjes së tij ndaj Allahut të Lartësuar.”

* Sipas këtij vargu përcjellësish: prej Muhamed ibn Khalid Etajalesijit, prej ibn Ebu Nexhranit, prej Abdullahit (ibn Sinan) transmetohet: “Ebu Abdullahu (Imam Sadiku) ka thënë: ‘Ne të Ehli Bejtit themi vetëm të vërtetën. Ne nuk jemi të izoluar prej gënjeshtarëve. Ata thonë gënjeshtër për ne. Gënjeshtari, me gënjeshtërën e tij, synon të ulë sinqeritetin tonë te njerëzit. I Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte njeriu që thoshte fjalën më të drejtë e më të vërtetë, ishte njeriu më i sinqertë i të gjithë njerëzimit. Musejleme thoshte gënjeshtër për të. Edhe prijësi i besimtarëve, Imam Aliu, ishte njeriu më i drejtë. Atë e kishte shfajësuar Allahu i Lartësuar, pas të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por gënjeshtari Abdullah ibn Sebe jo vetëm që thoshte gënjeshtër për të, por edhe punonte që të përgënjeshtronte sinqeritetin e tij, madje ai shpifte edhe për Allahun.”

Elkeshiji ka thënë: “Disa dijetarë janë shprehur se Abdullah ibn Sebe ishte jehudi, që pranoi Islamin dhe ishte ndjekës i Imam Aliut. Kur ishte në fenë e jehudive, ai kaloi në ekzagjerime dhe tha se Jushe ibn Nuni ishte i porosituri i Musait (*Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë për të!*) dhe kur hyri në Islam, pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe*

bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) tha të njëjtën gjë për Imam Aliun. Abdullah ibn Sebe ishte i pari që foli hapur se Imamati i Aliut ishte farz dhe shpalli sheshit se ai e shfajësonte veten e nuk mbante asnjë përgjegjësi ndaj armiqve të Imam Aliut. Ai foli hapur se është armik i armiqve të Aliut dhe i deklaroi ata mohues.⁴⁰

4. MUHAM'MED IBN ALI IBN HUSEJN IBN BABUJEH ES-SADUK (381 Hixhreti)

Ka sjellë një transmetim, ku ka përmendur Ibn Seben: Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu, ka thënë: “Kur ndonjëri prej jush të përfundojë faljen e namazit, le të ngrejë të dyja duart në drejtim të qiellit dhe të përkushtohet në lutje.” Ibn Sebe i tha: “O prijës i besimtarëve, a nuk është Allahu i Lartësuar në çdo vend?” Ai tha: “Patjetër.”

Por ai përsëri tha: “Atëherë, përse duhet të ngrejë të dyja duart në drejtim të qiellit?”

Imam Aliu tha: “A nuk e lexon ti ajetin:

وَفِي السَّمَاءِ رِزْقُكُمْ وَمَا تُوعَدُونَ

tùadùne” “në qiell është furnizimi juaj dhe gjithçka që u

⁴⁰ “Rixhàlul-Keshij”, f. 98-101.

është premtuar.”⁴¹ A nuk kërkohet furnizimi aty ku gjendet dhe a nuk është qielli vendi i furnizimit e i gjithçkaje që ka premtuar Allahu i Lartësuar?⁴²

Këtë tregim ai e ka marrë prej një transmetimi të gjatë, të cituar në librin “Elkhisàl”.⁴³

5. EBU XHA FER IBN HASEN ET’TÛSIJ, shejhu i grupit (460 Hixhreti)

Shejhu Et’ tusij, ka shkruar një jetëshkrim një lidhje me të vërtetën e Abdullah ibn Sebes, në librin e tij “Rixhàlu-t’ tûsij”, kapitulli “Shokët e Aliut”. Në këtë shkrim ai ka thënë: “Abdullah ibn Sebe u kthye në mohim dhe shfaq i ekzagjerime.”

Gjithashtu, në marxhinaturën e librit të tij, ai ka përmendur për Abdullah ibn Seben fjalët: ekzagjruer, i mallkuar, atë e ka djegur në zjarr Prijësi i besimtarëve. Ai mashtronte dhe thoshte se Aliu është perëndi dhe profet.”

⁴¹ Sure “Edh Dhàrijjàt”, ajeti 22.

⁴² “Men là juhdiruhul-fekijhu”, vëll. 1, f. 325; K. “Et’ taëkiyb”, cituar prej shejhut Et’ tusij, në librin “Tehdhijbul-ahkàmi, vëll. 2, f. 322.

⁴³ “Kitàbul-khisàl”, f. 628.

Më pas ai citon një transmetim prej Elkeshijit, për Abdullah ibn Seben: “Në lidhje me jetëshkrimin e Abdullah ibn Sebes janë shkruar disa vepra.”⁴⁴

6. IBNI EBUL-HADIJD (656 Hixhreti)

Ebul-Hadijd ka thënë: “Ibn Sebe është i pari që ka shprehur ekzagjerime në kohën e Aliut dhe ka thënë: “I pari që ka folur hapur për ekzagjerime në kohën e tij është Abdullah ibn Sebe, i cili është ngritur më këmbë kur ai po këndonte hytben dhe i ka thënë: “Ti, ti!” Këtë fjalë e ka përsëritur. Aliu i tha: “Ore, i mjeri ti! Kush jam unë?”

Ai i tha: “Ti je Allahu.” Ai urdhëroi që ai të dënohet. Bashkë me të u dënuan edhe ata që mendonin si ai.”⁴⁵

7. HASEN IBN ALI EL-ALAMEH ELHALIJ (726 Hixhreti)

El-Alemeh Elhalij në librin e tij

⁴⁴ “Rixhàlu-t’ túsij”, f. 51.

⁴⁵ “Sherhu Nehxhul-Belàgah”, vëll. 5, f. 5. K. 58.

Edhe pse “Errixhâl” e ka përmendur Abdullah ibn Seben, e ka përmendur në kategorinë e përcjellësve të gradës “Daijf”-“dobët”.⁴⁶

8. INAJETULL’LLÀH IBN ALI ELKAHBÀIJ (1016 Hixhreti)

Dijetari i madh e studiuesi i biografive të burrave, Inajetu-ll’lâh ibn Ali Elkahbàij, e ka përmendur Abdullah ibn Seben në librin e tij “Muëxhmeu-rr’rixhâl”: “Abdullah ibn Sebe u kthye në mohim dhe ka shfaqur hapur ekzagjerime. Pastaj ka përmendur transmetimet e Elkeshijit, prej të cilave:

Prej Abdullah ibn Sinanit, transmetohet: “Më ka transmetuar babai im, prej Ebu Xhaferit, Imam Sadikut: “Abdullah ibn Sebe ka pretenduar profetësinë dhe pretendon se Prijësi i besimtarëve, Imami Aliu, është Allahu i Lartësuar.”

Kur Prijësi i besimtarëve u njoftua për këtë fjalë, e thirri, e pyeti dhe ai e pohoi se ashtu ka thënë, madje tha para tij:

⁴⁶ “Rixhâlul-Halij”, f. 254, Pjesa e dytë, Botuar në Kom, Iran.

“Po, ti je Ai. Mua më është hedhur në ndërgjegjen time se ti padyshim je Allahu dhe unë jam profet!”

Prijësi i besimtarëve i tha: “I mjeri ti! Me ty është tallur shejtani! Të qaftë nëna jote! Hiq dorë prej këtyre mendimeve dhe bëj teube!”

Por ai nuk pranoi të bëjë teube. Atëherë ai e arrestoi dhe tre ditë me radhë i kërkoi të bënte teube, por ai përsëri nuk pranoi të bëjë teube, atëherë ai e dogji atë në zjarr dhe tha: “Padyshim që shejtani i ka marrë mendjen atij. Shejtani shkonte te ai dhe i hidhte në shpirt këto fjalë.”⁴⁷

9. MUAHMED IBN ALI ERDEBIJLIJ (1101 Hixhreti)

Erdebijlij e ka përmendur Abdullah ibn Seben në librin e tij “Xhàmiu-rr’rruvàt”, për të cilin ka thënë: “Ai është ekzagjerues i mallkuar. Ai ka pretenduar se Aliu është Zoti dhe për veten e tij ka pretenduar se është profet.”⁴⁸

⁴⁷ “Rixhàlul-Kahbàij”, vëll. 3, f. 284.

⁴⁸ “Xhàmir-rr’rruvàt”, vëll. 1, f. 485. Botues “Dàrul-Advài”, Bejrut.

10. MUHAM'MED BAKIR ELMEXHLISIJ (1111 Hixhreti):

Elmexhlsij, në librin e tij, “Bihàrul-Enuàr” – “Detet e dritave”, ka thënë: “Sebjtë thonë se Mehdiu i pritshëm është Ali ibn ebu Talibi dhe se ai nuk ka vdekur.”⁴⁹

Gjithashtu, në kapitullin “Elfitenul-hàdithetu bimisr” – “Ngatërresa që ndodhi në Egjipt”, ka cituar atë që i ka treguar Ibrahim Eth’thekafij, prej vargut të përcjellësve të tij: prej Abdurrahman ibn Xhundubit, prej babait të tij: “Amër ibn Elhamk, Hixhr ibn Adij, Habeh el-Arenij, Harith el-Aver dhe Abdullah ibn Sebe, pas çlirimit të Egjiptit, hynë te Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu, të cilin e gjetën të dëshpëruar e shumë të hidhëruar. Ata i kërkuan atij t’u shpjegonte qartë fjalën e tij për Ebu Bekrin dhe për Omerin. Aliu u tha: “Kjo çështje ju shqetëson ju? Ja, Egjipti u çlirua dhe përkrahësit e mi në Egjipt u vranë. Unë do të shkruaj për ju një letër, ku do t’i përgjigjem pyetjes që më bëtë. Por ju kërkoj të ruani të drejtën time në ato që ju keni humbur, pastaj letrën time ua lexoni përkrahësve të mi dhe ndihmoni për të drejtën.”⁵⁰

Gjithashtu dijetari i nderuar Elmexhlsij, në kapitullin: “Ahvàlu sàir As’hàbihi” – “Gjendjet e shokëve të

⁴⁹ “Bihàrul-Envàr”, vëll. 51, f. 210.

⁵⁰ Burimi i sipërm, vëll. 33, f. 566.

Imam Aliut”, në të njëjtit libër ka cituar prej rrugës së përcjellësve të shejhut Mufid: prej Amar Ed’dehnij, i cili ka thënë: “Kam dëgjuar Ebu Tufejlën të thotë: ‘Musejib ibn Nexhijeh erdhi te Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu, duke lëshuar thirrje luftarake⁵¹ kundër Abdullah ibn Sebes. Prijësi i besimtarëve e pyeti: “Si e ke punën?”

Ai tha: “Ai thotë gënjeshtër për Allahun dhe për të Dërguarin e Tij.”

Ai e pyeti përsëri: “Çfarë thotë?”

Ebu Tufejli tha:⁵² “Nuk e dëgjova atë që tha Musejibi, por dëgjova atë që tha Prijësi i besimtarëve: “Sa larg, shumë larg shkon zemërimi. Te ju do të vijë kaluar ai që fshejh qëllime të këqija, ai shtrëngon barkun me rripin e mesit prej dhimbjes që ndien për shkak të mishit të shumtë që ka ngrënë; ai s’ka kryer asnjërën prej punëve të Haxhit e të Umres (si prerja e thonjve, rruajtja ose qethja e kokës) dhe ai do ta vrasë atë. Me “atë” ai ka qëllim Husejn ibn Aliun.⁵³

Prej Zerareh është përcjellë: “I thashë Sadikut (Imam Sadikut): “Një burrë prej pasardhësve të Abdullah ibn Sebes flet për ngarkimin me detyrë.”

Imam Aliu e pyeti: “Ç’është ngarkimi me detyrë?”

⁵¹ Thirrje për luftë, kur nxiton të përgatitet për të luftuar.

⁵² Domethënë: “Tha Ebu Rufejli.

⁵³ “Bihàrul-Enuàr”, vëll. 42, f. 146.

Zerareh u përgjigj: “Ai thotë: “Allahu i Lartësuar krijoi Muhamedin e Aliun. Që të dy i ngarkoi me detyra dhe ata të dy krijuan, furnizuan. Allahu bëri që ata të dy të vdesin dhe Ai i ringjalli të dy.”

Atëherë Imam Aliu tha: “Gënjen, armiku i Allahut! Kur të shkosh te ai, lexoi ajetin 16 të sures “Err Rad”:

أَمْ جَعَلُوا لِلَّهِ شُرَكَاءَ خَلَقُوا كَخَلْقِهِ فَتَشَبَّهُ الْخَلْقُ عَلَيْهِمْ قُلِ اللَّهُ خَلَقَ كُلَّ شَيْءٍ وَهُوَ الْوَاحِدُ الْقَهَّارُ

“...em xhealù lil'làhi shurekàe khalekù kekhalkihi feteshabehel-khalku alejhim kuli-l'làhu khàliku kul'li shej'in ue huvel-vàhidul-kah'hàru”

“... apo ata i bënë shokë Allahut ato zotat e tyre dhe ato (idhujt që ata i bënë shokë Allahut) krijuan siç krijoi Ai dhe atyre krijimi u është bërë i pa qartë; thuaj: Allahu është Krijuesi i ç'do sendi, Ai është Një e i Vetëm, Ngadhënjyesi.”

Pastaj shkova te ai burri dhe e njoftova. Më dukej sikur gëlltita një gur.” Tjetër ka thënë: “Më dukej sikur më merrej goja.”⁵⁴

⁵⁴ “Bihàrul-Enuàr”, vëll. 25, f. 344.

11. NIMETULL'LLÀH ELXHEZÀNERIJ (1112 Hixhreti)

Niëmetull'llàh Elxhezànerij, në librin e tij “El-enuàru-n’nuëmànij’jeh” thotë: “Abdullah ibn Sebes i ka thënë Aliut (*Allahu i ndriçoftë fytyrën!*): “Ti me të vërtetë je Zoti.”

Për këtë fjalë, Aliu e internoi në krahinat e largëta.

Gjithashtu thuhet: “Ai ishte jehudi, që pranoi Islamin. Kur ai ishte në fenë e jehudive, thoshte për Jeshu ibn Nunin dhe për Musain të njëjtat fjalë që thoshte për Aliun...”⁵⁵

12. MUHAMMED BAKIR ELKHUNESARIJ (1313 Hixhreti)

Muhammed Bakir Elkhunesarij e ka përmendur Ibn Seben, ashtu siç e ka përshkruar i drejti, i sinqertë, i cili e ka mallkuar dhe e ka akuzuar atë për gënjeshtar e falsifikator.⁵⁶

⁵⁵ “El-Enuàru-n’nuëmànij’jeh”, vëll. 2, f. 234.

⁵⁶ “Reudàtul-xhen’nàt”, vëll. 3, f. 133, Boton: Shtëpia botuese “Ed’ dârul-islamij’jeh”, Bejrut.

13. MIJRZA EN'NURIJ ET'TABRESIJ (1320 Hixhreti)

Shejhu i nderuar, En'nurij, në librin e tij "Mustedrekul-Vesàili", kapitulli "Gjykimi i ekzagjeruesve dhe i kaderive", në kuadrin e njoftimit të përcjellë prej Amar Es'sabatij", ka thënë: "Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu, u vendos në banesën e Kisras. Bashkë me të ishte edhe astrologu i Kisras, Delf ibn Muxhijri. Pasi dielli u anua kah perëndimi, Prijësi i besimtarëve i tha Delfit: "Ngrihu dhe eja me mua!"... Dhe në vijim Amar Es'sabatij tha: "Pastaj ai pa një kafkë të lënë mbi tokë. Kafka ishte e prishur nga kalbja dhe i tha njërit prej shokëve të tij: "Merre këtë kafkë!" Pastaj u kthye në banesë dhe u ul. Ndërkaq urdhëroi t'i sillnin një enë, në të cilën ai derdhi ujë dhe pastaj i tha atij që mori kafkën: "Fute kafkën në enë!"

Pastaj tha: "Betohem mbi ty o kafkë, më thuaj kush jam unë? Dhe cili je ti?"

Kafka foli me një gjuhë të qartë e të pastër: "Ti je Prijësi i besimtarëve, je zotëria i të porositurve dhe Imami i të devotshmëve, nga pamja e jashtme dhe nga ana e brendshme, kurse unë jam robi i Allahut dhe biri i robëreshës së Allahut, Kisra Enu Shijrvan.

Njerëzit që ishin aty, së bashku me disa prej banorëve të Sabatit, kur shkuan te familjet e tyre, i njoftuan njerëzit e tyre për ato që panë e që dëgjuan prej kafkës. Ata u trazuan dhe patën kundërshtime për kuptimin e fjalës “Prijësi i besimtarëve”. Ata shkuan te ai dhe thanë ashtu siç thanë kristianët për Mesium dhe ashtu siç tha Abdullah ibn Sebe dhe ndjekësit e tij, të cilëve i tha: “Nëse ju e leni në këtë, njerëzit do të mohojnë.” Kur Prijësi i besimtarëve e dëgjoi këtë fjalë prej tyre, u tha shokëve të tij: “Ç’dëshironi të bëj me ta?” Ata thanë: “Digji në zjarr, ashtu siç dogje në zjarr edhe Abdullah ibn Seben me ndjekësit e tij.”⁵⁷

14. ELMAMEKANIJ (1351 Hixhreti)

Elmamekanij ka shkruar për Ibn Seben në librin e tij “Tenkijhul-mekâl” dhe ka thënë: “Ai është përmendur në librin “Men là Juhdiruhul-fekijjhu”-“Atij që nuk i ka shkruar fekiyhu”, në kapitullin “As’hàbu emijril-muëminijne”-“Shokët e Prijësit të besimtarëve”, pastaj citon fjalën e Sadukut: “Abdullah ibn Sebe u kthye në mohim dhe shfaqti ekzagjerime.” Pastaj tha: “Ekzagjeruesi i mallkuar, të cilin Prijësi i besimtarëve e dogji në zjarr, për

⁵⁷ “Mustedrekul-Vesàili”, vëll. 18, f. 168; Gjithashtu lexo librin “Medijnetul-meàxhizi”, vëll. 1, f. 226.

shkak se gënjente kur thoshte se Aliu është Zot dhe ai ishte profet.”

Më pas ai përmend njoftimet e ardhura prej Eleshijit për Abdullah ibn Seben.⁵⁸

15. MUHAM'MED HUSEJN ELMUDHAF'FERIJ (1369 Hixhreti)

Dijetari Muham'med Husejn Elmudhaf'ferij, që është prej dijetarëve bashkëkohës, nuk e mohon ekzistencën e Ibn Sebes, por mohon që shi'at të kenë ndonjë lidhje me të. Për këtë ai thotë: “Përsa u përket atyre që besojnë ato që kanë thënë disa autorë, se baza e Shi'izmit është prej stisjeve të Abdullah ibn Sebes, i njohur me epitelin Ibn Seudas, ky mendim është iluzion dhe njohje e pakët për medh'heibn e tyre. Ai që e pohon pozitën e këtij burri të shi'at, si dhe mospërgjegjësinë e shi'ave ndaj fjalëve e ndaj punëve të tij dhe ka dijeni për thëniet e dijetarëve të shi'ave, të cilët e kanë atakaur Ibn Seben pa asnjë kundërshtim në mesin e tyre, ka dijeni të mjaftueshme për vërtetësinë e kësaj fjale.”

⁵⁸ “Tenkijhul-mekâl fîj ilmi-rr'rixhâl”, vëll. 2, f. 183 dhe f. 184.

16. SHERIJF JAHJA EL-EMIJN

Ky autor ka shkruar për Abdullah ibn Seben në librin e tij “Muëxhemul-firekil-islami’jeh”, në të cilin thotë: “Sebijtë janë ndjekësit e Abdullah ibn Sebes, i cili ekzagjeroi për Imam Aliun dhe ka pretenduar se ai vetë është profet. Më pas ai ka vazhduar me ekzagjerimet e tij, derisa tha se Aliu është Zot, madje i tha drejtpërdrejt: “Me të vërtetë, ti je Zoti!”. Imami, për këtë fjalë, e internoi atë në krahinat e largëta.

Kur u vra Aliu, Ibn Sebe tha: “Ai as nuk ka vdekur e as nuk është vrrarë. Në të vërtetë, Ibn Mulxhemi ka vrrarë një shejtan që ai atij i ngjau me fytyrën e Aliut dhe se Aliu është në re. Bubullima është zëri i tij, rrufeja është kamxhiku i tij. Më pas Aliu do të zbresë në tokë, të cilën do ta mbushë me drejtësi. Kur sebijtë dëgjojnë bubullimën, thonë: “Ue alejkes selàmu jà emijrel-muëminijne” – “Selam, paqe e shpëtim, për ty o Prijës i besimtarëve”.

Ibn Sebe ka thënë: “Në të vërtetë, Aliu është ngjitur lart në qiell, ashtu siç u ngjit Isai, biri i Merjemes (*Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë për të!*). Jehuditët e kristianët gënjejnë kur thonë se Isai u vra, po kështu gënjejnë edhe adhuruesit e engjëjve e havarixhët, kur thonë se Aliu është vrrarë. Në të vërtetë, jehuditët e kristianët kanë parë një person të kryqëzuar që atyre u dukej se ishte Isai (*Paqja e shpëtimi i*

Allahut qoftë për të!). Po kështu gënjejnë edhe ata që thonë se Aliu është vrrarë, por, në të vërtetë, ata kanë parë një të vrrarë që i shëmbëllente Aliut dhe kujtuan se ai i vrrarë ishte Aliu.

Gjithashtu sebiqtë thonë: “Ne jemi udhëzuar prej një shpalljeje, nga e cila njerëzit kanë rënë në rrugën e humbjes dhe prej një diturie të panjohur prej njerëzve! Ata gënjejnë kur pretendojnë se i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka fshejtur nëntë të dhjetat e shpalljes.

Sebiqtë janë grupi i parë që ka folur për përfundimin, përmendjen e tjetrit me fjalë të padenja, pa praninë e personit për të cilin flitet dhe për kthimin. Sebiqtë janë prej grupeve të zhdukura. Lexo ‘Ekzagjeruesit’”⁵⁹

17. SAIB ABDULHAMIJD

Përsa u përket shi’ave, ky dijetar ka shkruar: “Në të vërtetë, shi’at kanë transmetuar me përcjellës të gradës “Sahijh” – “të saktë” prej tre Imamëve të tyre: Zejnel-

⁵⁹ “Muëxhemul-firekil-islamij’jeh” – “Enciklopedia e grupimeve islame”, f. 132.

Abidijn, Muhamed Bakir dhe Xhafer Sadik. Të tre Imamët e kanë mallkuar Abdullah ibn Seben dhe ndjekësit e tij.”

Më pas ka thënë: “Nëse ibn Tejmijeh dëshiron të njohë të vërtetën për këtë jehudi të djegur në zjarr (ibn Sebe), le të lexojë vetëm librat e shi’ave.”⁶⁰

Këto ishin disa prej mendimeve të dijetarëve shi’i, të cilët e kanë theksuar Abdullah ibn Seben në veprat e tyre, e kanë shpallur atë mohues e ekzagjierues dhe e kanë bërë detyrim që të mos mbahet asnjë përgjegjësi ndaj tij. Gjithashtu ata kanë deklaruar se është detyrim që ai të mallkohet, ashtu siç e kanë mallkuar atë Imamët.

* * *

⁶⁰ “Ibnu Tejmij’jeh, hajàthù ue akàiduhù”-“Ibni Tekmijeh, jeta dhe doktrinat e tij”, f. 237-238, Botues: Shtëpia botuese “Elgadijr”, Bejrut.

AUTORËT QË E MOHOJNË EKZISTENCËN E TIJ

Grupi i studiuesve e dijetarëve shí'i, që e mohojnë ekzistencën e Abdullah ibn Sebes janë shprehur se ai është thjesht një figurë legjende, mit dhe se nuk ka ekzistuar mbi këtë tokë. Këta studiues e dijetarë mund të ndahen në dy pjesë: njëra pjesë prej tyre kanë shkruar për figurën e Abdullah ibn Sebes studime të veçanta e të thelluara, kurse pjesa tjetër e ka përmendur atë në përgjithësi dhe shkurtimisht.

Prej atyre që kanë marrë përsipër të shpallin të pavërtetë gënjeshtrenë e Abdullah ibn Sebe në studimet e tyre rendisim:

1. EL-ALAMEH MURTEDA EL-ASKERIJ...studim historik

Prej studiuesve që e kanë shqyrtuar me hollësi çështjen Ibn Sebe, kanë vërtetuar se tregimi për figurën e

Abdullah ibn Seben është një trillim që s'ka asnjë bazë prej së vërtetës, është edhe dijetari bashkëkohës Es'sej'jid Murtedà El-askerij.

Es'sej'jid El-Askerij ka bërë një vëzhgim të plotë, të bazuar mbi një studim të gjerë për Abdullah ibn Seben. Studimi i këtij dijetari ka rezultuar në një libër me dy vëllime, me titull “Abdullah ibn Sebe dhe legjenda të tjera”.⁶¹

Ky studiues serioz ka vërtetuar me argumente historike, të pakundërshtueshme dhe, në sajë të një studimi konkret, për origjinën e kësaj figure legjendare ka thënë se ai është vetëm një trillim. Por armiqtë e shi'ave e hedhin mbi shi'at pa asnjë argument shkencor e pa asnjë dokument historik. Me sipër kemi folur për studimin e Sej'jid Murtedà El-askerijit, kur kemi trajtuar rrënjët historike të tregimit të Ibn Sebes dhe kemi parë se ky autor bashkëkohës ka shpjeguar se ai që e ka sjellë në skenë Abdullah ibn Seben është Taberiji, me rrugën e përcjellësit vënës njoftimesh, Sejf ibn omer. Gjithashtu, ky autor pohon se rruga e përcjelljes së këtij njoftimi përmbledhet vetëm në Sejfin, për të cilin Es'sejid El-Askerij ka folur në punimin e tij kushtuar jetëshkrimit të figurës mitike, Abdullah ibn

⁶¹ Botimi i parë i vëllimit të parë ka dalë në Nexhefi Eshref të Irakut, në vitin 1375 Hixhreti në Irak. Më pas është ribotuar në Kajro; Vëllimi i dytë është botuar në Teheran dhe më pas në Bejrut.

Sebes. Në këtë punim ai ka vërtetuar se ky përcjellës është prej përcjellësve të gradës “daijf”-“dobët”, është prej përcjellësve që askush nuk i merr në konsideratë njoftimet e ardhura prej tij, ashtu siç janë shprehur për këtë çështje dijetarët e mëdhenj që kanë atakuar modifikimet e ndryshimet dhe kanë vërtetuar se themelet e tregimit për Abdullah ibn Seben janë ndërtuar mbi një mit që rrokulliset në greminë dhe nuk qëndron dot para studimit e diskutimit objektiv, me të cilin ka ardhur talenti i këtij studiuesi të shquar.

Dijetari El-Askerij ka shkruar edhe një studim tjetër rreth këtij subjekti. Deri tani është botuar vetëm vëllimi parë i këtij studimi prej 366 faqesh, “El-usturetu-s’seb’ij’jetu kemà tekha’jelehà ue ikhtelekahà Sejf ibn Umer”-“Legjenda Sebe, ashtu siç e ka imagjinuar dhe e ka stisur Sejf ibn Omeri”. Ky libër është botuar në vitin 1424 Hixhreti dhe është botim i Fakultetit të Bazave të Fesë, pranë Qendrës Shkencore në qytetin Kom të Iranit.

2. DR. ALI ELVERDIJ... studim i thelluar

Dr. Ali Everdij, pedagog në universitetin e Bagdadit, e fillon tregimin për Abdullah ibn Seben me një ngjarje, të cilën ai e thekson në librin e tij. Ngjarja, në mënyrë të përmbledhur, është si vijon: “Një ditë dëgjova një prift që

vinte në lojë Islamin, duke thënë: “Shikoni këtë fe, që me fitoret e saj, ishte në majat e madhështisë, por menjëherë bëhet pre e lehtë e një jomyslimani, për të cilin historia njeh shumë pak gjëra. Në mësimet e Profetit të tyre shohim një të huaj, shohim një jehudi që hyn në këtë shoqëri, të cilën ai arrin ta shqyejë në mënyrë të frikshme, sa e bën copë-copë. Askush nuk ngre dorën kundër këtij të huaji, askush nuk e dëbon apo ta shtypë.”⁶²

Më pas ky autor shpalos mendimet e studiuesve që mbështesin ekzistencën e një personi të tillë, si dhe mendimet e studiuesve që nuk e pranojnë se ai person ka ekzistuar. Në këtë pikë, autori shtron pyetjen: “Këtu mbetemi të habitur mes dy mendimeve kontradiktore: A ishte Ibn Sebe një person konkret, apo është një iluzion i trilluar?”

Kjo është një pyetje shumë e rëndësishme për cilindo që ka qëllim të studiojë historinë e shoqërisë islame dhe të marrë në konsideratë këshillat e saj të shumta. Për ne është plotësisht e drejtë, që pyetjen ta shtrojmë në një mënyrë tjetër dhe të themi: A kishte nevojë shoqëria islame e asaj kohe për ndonjë person të huaj, i cili të shkaktonte e të nxiste ngatërresa?

⁶² “Vuadh’ dhu-s’ selâtijn”-“Këshilluesit e mbretërve”, f. 96, Botuar në Bagdad, Irak.

Duket se historianët që kanë cituar tregimin e Ibn Sebes, mendojnë se shoqëria islame në atë kohë ishte e kënaqur, e qetë, e sigurt dhe s’kishte asgjë që mund të sillte shqetësim në atë shoqëri. Prandaj unë mendoj se ata historianë të tipit të këshilluesve, të cilët, në mendimin e tyre, ndjekin logjikën e Talesit të kohës së vjetër, kur shikojnë një lëvizje shoqërore, çuditën dhe pyesin njëri-tjetrin sikur lëvizja, në këndvështrimin e tyre, është parregullsi e natyrës së shoqërisë, ose ajo është një ngjarje kalimtare në atë shoqëri.

Logjika shoqërore moderne thotë se shoqëria është me natyrë lëvizëse origjinale dhe se shoqëria është në ndryshim të përhershëm, apo siç e kanë emërtuar këtë ndryshim në terminologjinë shkencore me fjalën “proces”.

Logjika moderne nuk çuditet kur shejh shoqërinë të lëvizë, në të kundërt, ajo çuditet e pyet kur e shejh shoqërinë në qetësi, pasi qetësia, në pikëpamjen e logjikës moderne, është parregullsi e ardhur, kurse lëvizja, në shumicën e rasteve, është baza mbi të cilën qëndron struktura shoqërore.

Shoqëria islame e periudhës gjatë së cilës Ebu Dherri shfaqti mendimet e tij, vuante prej një krize shoqërore shumë të madhe, për shkak se dallimi mes të pasurit e të varfrit ishte aq i gjerë, sa revoltonte shpirtrat.

Revolta në atë kohë ishte një domosdoshmëri dhe ne nuk kemi nevojë të analizojmë shfaqjen e revoltës, por kemi nevojë të kundërtën, kemi nevojë të analizojmë rastin sikur në atë kohë të mos kishte ndodhur ajo revoltë, ose ajo lëvizje.”

Më pas El-Verdij thotë: “Për mua mbetet i paqartë fakti se përse ajo lëvizje i atribuohet një personi si Ibn Sebe, që ishte vetëm një trillim e asgjë më shumë, ashtu siç ka thënë për të edhe dr. TàHà Husejn.

Duket qartë se kjo figurë është stisur në mënyrë të përkryer prej atyre të pasurve, kundër të cilëve drejtohej revolta. Dihet se kështu kanë vepruar shtresat që jetojnë në mirëqenie, në të gjitha etapat e historisë, ndaj atyre që ngrenë krye kundër tyre.

Për të gjitha revoltat shoqërore armiq të revoltave thonë se ato i ka shkaktuar një i huaj, ashtu siç e ka theksuar këtë fakt studiuesi, sociologu i njohur, profesor Smilli.

Në këtë kuadër vlen të theksohet se edhe vetë Muhamedin, në fillimet e thirrjes së tij, kurejshët e akuzuan se merrte mësimë prej një djali kristian, të quajtur Xheber.⁶³

Më pas, disa të tjerë e akuzuan se ai i merrte mendime prej murgut Behijra, ose prej Selman Farisiut dhe prej të tjerëve.⁶⁴

Çdo parim të ri, shtresat që jetojnë në mirëqenie ia atribuojnë ndikimit të një rryme të huaj, ose një të huaji dhe, siç e shpjegon prof. Smilli, kështu ka ndodhur në periudha të ndryshme të historisë.”⁶⁵

Dr. El-Verdij, gjithashtu, thotë: “Historianët, shkakun kryesor në atë ngatërresë të madhe, ia atribuojnë Abdullah ibn Sebes, një të huaji jehudi që hyri në Islam, me qëllim që të bëjë mashtrime e makinacione në të.

Duket qartë se zotëruesit e pronave të mëdha, që dolën në kohën e Uthmanit, panë se zemërimi i masës ndaj pasurive të tyre, për të cilat është pak të quhen të mëdha, po u gërryente tokën nën këmbë, prandaj ata quajtën shkaktar të atij zemërimi një jehudi të huaj, që kishte

⁶³ Lexo Hasenejn Hejkelin, “Hajātu Muham’med” – “Jeta e Muhamedit”, f. 136, Botuar në Kajro.

⁶⁴ Lexo Abdurrahman Bedevij, “Shakhsj’jätun kalikatun fil-Isàm” – “Personalitete shqetësuese në Islam”, f. 33, Botuar në Kajro.

⁶⁵ “Vuadh’ dhu-selätijn” – “Këshilltarët e mbretërve”, f. 97-98.

qëllim të mbillte mashtrime e trillime në Islam e ndër myslimanët. Natyrisht që me atë stisje ata kishin qëllim të mbulonin shkakun origjinal të revoltës ulëritëse kundër tyre.

Punët e mëdha që i atribuohen Abdullah ibn Sebes, mund t'i bëjë vetëm një gjeni, ose një magjistar, ose ndonjë person i një kallëpi të shquar, që ka fuqi magnetizuese gjumëvënëse, i cili, patjetër duhet të ketë sy me fuqi magnetizuese aq të fuqishme, sa të thyejë edhe gurët, ose ai ka një fuqi shpirtërore aq të madhe, sa i bën njerëzit që ka përpara si të ishin dhenë dhe që ndikohen prej fjalëve të tij, pa e ndier se nga i vjen ai ndikim.

Sikur në kohën e Uthmanit të ishte shfaqur një burrë i tillë, me siguri që në një mënyrë a në një tjetër, do të kishte arritur të ne përshkrimi i tij. Por e çuditshme është se nuk gjejmë që Ibn Sebe të përmendet në burimet e rëndësishme që flasin për ngjarjet që kanë ndodhur gjatë hilafetit të Uthmanit.

Unë nuk kam gjetur në histori ndonjë tregim të trilluar, që të trumbetohet e të mbetet gjatë gjithë kohëve si tregimi i këtij personi, por gjejmë se Ibn Sebe ka trazuar mendjet e shumë dijetarëve. Sikur Ibn Sebe të ishte një

person i vërtetë, patjetër që ai do të qante shumë e do të hidhte poshtë këto akuza të shumta që hidhen mbi të.”⁶⁶

Në fundin e kapitullit të pestë të librit të tij, dr. El-Verdij, shkurtimisht ka regjistruar rezultatin: “Abdullah ibn Sebe gjendet në çdo kohë e në çdo vend. Pas çdo lëvizjeje të re mund të jetë një Ibn Sebe. Nëse ajo lëvizjeje del me sukses, emri i Ibn Sebes fshihet prej historisë së asaj lëvizjeje dhe ajo lëvizjeje bëhet e lavdëruar. Por, kur lëvizja dështon, mjerimi do të bjerë mbi kokën e Ibn Sebes dhe nga të gjitha anët do të hidhet pluhur mbi cilësitë e tij.

Në të vërtetë Ibn Sebe nuk është i qetë në asnjë gjendje. Në çdo rrugë ai gjithmonë përfiton prej rastit dhe, derisa padrejtësia të jetë e pranishme, Allahu na ruajttë, çdo njeri mund të jetë sebi, mund të jetë ndjekës i Abdullah ibn Sebes.”⁶⁷

⁶⁶ Burimi i sipërm, f. 111.

⁶⁷ “Vuadh’ dhu-s’ selâtijn”, f. 115.

A ËSHTË AMAR IBN JASERI IBN SEUDA?

Autori është ndikuar prej fjalës së të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili, duke përmendur sahabiun e nderuar, Amar ibn Jaser, ka thënë se atë do ta vrasë grupi i padrejtë. Në të vërtetë, Amari u vra në Luftën e Sifijnit prej ushtrisë së Muavijes.

Në njoftimet e transmetuara thuhet se Ibn Arebij, në librin e tij ka përmendur se një herë Amari ka thënë: Uthmani është “errësirë nate tullace”. Por, kur Aliu e dëgjoi Amarin të shprehet kështu për Uthmanin, e qortoi rëndë. Pikërisht kjo i ka shtyrë historianët të thonë se sebijtë u lidhën me Amarin dhe u takuan me të që ta bënin për vete.⁶⁸

Dr. El-Verdij, pasi citon fjalët e mësipërme të Ibn Arebijit, thotë: “Këta historinë nuk kanë thënë se Amari ishte sebij dhe duket se ata s’kanë guxuar të lëshojnë mbi Amarin këtë epitet të përçmuar, sepse ai është një sahab shumë i nderuar, është prej atyre që janë torturuar shumë

⁶⁸ “El-avàsimu uelkavàsimu”, f. 150-151.

në rrugën e Allahut, madje vetë Profeti ka folur shpesh për virtytin e tij.

Realisht Amari ishte sebij, në kuptimin e plotë gjuhësor që ka kjo fjalë dhe ai vazhdoi të ishte sebij derisa vdiq. Unë kam idenë se ai ishte lideri më i madh i sebijve, pasi me të vërtetë është biri i vetë Sebeit.”⁶⁹

Më pas El-Verdij, duke pyetur, thotë: “Këtu mund të dalë dikush e të pyesë: Ku shkoi Ibn Sebe në ato trazira luftërash të mëdha?

Por më e çuditshme është se ne e gjejmë Ibn Seben në të gjitha ngjarjet që kanë të bëjnë me revoltën kundër Uthmanit, si dhe në ngjarjet që ndodhën pas tij. Më pas shikojmë se ai mungon në betejën e Sifijnit, ditën kur u vra Amar ibn Jaseri. Përse u fsheh ky dinak demagog në atë luftë të tmerrshme dhe ku u fsheh?

Historianët nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje trullosëse, as pak e as shumë.

Realisht Ibn Sebe nuk është fshehur gjatë luftës së Sifijnit. Në të kundërt, ai nuk ka ekzistuar fare që të fshihej, pasi ai është vetëm një trillim, ashtu siç e thamë në

⁶⁹ “Vuadh’ dhu-s’ selàtij”, f. 172 dhe f. 174.

kapitullin e mëparshëm. Në të vërtetë, trillimi vjen e shkon sipas qëllimit të atyre që e kanë stisur trillimin.”

Më pas El-Verdij shton: “Mua më duket se tregimi për Ibn Seben, nga fillimi deri në fund, është një rrëfenjë e thurur në mënyrë të përsosur dhe me mjeshtri të lartë përfytyrimi. Është fakt se kurejshët nuk dalloheshin për mençuri vetëm në fushën e politikës, por ata ishin mjeshtra edhe në artin e tregimeve. Duket se kurejshët, gjatë kohës së Uthmanit, flisnin për Amar ibn Jaserin në mbledhjet e tyre të veçanta dhe në fshejtësi e shanin atë, por mendonin se në atë kohë nuk ishte në interesin e tyre që të shpallnin para njerëzve sharjet që ata lakonin në adresë të tij.

Mbase ndonjëri prej përcjellësve të njoftimeve i ka dëgjuar kurejshët të përmendnin Ibn Seudan dhe ta shanin atë. Por ky përcjellës ka menduar se fjala Ibn Seuda, për të cilin flisnin kurejshët, është për ndonjë person tjetër dhe jo për Amar ibn Jaserin.

Ka të ngjarë që tregimi për Ibn Seben, në fillim mund të ketë lindur prej këtij mendimi të gabuar dhe më pas, rreth tij, pak e nga pak, janë thurur legjenda të shumta.

Prej çudirave të historisë është kur shikojmë se shumë prej punëve që i atribuohen Ibn Sebes, në një formë

ose në një tjetër, i gjejmë edhe në jetëshkrimin e Amar ibn Jaserit. Natyrisht që ky fakt bën që të mendohet mbi të.

Në vijim do të shpalos për lexuesin disa prej atyre punëve që janë të përbashkëta për Amarin e për Ibn Seben dhe lexuesi le të japë mendimin e tij për to.

1- Ibn Sebe, njihej me epitetin Ibn Seuda dhe ne pamë se edhe Amari, në shprehjet e kurejshëve, thirrej me epitetin përçmues Ibn Seuda.”⁷⁰

2- Babai i Amarit ishte nga Jemeni. Kjo do të thotë se ai ishte prej bijve të Sebeit dhe çdo jemenas shpreh të vërtetën, kur thotë se ai është bir i Sebeit, pasi të gjithë banorët e Jemenit e kanë origjinën te Sebe ibn Jashxheb ibn Jareb ibn Kahtan.

Në Kur’anin Famëlartë tregohet se shpendi hud-hud i tha Sulejmanit (*Paqja e shpëtimi i Allahut qoftë mbi të!*) se ai kishte ardhur prej Sebeit dhe me Sebein, qëllimi ishte për Jemenin.

3- Veç kësaj, Amari kishte një dashuri shumë të madhe për Ali ibn Ebu Talibin. Bënte thirrje për të

⁷⁰ Në fillim të këtij kapitulli dr. El-Verdij ka theksuar fjalët e kurejshëve. Ne pamë se ata e thërrisnin Amarin skllav dhe biri i zezakes.

ndihmuar Aliun me të gjitha rrugët dhe i nxiste njerëzit të jepnin besën për të.

El-alusiji tregon: “Një burrë erdhi te Amari dhe i kërkoi t’i shpjegojë ajetin 82 të sures “En Neml” të Kur’anit:

❁ وَإِذَا وَقَعَ الْقَوْلُ عَلَيْهِمْ أَخْرَجْنَا لَهُمْ دَابَّةً مِّنَ الْأَرْضِ تُكَلِّمُهُمْ

“Ue idhà veka’al-kaulu akhrexhnà lehum dàb’beten minel-erdi tukel’limuhum...”

“Dhe kur mbi ata fjala (dënimi) të bëhet realitet, Ne do të nxjerrim një gjallesë prej tokës që do t’i flasë atyre...”
Amari, për gjallesën që përmendet në këtë ajet, thotë: “Ajo gjallesë është Ali ibn Ebu Talibi.”⁷¹

Kjo fjalë që thuhet prej Amarit është e ngjashme me fjalën që thotë Ibn Sebe, për të cilin thonë se besonte në kthimin e Aliut në jetë, pas vdekjes së tij.

4- Gjatë kohës kur Uthmani ishte në krye të hilafetit, Amari shkoi në Egjipt dhe filloi të nxisë njerëzit kundër Uthmanit. Gjithashtu thuhet se për këto aktivitete të

⁷¹ “Ruhul Me’ânij”, vëll. 6, f. 312.

Amarit, guvernatori bëri zhurmë dhe ishte i vendosur të vinte dorë mbi të.”⁷²

Ky njoftim është i ngjashëm me atë që thuhet edhe për Ibn Seben, se edhe ai u vendos në Egjipt. Pastaj qytetin Fustat e bëri qendër të thirrjes së tij dhe prej aty ai filloi të mbajë korrespondencë me përkrahësit e vet.

5- Ibn Sebes i atribuohet kjo thënie: “Uthmani e mori hilafetin me pa të drejtë dhe se personi ligjor të cilit i takon hilafeti është Ali ibn Ebu Talibi.

Në të vërtetë, kjo është fjala e vetë Amar ibn Jaserit, i cili është dëgjuar ditën e bësëdhënies për Uthmanin të thërrasë me zë të lartë në xhami: “O kurejsh! Nëse ju e hiqni këtë punë prej shtëpisë së Profetit tuaj, duke ia dhënë herë njërit e herë tjetrit, unë nuk kam më siguri që Allahu nuk do ta heqë këtë detyrë prej dorës suaj dhe do t’ua japë të tjerëve, ashtu siç e hoqët ju prej familjes së tij dhe e vutë në të tjerë që s’janë të familjes së tij.”⁷³

6- Ibn Sebes i atribuohet se pengoi orvatjet e Aliut për të arritur paqen mes tij e mes Aishes në pragun e Betejës së Basras. Kushdo që lexon hollësi që kanë të bëjnë me Betejën e Basras, do të gjejë se Amari ka një rol shumë

⁷² Lexo dr. TàHà Husejn, “Elfitnetul-kubrà”, vëll. 1, f. 128.

⁷³ Lexo Abdulhamijid Es’she’hàr, “Ehlul-Bejti”, f. 66, Botuar në Kajro.

aktiv në atë betejë dhe është Amari ai që shkoi së bashku me Hasanin e me Malik Eshterin, në Kufe për të nxitur nxjerrjen që të bashkoheshin me ushtrinë e Aliut.

7- Edhe për Ibn Seben kanë thënë: “Ai është personi që nxiti Ebu Dherrin të ngrihej në lëvizjen e tij sociale.” Sikur ne të studiojmë lidhjen e Amarit me Ebu Dherrin, do të gjejmë se ajo ishte një lidhje shumë e fortë, të dy ishin prej të njëjtës shkollë, prej shkollës së Ali ibn Ebu Talibit.

Ebu Dherri s’kishte nevojë ta mësonte Ibn Sebe, se plaçka e luftës është pasuri e myslimanëve, ose nuk është e drejtë që plaçka e luftës të quhet pasuri e Allahut. Dy shokët e Ebu Dherrit, Amari dhe Aliu, qëndrojnë më lart se kushdo tjetër, që t’i mësonin atij këtë çështje, nëse ai me të vërtetë nuk e dinte.”

Në fund, dr. El-Verdi arrin në përfundimin: “Nga e gjithë kjo që u tha më lart, del se Ibn Sebe nuk është askush tjetër përveçse Amar ibn Jaseri. Kurejshët e konsideronin Amarin kreun e revoltës kundër Uthmanit. Në fillim të asaj pune nuk deshën ta thoshin hapur emrin e tij, por e thanë me emrin Ibn Sebe, ose me epitetin Ibn Seuda. Përcjellësit e njoftimeve e përcollën këtë epitete krejtësisht të shkujdesur,

sepse ata, në të vërtetë, nuk kishin dijeni për punët që bëheshin prapa perdes.”⁷⁴

3- PROF. ABDULLAH ES'SEBIJTJ... studim historik

Profesori, dietari i shquar, shejhu Abdull'llah Es'sebijtij është prej dijetarëve të shi'ave në Irak dhe autor i shumë librave: “Tahte ràjetul-hak'k”-“Nën flamurin e së vërtetës”, “Elmubàheleh”-“Mallkimi i ndërsjellë”, “Haxhx'hetul-vedàë”-“Haxhi i lamtumirës”, “Selmàn Elfàrisij”-“Selman Farisiu”, “Ebù Dherr Elgaf'fàrij”-“Ebu Dherr Gafariu”, “Am'màr ibn Jàser”-“Amar ibn Jaseri” dhe “Hixhr ibn Adij”- “Hixhr ibn Adij”.

Ndër veprat e prof. Es'sebijtijit është edhe një libër tjetër i tij me vlera të larta, të cilin e shkroi në përgjigje të librit “Eljehudij'jetu fil-Islàm”-“Jehudizmi në Islam”, me autor njërin prej shejhëve të universitetit të Ez'herit.

Ky libër i profesorit ka një rëndësi të veçantë për disa arsye. Në këtë libër ai i përgjigjet trazirës që shkaktoi Sad Muham'med Hasen në tregimin për jetën dhe veprën e Ibn Sebes. Në këtë gjendje, prof. Es'sebijtijin i dilte detyra që çështjen ta trajtonte në mënyrë të detajuar, nëpërmjet

⁷⁴ “Vuàdhu-s'selàtij”, f. 176-180.

një studimi shtesë, ku përmend legjendën e sebijve, bazuar në argumente të shumta historike.

Që në fillim të studimit të tij,⁷⁵ prof. Es'sebijtij thekson: "Sebijzmi, si rrymë, as nuk ekziston e as nuk ka ndonjë ndikim, përveçse në botën e iluzioneve dhe në fantazinë e armiqve të shi'ave, të cilët kanë nevojë për një ekzistencë të jashtme. Më pas profesori shpjegon qartë se kjo legjendë është vetëm një pjesë e akuzave që armiqtë kanë hedhur mbi Shi'izmin gjatë gjithë historisë së këtij medh'hebi.

Legjenda e Sebijzimit ashtu siç shkruan prof. Es'sebijtij, është një stisje e çuditshme, që nuk qëndron para studimit të hollësishëm. Kushdo që i nënshtrohet logjikës së studimit, nuk e vërteton e nuk e beson këtë legjendë.

Mjeti i vetëm i kohëve të hershme për mbulimin e së vërtetës ishte lëshimi i akuzave që ata i përhapnin për të sulmuar armiqtë dhe kjo është ajo që ka ndodhur me shi'at, kundër të cilëve armiqtë e tyre stisën Sebijzmin dhe Abdullah ibn Seben. Pastaj këtë stisje të tyre e hodhën mbi cilindo që përkrahte Ali ibn Ebu Talibin, ndryshe çështja e Ibn Sebes, ashtu siç flasin tregimet historike, do të shkaktonte vetëm tallje e do t'i bënte njerëzit të qeshnin.

⁷⁵ Lexo: "Ilà meshijkhatil-ez'her", f. 110-118.

Si është e mundur që Ibn Sebe e sebijtë të ngriheshin në mënyrë kaq të befasishme kundër jetës së myslimanëve në kohën e Uthmanit? Si e gjeti më pas Ibn Sebe mundësinë që, brenda një kohe fare të shkurtër, të ngrihet kundër halifes dhe ta vrasë atë, me qëllim që pas vrasjes së tij të shkaktonte ngatërresa në mesin e myslimanëve, për më tepër kjo ngatërresë (Sebijzmi) të dalë gjatë brezave e të rilindë gjatë shekujve?

Rrëfenjat flasin për një fuqi të padukshme të Ibn Sebes, i cili pati mundësi të fusë i vetëm në dorën e tij botën islame, edhe pse ajo ishte aq e gjerë dhe në kulmin e forcës e të fuqisë së saj. Këtë ai e arriti me anë të ushtës jehude, asaj ushte magjike, të fshejtë, e cila hapi një plagë në fe, u sul mbi moralet e myslimanëve dhe i bëri ato copë-copë.

Realisht njeriut nuk i mbetet asgjë veçse të pyesë: Si ka mundësi që jehudiu Abdullah ibn Sebe, i cili nga ana e mashtrimeve politike ia kalon edhe Ben Gurionit, nuk filloi pushtimin e Palestinës, të cilën jehuditët dëshirojnë që ajo të jetë “shteti i tyre kombëtar”, megjithëse të gjithë të tjerët e dinë mirë se jehuditë kanë qarë për tokën e premtuar, Palestinën, që ditën e parë?!

Në të vërtetë, fijet e politikës, nën nxitjen e imagjinatës e të fantazisë kanë endur një person legjendë, të paqartë, me emrin Abdullah ibn Sebe dhe gjithnjë,

nëpërmjet fantazisë, u përshkrua për këtë person një rol i planifikuar, me qëllim që të shkatërronte Islamin dhe të fliste hapur kundër tij. S'ka dyshim se e gjithë kjo është vetëm për qëllime politike.

A është detyrë të studiojmë në këtë person identitetin e asaj dore mëkatore, që pati guximin të stisë e ta përhapë këtë legjendë?!

Përgjigjen për këtë pyetje është e pamundur ta gjejmë në vorbullën e fanatizmit e të injorancës, pasi një përgjigje e dalë prej një mjedisi të tillë s'ka vlerë në peshoren e logjikës. Në të vërtetë, ajo që është në të gjithë prapavijën e çështjes qëndron në kundërshtimin që lindi rreth hilafetit. Është pikërisht ky kundërshtim që e lindi Ibn Seben dhe që çoi në tjerren e legjendës së Sebijzmit, të cilin më pas e përdorën si akuzë që hidhej mbi çdo kundërshtar të linjës zyrtare dhe ky person asgjësohej me argumentin se është ndjekës i Ibn Sebes.

Dr. TàHà Husejn thotë: “Janë të shumta argumentet që mbështesin këtë mendim të prof. Abdullah Es'sebijtij. Më sipër ne pamë se akuza e bashkëpunimit me Ibn Seben është shtrirë deri edhe te sahabët e nderuar, madje deri te sahabët që ishin afër te i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe*

bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), si Ebu Dherri dhe Amar ibn Jaseri.”⁷⁶

Nga ajo që ka shkruar dr. TàHà Husejn kuptohet se akuza mbi ndjekësit e Ibn Sebes është shtrirë deri edhe mbi Malik El-Eshterin.

Prej dëshmive të tjera që ne po sjellim për të shpjeguar se kjo akuzë u shndërrua në një mjet për të folur keq për armiqtë e pushtetit dhe shkak për t'i luftuar ata, është letra që guvernatori i Basras e i Kufes i shkroi Zijad ibn Ebijhit për Muavijen, kur arrestoi Hixhrin me shokët e tij, ndaj të cilëve u tregua shumë i ashpër. Pastaj, së bashku me letrën, i çoi ata te Muavija. Në atë letër lexojmë se si Zijadi e përshkruan sahabiun Hixhr dhe shokët e tij: “Djajtë e kësaj toke (në tekst: *turàbijeh*, fjalë që ka lidhje me togfjalëshin “*ebù turàb*”, që ishte epiteti i Prijësit të besimtarëve, Imam Ali ibn Ebu Talibit), si dhe “*seb’ij*”-të, kreu i të cilëve është Hixhr ibn Adij, kundërshtuan Prijësin e besimtarëve (do të thotë kundërshtuan Muavijen), përçanë bashkësinë e myslimanëve dhe filluan luftën kundër nesh, por Allahu na nxori ne të jemi kundër tyre.”⁷⁷

Le t'i rikthemi atyre që shejhu Es'sebijtij ka shkruar në fillim të studimit të tij, ku përmend se studiuesi

⁷⁶ “Alij'jun ue benùhu” – “Aliu dhe djemtë e tij”, f. 115.

⁷⁷ Lexo librin “Hixhr ibn Adij” të autorit, dijetarit të dëgjuar, Ekemraij, f. 66-67, botuar në Teheran, Iran.

objektiv, kur studion faktet me të cilat është rrethuar tregimi i Ibn Sebes, nuk gjen fushë që të bindet për të vërtetën se ai person ka ekzistuar, se ai ka një aktivitet e një pamje të jashtme. Prandaj ky studiues ka plotësisht të drejtë të pyesë për fuqinë e madhe që i atribuohet Ibn Sebes: Prej nga i erdhi atij kjo fuqi? Si mundi ai të fillojë lëvizjen e tij, kur ishte nën vëzhgimin e njerëzve të Uthmanit, të qeveritarëve e të guvernatorëve të Uthmanit? Si mundi ai të ketë aq fuqi, sa të mbizotërojë mbi shoqërinë islame?

Cili ishte Ibn Sebe? Si kishte mundësi të lëvizë e të qarkullojë në të gjitha trevat e botës islame për të përhapur thirrjen e tij, pa e bërë të heshtë shpata e emevive, ose që atë ta kapte ndonjë prej guvernatorëve të Uthmanit, ose, më e pakta, ta internonin, ta largonin, ose edhe ta arrestonin?

Gjithashtu, për studiuesin lind e drejta të pyesë edhe për ndjekësit e Ibn Sebes. Cilët ishin ata?

Ne e dimë mirë se përkrahës të Aliut ishin vetëm sahabët më të afërm të të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Atëherë, nëse me të vërtetë Ibn Sebe ka ekzistuar, duhej që ndjekësit e tij të ishin prej Ehli Syneetit.

Veç kësaj, kur Ibn Sebe kishte kaq shumë talente dhe kaq shumë kapacitet politik, ku janë jehuditët që nuk flasin për të? Përse emri i tij nuk përmendet në historinë e tyre? Si qe puna e tij dhe si qe e ardhmja e tij? Ç'u bë me ndjekësit e tij dhe si qe përfundimi i tyre?

Këto dhe pyetje të tjera nuk e lënë studiuesin e paanshëm të mos i shtrojë dhe të kërkojë përgjigje të qarta.⁷⁸

* * *

Është edhe një grup tjetër dijetarësh e ideologë shi'a që e mohojnë ekzistencën e Abdullah ibn Sebes, por që e nënvizojnë atë në përgjithësi e shkurtimisht dhe nuk kanë shkruar ndonjë studim për atë. Prej këtij grupi dijetarësh përmendim:

1- SHEJHU MUAHM'MED HUSEJN KÀSHIFUL-GITÀI

Në librin e tij “Aslu-sh'shij'ati ue usùluhà” – “Origjina e Shi'izmit dhe bazat e tij”, shejhu i nderuar, për Abdullah

⁷⁸ “Ilà meshijkhatil-Ez'her” – drejtuar meshihatit të Ez'herit, f. 115-118, Botuar në Bagdad në vitin 1375 të Hixhretit.

ibn Seben, thotë: “Nuk është larg mendimi i atij që thotë se tregimet rreth Abdullah ibn Sebes dhe rreth të marrit të tribusë beni Amir dhe të tribusë Ebu Hilal... dhe të ngjashëm me ata burra e me ata heronj, të gjitha këto tregime, janë njoftime mitike, të vëna prej autorëve të tregimeve, si dhe prej atyre që tregojnë përralla natën e prej atyre që bëjnë shaka.”⁷⁹

2- ÀJETULL’LLAHUL-UDHMA ELMUHAK’KIKU ES’SEJ’JID EBÛL-KÀSIM EKHÛIJ

Në enciklopedinë e tij, shejhu i nderuar, Elkhuij thotë: “Legjenda Abdullah ibn Sebe dhe tregimet e shumta rreth turbullirave që ai ka shkaktuar, janë stisje të vëna. Të gjitha janë të stisura prej gënjeshtarit demagog e vënësit të njoftimeve Sejf ibn Omerit. Ne nuk na premton vendi të zgjatemi e të sjellim argumente për këtë, por na mjafton, madje është shumë ajo që ka sjellë për ne dijetari i shquar dhe studiuesi i mirënjohur Es’sej’jid Murtedà El-Askerij me studimet e tij të thella e të detajuara rreth këtyre tregimeve mitike dhe rreth Sejfit e njoftimeve të vëna prej tij.”

⁷⁹ “Aslu-sh’shi’ati ue usùluhà” – “Origjina e Shi’izmit dhe bazat e tij”, f. 57-58, Botimi i 8-të, Kajro.

Të gjitha këto shejhu i nderuar i ka paraqitur në librin e tij me dy vëllime “Abdullah ibn Sebe dhe legjenda të tjera”, si dhe në librin tjetër të tij: “Njëqind e pesëdhjetë sahabë të stisur”⁸⁰.

3- ELALÀMEH ES’SEJ’JID MUHAM’MED HUSEJN ET’TABÀTÀIJ

Profesori dhe dijetari ynë i madh, Et’tabàtài, në tefsirin e tij “El Mijzan” ka thënë: “Këta dy persona, për të cilët njofton Taberiji dhe që kanë përcjellë njoftime të shumta rreth Uthmanit, e kam fjalën për Shuajbin e për Sejfin, janë gënjeshtarë e vënës njoftimesh dhe të njohur si mashtrues. Dijetarët që kanë shkruar biografitë e përcjellësve të njoftimeve, i kanë atakuar të dy për stisjet që ata bënë për Ibn Seudan, të cilin e kanë quajtur Abdullah ibn Sebe. Dihet se njoftimi i ardhur prej këtyre të dyve, si të gjitha njoftimet e tjera të vëna, përfundon vetëm në këta të dy. Kohët e fundit studiuesit kanë dalë me mendimin e

⁸⁰ Të dy librat janë botuar e janë shpërndarë disa herë në: Nexhefi Eshref, Bejrut, Teheran dhe Kajro.

“Muëxhemu rixhàlul-hadijth” – “Enciklopedia e burrave të hadithit”, vëll. 11, f. 207; lexo librin “Abdull’llàh ibn Sebe diràsetun ue tahliljun” – “Abdullah ibn Sebe”, studim dhe analizë, autori, shejhu Ali Al Muhsin, Botuar prej “Dàrul-hàdij” , Bejrut, në vitin 1423 të Hixhretit.

prerë se Ibn Seuda është prej stistjeve mitike, që s'kanë asnjë bazë nga realiteti.⁸¹

4- DR. KÂMIL MUSTAFÂ ESH'SHEJBIJ

Ky dijetar ka shkruar se Abdullah ibn Sebe është sahabiu i nderuar Amar ibn Jaser dhe se këto dy emra janë vetëm një burrë dhe jo dy vetë. Në vijim, doktori i nderuar thotë: “Mbi këtë bazë *sebjtë* janë një grup që e ka drejtuar Amar ibn Jaseri dhe janë kurejshët ata që ia kanë vënë atij këtë epitete dhe janë po kurejshët ata që kanë shtuar mbi mendimet e tij teprime e gjëra të gabuara. Të gjitha këto i kanë shtuar mbi mendimet e Amarit, me qëllim që t'i nxjerrin jashtë logjikës, të heqin prej mendimeve të tij fuqinë bindëse dhe të hedhin mbi mendimet e tij vellon e dyshimit e të pavlefshmërisë. E gjitha, kjo me qëllim që njerëzit të largoheshin prej mendimeve të tij e prej parimeve të tij në lidhje me të drejtën e virtytin e tij mbi të gjithë myslimanët e tjerë bashkëkohës të tij në kohën e Uthmanit.”⁸²

⁸¹ “Emijzànu fij tefsijril-Kur'an”-“Peshorja në interpretimin e Kur'anit”, vëll. 9, f. 260.

⁸² “Es'siletu bejne-t' tesav'vufi uet' teshej'jui”-“Lidhja mes Sufizmit e Shi'izmit”, vëll. 1, f. 89, Botuar në Kajro.

KAPITULLI I KATËRT

SHI'AT DHE EKZAGJERUESIT

EGZAGJERUESIT DHE EKZAGJERIMI TE SHI'AT

Prej delikteve më të rënda të historisë është që shi'ave dhe Shi'izmit i atribuohen Ibn Sebes, pavarësisht nëse ai ka ekzistuar apo jo, ose ai është thjesht një legjendë e trilluar, ashtu siç e theksuam më sipër.

Tani le të supozojmë se Ibn Sebe ka ekzistuar realisht në këtë botë, atëherë ne shpallim qartë e sheshit se

shi'at e Shi'izmi s'mbajnë asnjë përgjegjësi për mendimet e tij të shprishura e të devijuara. Këtë e kemi theksuar në kapitullin e mëparshëm. Përsa u përket doktrinëve ekzagjeruese, që herë-herë thuhet për shi'at, ato i takojnë vetëm personit të trilluar Ibn Sebes e ndjekësve të tij dhe s'kanë asnjë lidhje, as nga afër e as nga larg me shi'at e me Shi'izmin.

Në lidhje me këtë çështje, El-Alameh Ajetu-ll'illah, shejhu Muham'med Hasen Kàshiful-gitài, thotë: "Përsa i përket Abdullah ibn Sebes, të cilin ia bashkëngjisin shi'ave, ose shi'at i identifikojnë me të, ja ku janë të gjitha librat e shi'ave që shpallin sheshit se shi'at e mallkojnë atë dhe nuk mbajnë asnjë përgjegjësi ndaj thënieve të tij. Fjala më e lehtë që thonë librat e shi'ave, në lidhje me të drejtën e Ibn Sebes, mjaftohen me përshkrimin e gjendjes tij. Në librat e shi'ave, Ibn Sebe përmendet me shkronjën "*ajn*" dhe, sipas këtij kuptimi, sa herë që Abdullah ibn Sebe të përmendet, atëherë më i mallkuar është."⁸³

Çështja, ashtu siç e ka përmendur shejhu Kashiful-Gitai, rezulton se dijetarët e shi'ave e kanë mallkuar Ibn Seben dhe kanë deklaruar se ata s'mbajnë asnjë përgjegjësi ndaj thënieve të tij, nëse ai me të vërtetë ka ekzistuar realisht si person. El-alàme Elhalij, në lidhje me të, thotë:

⁸³ "Asulu-sh'shijati ue usùluhà" – "Origjina e shi'ave dhe bazat e tyre", f. 57, Botuar në Kajro, Egjipt.

“Padyshim, Abdullah ibn Sebe është ekzagjerues i mallkuar, të cilin Prijësi i besimtarëve e ka djegur në zjarr.”

Gjithashtu, për Abdullah ibn Seben kanë thënë: “Me doktrinat që ai përhapte, pretendonte se Aliu është hyjni ose është profet. Allahu e mallkoi atë trillues të devijuar!”⁸⁴

Për më tepër, dijetarët e shi’ave dhe autorët e librave, dijetarë në fushën e hadithit dhe të atyre që kanë shkruar për grupimet, autorë artikujsh e historianë, të gjithë pohojnë se Aliu dhe ndjekësit e tij, janë shtresa më e lartë që i kanë kundërshtuar në kohën e tyre doktrinat ekzagjeruese. Këtë çështje e theksuan kur panë se si e përmendnin Aliun sebiqtë dhe se si Aliu, jo vetëm që u shfaqësua prej ekzagjeruesëve, por i luftoi ata dhe vetë Ibn Seben e dogji në zjarr, ose e internoi.

Këtë çështje e ka nënvizuar edhe prof. Gojardi në librin e tij. Ai i ndan myslimanët në grupe e në medh’hebe. Në librin e tij, prof. Gojardi thotë se shi’at janë ndjekësit, përkrahësit e dashamirët e Aliut e të djemve të tij. Më pas ky autor u ngjiti deri te Abdullah ibn Sebe dhe tha: “Në kohën e Aliut ishte një person, të cilin e thërrisnin

⁸⁴ Husejn Ali Mahfûdh, “Tàrijkhu-sh’shijah” – “Historia e shi’ave”, f. 39-40, Botuar në Bagdad; El-erdebijlij Elgarevij, “Xhàmiu-rr’rruvàt” – “Indeksi i përcjellësve të njoftimeve”, vëll. 1, f. 485, si dhe në libra të tjerë, në të cilat trajtohet Ibn Sebe.

Abdullah ibn Sebe. Ai ishte jehudi. Në fillim të punës së tij pretendoi hyjninë për dhëndrin e Profetit, Ali ibn Ebu Talibn. Por Aliu, djemtë dhe ndjekësit e tij i pastruan shi'at dhe në kohën e tyre i kanë kundërshtuar ashpër doktrinat ekzagjeruese.⁸⁵

Ajo që ne mund të themi me fjalë të shkurtra është, sikur të supozojmë se Abdullah ibn Sebe dhe sebijtë të kenë ekzistuar me të vërtetë, padyshim që janë prej grupeve ekzagjeruese dhe s'kanë asnjë lidhje me shi'at. Gjithashtu, edhe autori i librit "El-Islamu uerr'rrxh'ah"- "Islami dhe renegatizmi", kur përmend numrin e grupeve të ekzagjeresëve prej shi'ave, në krye të tyre ka përmendur sebijtë dhe ka nënvizuar se ata janë burimi i të gjitha grupeve të tjera ekzagjeruese, ata janë ndjekësit e Abdullah ibn Sebes dhe, ashtu siç shkruan ai, ata janë prej banorëve të Humejrit.⁸⁶

Prej atyre që e kanë theksuar akoma më shumë çështjen e ekzagjerimit dhe ekzagjeresit, është Ibn Khalduni, i cili, në parathënien e tij, kur i përshkruan ekzegjeresit, shkruan se ata flisnin për hyjninë e imamëve prej pasardhësve të Imam Aliut. Por Imam Aliu ata i ka

⁸⁵ Prof. Stanislas Gojard, "Sàzemanhàj"- "Qytetërimi i perandorisë islame", f. 38-40, Botuar në Teheran, 1336 Hixhreti.

⁸⁶ Abdul-veh'hàb Ferijd, "El-Islamu uerr'rrxh'ah"- "Islami dhe renegatizmi", f. 63, në gjuhën perse, Botuar në Teheran.

djegur në zjarr. Megjithëkëtë, autori nuk e përmend heroin e tregimit të legjendës Abdullah ibn Seben.

Po ky autor, në kapitullin e librit të tij, që flet për medh'hebet e shi'ave, tekstualisht shkruan: "Prej grupeve të shi'ave, ka prej atyre që quhen ekzagjerues, të cilët e kanë tejkaluar cakun e logjikës e të besimit me fjalën e tyre për hyjninë e imamëve të tyre." Më pas ai shton: "Ata që shkuan deri në këtë mendim, Aliu i ka djegur në zjarr."⁸⁷

Në librat dhe artikujt që trajtojnë grupet, si për shembull librat: "Elferku bejnel-fireki"- "Dallimi mes grupeve", "Elmilelu uen'nehalu"- "Grupet e pretendimeve" dhe libri "El-akdul-ferijd"- "Enigma e rrallë", thuhet se Abdullah ibn Sebe ishte prej ekzagjeruesve dhe se Imam Ali ibn Ebu Talibi, disa prej atyre ekzagjeruesve, i ka djegur në zjarr, kurse disa të tjerë i largoi. Abdullah ibn Sebe ishte prej të internuarve.⁸⁸

⁸⁷ "Parathënia" e Ibn Khaldunit, f. 198.

⁸⁸ "Elferku bejnel-fireki"- "Dallimi mes grupeve", vëll. 1, f.10; "Elmilelu uen'nehalu"- "Grupe dhe pretendime", vëll. 1, f. 174; "El-akdul-ferijd"- "Enigma e rrallë", vëll. 2, f. 240; Gjithashtu lexo: Shejhu Muham' med Xhev'vâd Mugnijeh, "Mea-sh'shi'atil-imàmij'jeh"- "Me shi'at imamij", f. 40, Botuar në Bejrut; Sej'jid Hâshim Maë'rûf, "Akijdetu-sh'shi'atul-imàmij'jeh"- "Doktrina e shi'ave imamij, f. 216, Botuar në Bejrut; Ebû Hasen El-Esh'arij, "Mekâlatul-islamij'jijne"- "Artikuj të islamistëve", f. 85, Botimi i parë në Bejrut; Dr. Hasen Ali Mahfûdh, "Tàrijhku-sh'shi'ah"- "Historia e shi'ave", f. 39, Botuar në Bagdad.

Ajo që duhet të nënvizojmë në këtë pikë, është se dijetarët e shi'ave nuk janë kufizuar vetëm të refuzojnë ekzagjeruesit, t'i mallkojnë e të deklarojnë se ata janë krejtësisht të pafajshëm për ekzagjerimet që kanë bërë ekzagjeruesit, pa bërë dallim nëse Abdullah ibn Sebe ka ekzistuar në mesin e të tjerëve ose jo. Në të gjitha librat e teologjisë e të fik'hut, dijetarët e studiuesit e shi'ave janë shprehur se ekzagjeruesit janë "nexhis"- "të ndyrë" dhe se ata kanë dalë prej fesë.

Ja dhe shejhu Mufijid (vdekur në vitin 413 Hixhreti) që është prej dijetarëve të mëdhenj të shi'ave, në librin e tij të vlefshëm "Tahsijhul-iëtikàdi"- "Korrigjimi i besimit", nëntitullin "Ekzagjerimi", shkruan: "Ekzagjeruesit janë prej atyre që hiqen se janë myslimanë. Ata janë personat që kanë hyjnizuar Prijësin e besimtarëve (Imam Aliun) dhe imamët prej pasardhësve të tij, për të cilët ekzagjeruesit kanë thënë se janë profetë dhe i kanë cilësuar për virtyte e përparësi në punët e fesë e në punët e kësaj bote. Ekzagjeruesit, duke theksuar përparësitë e imamëve, kaluan të gjitha caqet e arsyes dhe kanë dalë prej qëllimit. Ata janë në rrugën e humbjes dhe janë mohues, janë prej atyre që Prijësi i besimtarëve i ka dënuar me vdekje.

Gjithashtu, edhe imamët janë shprehur se ekzagjeruesit janë mohues dhe kanë dalë jashtë Islamit.”⁸⁹

* * *

Dukuria e ekzagjerimeve dhe e kalimit të caqeve të logjikës në fushën e besimeve nuk është e veçantë vetëm për injorantët që i përkasin shi’ave, pasi kjo dukuri ka përfshirë edhe Ehli Synetin, prej të cilëve kanë dalë jo pak ekzagjerime, madje edhe prej burrave të tyre të mëdhenj, kur injorantët ftojnë njëri-tjetrin që këto ekzagjerime t’ia atribuojnë shi’ave.

Në këtë rrugëtim, dijetari i madh El-Emijnij ka cituar në enciklopedinë e tij historike “Elgadijr” njëqind tregime prej tregimeve të ekzagjeruara, të ardhura prej Ehli Synetit. Ato janë tregime të tjerrura rreth personave të tillë,

⁸⁹ Komenti i librit “Akàidu-s’sadùk, eu tashijhul-iëtikàdi” - “Doktrinat e Sadukut”, ose “Korrigjimi i besimit”, f. 63, Botuar në Tabriz, 1317 Hixhreti. Në lidhje me shpalljen mohues e renegatë të ekzagjeruesve, mund të lexoni librat: “Misbàhul-fekijh” - “Fanari i fekijhut”, Pjesa “Pastrimi”, autori Fekijhu Elhemedànij, f. 568; “Elurvetul-vuthkà” - “Veriga e pashkëputshme”, autori Es’sej’jid Eljezedij, f. 19, Botuar në Kom; “Mustemsikul-urveti” - “I kapuri pas verigës”, autori Muhsin Elhakem, vëll. 1, f. 325, Botuar në Nexhef; Gjithashtu, lexo të gjitha librat e fik’hut të shi’ave, që mund të merren në konsideratë dhe në mënyrë të veçantë lexo librin “Fij Bahthi-n’nexhàsàt” - “Studim mbi papastërtitë”.

si Muavija⁹⁰ dhe, duhet nënvizuar se dijetari El-Emijnij, për citimin e këtyre tregimeve, është bazuar në libra e në burime që merren në konsideratë, prej botimeve të vëllezërve tanë të Ehli Synetit.

Për cilindo që lexon thëniet e këtyre tregimeve bëhet e qartë se çështja e ekzagjerimeve nuk ka të bëjë vetëm me ato që u vihen shi'ave, pasi ekzagjerime gjenden edhe në medh'hebet e tjera islame. Por, nisur nga dëshira për të folur sa më shkurt, ne kemi bërë kujdes të mos futemi në imtësi për çështje që ka kundërshtime dhe që nuk sjellin asnjë dobi nëse ato botohen, në mënyrë të veçantë për ne që kemi marrë përsipër të punojmë për unitetin e për afrimin e medh'hebeve islame.

⁹⁰ "Elgadijr", vëll. 11, f. 103-192, Botuar në Bejrut.

MBYLLJE

Padyshim që deliktet më frikësuese dhe që sjellin më shumë mëri është lejimi për të futur rrenën e shpifjen në historinë islame dhe lëshimin e akuzave pa u menduar, por thjesht në vazhden e tjerres së fantazisë e të trillimeve, duke u bazuar te mitet. Pastaj këto gënjeshtra, shpifje e akuza paraqiten në faqet e historisë si të vërteta. Padyshim që kjo është bërë për qëllime të kësaj bote dhe për interesa personale, në një kohë që për bijtë e së njëjtës fe nuk sjellin gjë tjetër veçse kundërshtime. Janë këto kundërshtime që i kanë çuar në rrugë të gabuar brezat njëri pas tjetrit, kanë futur bijtë e këtij ymeti në ndeshje e në konflikte të atilla që kanë konsumuar kapacitetet, burimet e pasuritë e ymetit islam. Është e qartë se të gjitha këto bëhen prej grabitësve lakmitarë, kolonialistëve e sundimtarëve shtypës, të cilët i lanë trashëgim ymetit poshtërimin, përluljen e prapambetjen.

Nisur nga ky realitet, disa bij të këtij ymeti të lavdëruar kanë meritën që të mbajnë barrën e brengave të këtij ymeti dhe janë vënë në pararojë për një të nesërme të ndritshme. Ata kanë marrë nismën për të ndrequr të çarën,

për të mbledhur fuqitë dhe për t'u ngritur mbi të gjitha kundërshtimet e dukshme dhe të padukshme, që janë të pranishme në të gjithë popujt.

Gjithashtu, ata bëjnë shumë mirë kur qëndrojnë larg çdo gjëje që shkakton zhurmë e armiqësi, vënë në qendër të studimeve të tyre ato që kanë të përbashkët dhe shqetësimet e mëdha. Ata bëjnë thirrje të stolisemi me objektivitetin ndaj shprehjeve për të cilat ka kundërshtime dhe të përpiqemi për t'i trajtuar të gjitha këto në kuadrin e studimit të mirëfilltë shkencor, me qëllim që me këto lloj shprehjesh, sharjesh, cenesh e të metash të mos etiketohet ky grup apo një grup tjetër.

Unë dëshiroj që jo vetëm këto fjalë dhe shprehje të dalin jashtë kuadrit studimor, por edhe çështja e Abdullah ibn Sebes dhe e sebijve, që iu ngjiten shi'ave dhe Shi'izmit, ashtu siç e pamë qartë nëpërmjet studimeve të shtruara në këtë libër. Në këtë libër, nëpërmjet mendimeve të dijetarëve të ymetit islam vërtetua se personi, Abdullah ibn Sebe, nuk mund të mbante punët që i atribuohen, si roli i pretenduar që ai gjoja ka luajtur. Janë të shumë dijetarët e studiuesit e mëparshëm të shi'ave, të cilët Abdullah ibn Seben e kanë konsideruar të shkarë në rrugën e humbjes, të devijuar prej rrugës së drejtë dhe ekzagjerues. Me rrugët e Ehli Bejtit kanë ardhur transmetime që njoftojnë se ai është i mallkuar dhe se ndaj


atij personi shi'at nuk mbajnë asnjë përgjegjësi. Kurse një pjesë tjetër prej dijetarëve e studiuesve shi'a, me studimet e tyre, kanë vërtetuar se ai është thjesht person mitik, i trilluar dhe një legjendë e stisur. Në këto studime ata nuk janë vetëm, pasi me mendimin e tyre është bashkuar edhe një numër i madh dijetarësh e studiuesish prej vëllezërve të tyre të Ehli Syneetit.

Edhe nëse supozojmë se ka ekzistuar Abdullah ibn Sebe, ai s'ka as lidhjen më të vogël me shi'at, as nga afër e as nga larg. Pas këtij deklarami të hapur për studiuesin e paanshëm, Allahu i Lartësuar i ka hapur të gjitha dritaret e vëzhgimit e i ka hedhur fuqinë e dëgjimit. Ky studiues e shejsh mirë këtë fakt, prandaj për një studiues të tillë s'ka arsye që ai të besojë e të vërtetojë ato që thuhet për këtë gënjeshtër historike dhe ta bëjë atë shkak për ndarje e lëndë të parapërgatitur për të lëshuar fyerje të ndërsjella, për të shkaktuar grindje dhe për t'i bërë ato një treg ku lëshohen akuza, me qëllim që myslimanët të merren me to.

Nisur nga sa u tha, thirrja e sinqertë, drejtuar atyre që u pulson ndërgjegjia dhe të gjithë mendjendriturve është të heqin dorë prej mendimit sipas mendësisë së kohës së kaluar, të ruhen e të bëjnë kujdes prej gjërave që thonë të tjerët, të punojnë për afrim, për vëllazërim e për unitet ndërmjet radhëve të këtij ymeti dhe të bashkojnë fuqitë në të gjitha drejtimet për të përballuar rreziqet që i

rrinë mbi kokë botës tonë islame, pasi vetëm kështu nuk e lenë rastin në dorën e armiqve të këtij ymeti.

Në vijim do të shpalosim tri kumtesa, të cilat i kemi renditur si shtesë të këtij libri. Ne mendojmë se këto kumtesa jo vetëm meritojnë të lexohen, por edhe të studiohen.



SUPLEMENTET E LIBRIT

*** SEBIJTË**

*** NJË HAP NË RRUGËN**

*** JO, O VËLLEZËRIT TONË NË FE**

SUPLEMENTI I PARË

SEBIJTË

Shkruar prej prof. Husejn El-Emijnit⁹¹

Sebijtë, para stisjes së tregimit për Abdullah ibn Seben, quheshin pjesëtarët e tribuve të Jemenit, që ishin prej pasardhësve të Sebe ibn Jeshxhebit.

Në Kur'anin Famëlartë, fjala “sebe” është përmendur në fjalën e të Lartit:

وَجِئْتُكَ مِنْ سَبَإٍ بِنَبَإٍ يَقِينٍ

⁹¹ Ai është dijetari i shquar Es'sej'jid Muhsin El-Emijn El-amilij, autor i enciklopedisë “Aëjànu-shij'ah”, botuar në dhjetëra vëllime; kurse prof. Hasen El-Emijn është autor i librit “Dàiretul-meàriful-islamij'jeti-sh'shij'ij'jeti”, enciklopedi shkencore historike, e botuar në disa vëllime, botuar në Bejrut dhe është përkthyer në anglisht. Ky autor ka shkruar edhe vepra të tjera për historinë e dijetarëve shi'a, si dhe libra të tjerë. Këtë artikull profesori na e dërgoi që ta botonim në këtë libër. Gjejmë rastin ta falënderojmë për këtë. Po e botojmë në këtë libër si suplement.

“...ue xhiëtuke min sebein ibnebein jekijnin” “... dhe të erdha prej Sebeit me një lajm të sigurt”⁹², si dhe në fjalën tjetër të Allahut:

لَقَدْ كَانَ لِسَبَإٍ فِي مَسْكِنِهِمْ آيَةٌ جَنَّتَانِ

“Lekad kàne lisebein fij meskenihim àjetun xhen’netàni...”
 “Sebei në banimin e vet kishte një argument, kishte dy kopshte...”⁹³

Me mbiemrin “sebij” është emërtuar një numër i madh përcjellësish të hadithit, në të gjashtë librat “Sahijh” të haditheve. Es’sem’ànij dhe Ibn Makula kanë numëruar një numër përcjellësish të njohur me mbiemrin “Sebij”, për shkak se janë prej pasardhësve të Sebe ibn Jeshxhebit dhe prej tyre janë: Abdullah ibn Hemijreh Es’sab’ij dhe Ebu Rushd ibn Hanesh Es’sab’ij. Prej këtyre dy përcjellësve ka transmetuar Muslimi në “Sahijhun” e tij, gjithashtu po prej këtyre të dyve kanë transmetuar në “Sunenet” e tyre: Nesàij’ji, Trimijdhij’ji, Ibni Màxheh dhe Ebù Dàùdi.

Gjithashtu, prej përcjellësve të hadithit, me mbiemrin “Sebij” janë: Ez’her ibn Abdullah Es’sab’ij, vdekur në vitin 250 të Hixhretit; Esed ibn Abdurr’rrahman Es’sab’ij El-Andulusij, i cili ishte gjallë pas vitit 150 të

⁹² Sure “En’Neml”, ajeti 22.

⁹³ Sure “Sebe”, ajeti 15.

Hixhretit; Sulejman ibn Bekar Es'seb'ij dhe Xhibil'leh ibn Zuhejr Es'seb'ij.

Siç thamë, emrat e mësipërm i përmendëm vetëm si shembull, pasi përveç këtyre që ka përmendur Sem'anij dhe Makula, janë edhe shumë emra përcjellësish hadithesh të tjerë, që janë përmendur në libra të tjerë me mbiemrin "Sebij" për shkak se e kanë prejardhjen prej Sebe ibn Jeshxhebit.

Burra me mbiemrin "Sebij" gjendeshin në Egjipt, të tjerë gjendeshin në Anduluzi, në Jemen, në treva të tjera dhe kështu ka vazhduar deri në mesin e shekullit të tretë të Hixhretit.

Nisur nga ky fakt, mësojmë se askujt nuk i shkonte ndërmend që, kur përmendej mbiemri "Sebj" qëllimi ishte për ndonjë emër tjetër, përveç përkatësisë se ishin me origjinë prej Jemenit. Kjo fjalë nuk kishte asnjë kuptim tjetër përveç këtij kuptimi.

Në këtë kuptim, me mbiemrin "Sebij" është quajtur grupi i tribuve katanase të Jemenit, që u grumbulluan rreth Ali ibn Ebu Talibit në betejat e tij të mëdha dhe që përbënin masën e përkrahësve të tij, të udhëhequr prej kryetarëve të vet, si: Am'mar ibn Jaseri, Malik Eshteri, Hixhr ibn Adij, Kajs ibn Saëd ibn Ubadeh, Khuzajmeh ibn Thabit, Sehl ibn Haniif, Abdullah ibn Adijl, Adij ibn Hâtem, Amr ibn

Elhamk, Sulejman ibn Sard e të tjerë përveç këtyre që u përmendën.

Të gjithë thirreshin me mbiemrin “Sebij”, për shkak të prejardhjes. Por puna mori një zhvillim tjetër në kohën e Zijad ibn Ebijhut, i cili mbiemrin “Sebij”, që tregonte origjinën e prejardhjes së atyre burrave, e mori si mjet thumbues. Në të vërtetë, mbiemri “Sebij” ata i nderonte, por me sa duket Zijadi zgjodhi t’i thumbojë ata me këtë mbiemër, me qëllim që t’u kujtonte atyre origjinën e tyre të largët të kohës së injorancës para Islamit.

Dihet se përveç tribuve jemenase, me Ali ibn Ebu Talibin u bashkua edhe tribuja Rebij’ah, të cilët ishin të përkushtuar ndaj Aliut, gjithashtu mes kësaj tribuje dhe tribuve jemenase katanase, u lidh një marrëveshje, si vijon:

“Rreth tij u mbledhën banorët e Jemenit dhe të “Rebij’ah”, të qytetit e nomadët”. Që me këtë marrëveshje, mbiemri “Sebij” u përdor edhe për ata të tribusë Rebij’ah, për shkak se ishin aleatë të jemenasve. Në të vërtetë, me mbiemrin “Sebij” ata emërtuan përkrahësit e Aliut dhe ata që mbështesnin vilajetin e tij, domethënë se vetëm Aliu duhej të ishte i parë. Më sipër u shpjegua se fjala “sebij” nuk kishte kuptim tjetër përveç kuptimit që tregonte se ata që mbanin këtë mbiemër ishin pasardhës të Sebejit. Kështu vazhdoi derisa Zijad ibn Ebijh përgatiti shkaqet për të masakruar Hixhr ibn Adijin me shokët e tij heronj, të cilët,

më pas, i dërgoi te Muavija. Ai i vrau dhe nuk i etiketoi me asgjë përveçse me fjalën e tij: “Këta janë djajtë sebij, pasues të Ali ibn Ebu Tàlibit!” Dhe më pas shtonte: “Ata shpallën hapur se hilafeti i takon familjes së Ali ibn Ebu Talibit, justifikonin Aliun dhe ishin të mëshirshëm ndaj tij.”

Sipas këtij etiketimi, krimi për të cilin u masakruan “sebijtë” ishte pretendimi i tyre se hilafeti i takonte familjes së Ali ibn Ebu Talibit dhe për shkak të mëshirës që tregonin ata ndaj Aliut dhe asgjë më shumë se kaq.

Fjala “sebij” filloi të lakohej përsëri në fillimet e shekullit të dytë të Hixhretit për të njëjtët faktorë e për të njëjtat shkaqe dhe, kur kjo fjalë thuhej, s’kishte asnjë qëllim tjetër veçse përkrahësit e Aliut dhe djemve të Aliut.

Dhe, kur Ebu Selemeh u përpoq të merrte hilafetin prej abasive dhe ta vinte atë në dorën e talibinëve (pasardhësve të Aliut), para besëdhënies për Sef’fahun, i cili, pasi mori besëdhënien, në fjalimin e rastit, ndër të tjera, tha: “Sebijtë pretendojnë rrugën e gabuar, kur thonë se të tjerët dhe jo ne kanë më shumë të drejtë të jenë krerë dhe për hilafetin.”

Siç shihet, ab’bàsiu Sef’fah s’pati mundësi të thotë gjë tjetër kundër tyre përveç fjalës “sebij” dhe se “sebijtë” mendojnë se të tjerë përveç abasive kanë më shumë të drejtë për hilafetin. Kuptohet se kjo shprehje ishte një

çoroditje nga ana e Seff'fahut, i cili, ashtu si Zijad ibn Ebijhu, kishte dëshirë që edhe një faj tjetër të hidhej mbi “sebijtë”, ose të gjente te ata ndonjë devijim prej Islamit dhe bazave të tij, që pastaj t'i zbulonte e t'i denonconte ato.

Kështu ishte kuptimi i fjalës “sebij” deri në fillimet e shekullit të dytë të Hixhretit, derisa në mesin e atij shekulli lindi një burrë, Sejf ibn Amr Et'Temijmij dhe fjala “sebij”, në gjuhën e tij, merr një kuptimi të ri. Me këtë mbiemër Sejfi emërtoi burrin e stisur, Abdullah ibn Seben dhe jo vetëm kaq, por më pas trilluesi Sejf kaloi deri në akuza kundër doktrinës islame.

Atëherë, kush është Abdullah ibn Sebe dhe kush janë “sebijtë”?

Si është thirrja e tij?

Si janë punët e këtij personi të trilluar, sipas asaj që tregon Sejf ibn Omer Et'Temijmij?

Përmbledhja e gjithë asaj që ata pretendojnë është: Ai ishte jehudi prej San'as, që u hoq se pranoi Islamin në kohën e Uthmanit, u infiltrua në mesin e myslimanëve dhe filloi të lëvizë nëpër trevat myslimane: Sham, Kufeh, Basra dhe Egjipt, duke përhapur përgëzimin se për Profetin Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka kthim, ashtu siç ka kthim për Isanë, të

birin e Merjemit dhe se Aliu është i porosituri i fundit, ashtu siç është Muhamedi (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) vula e profetëve. Përveç trillimeve të tjera, Sejfi thoshte se Uthmani është rrëmbyes, prandaj është detyrë që ai të kundërshtohet dhe e drejta e rrëmbyer t'i kthehet atij që i takon.

Heroin e tregimit ata e emërtuan Abdullah ibn Sebe dhe pastaj e thirrën me epitelin “Ibn Seuda”. Gjithashtu, ata thonë se Abdullah ibn Sebe i shpërndau thirrësit e tij nëpër vendet islame, duke u theksuar atyre që të hiqeshin se urdhërojnë punën e mirë e ndalojnë punën e keqe dhe i urdhëroi të atakonin sundimtarët. Përveç kësaj, ata shtojnë se në këtë thirrje të Abdullah ibn Sebes e ndoqën grupe myslimanësh, ndër të cilët kishte sahabë, tabi’inë (brezi i dytë i myslimanëve) dhe njerëz të mirë.

Ata pretendojnë se “sebijtë”, në zbatim të planit të liderit të tyre, Abdullah ibn Sebe, kudo që ndodheshin, filluan të nxisin njerëzit kundër qeveritarëve të tyre, filluan të shkruajnë letra rreth të metave të qeveritarëve dhe ato letra i dërgonin në vende të ndryshme. E gjitha kjo rezultoi në formimin e grupeve të myslimanëve, të cilët, nën nxitjen e “sebijve”, u sulën në drejtim të Medines dhe mbajtën të rrethuar Uthmanin në shtëpinë e tij, derisa më në fund e vranë brenda në shtëpi. E gjitha kjo u bë e mundur në sajë të udhëheqjes së drejtpërdrejtë të sebijve.

Ata pretendojnë se myslimanët, pasi i dhanë besën Aliut dhe, pasi Talhai e Zubejri shkuan në Basra, për Betejën e Xhemelit (Devesë), sebijtë menduan se krerët e të dyja ushtrive filluan të mirëkuptohen njëri me tjetrin dhe, se, kur ky mirëkuptim të bëhej realitet, ata do të kërkonin gjakun e Uthmanit. Në këtë gjendje sebijtë u mbloodhën natën dhe vendosën të futen mes dy ushtrive dhe herët në mëngjes të ndiznin luftën pa e marrë vesh asnjë këtë kurth të tyre. Ata thonë se sebijtë mundën që të vënë në jetë këtë plan të rrezikshëm në errësirën e natës, para se kjo gjë të tërhiqte vëmendjen e të dyja ushtrive, ndërkaq sebijtë ishin futur mes dy ushtrive që ishin në gatishmëri përballë njëra-tjetrës. Ata thonë se disa prej sebijve kishin depërtuar në mesin e ushtrisë së Basras dhe disa të tjerë ishin futur në ushtrinë e Aliut. Në këtë gjendje, të dyja ushtritë e rreshtuara përballë njëra-tjetrës u tronditën. Secili mendonte për kundërshtarin e tij. Gjithashtu, ata pretendojnë se pikërisht kështu ka filluar Beteja e Basras, që më shumë njihet me emrin Beteja e Xhemelit, pa marrë vesh e pa ditur asgjë krerët e të dyja ushtrive.

Deri këtu e përfundon ky rrëfenjës tregimin për sebijtë. Pas kësaj nuk thotë asgjë si që përfundimi i tyre.

Atëherë si është e vërteta e Abdullah ibn Sebes dhe a ka ekzistuar ai me të vërtetë?

A ka pasur mundësi të ndikojë ky jehudi dhe si e sa ishte ndikimi i tij në ato punë?

Realiteti historik është shumë larg asaj që disa u besojnë fjalëve që thuhet për çështjen e Abdullah ibn Sebes. Ata që e stisën tregimin e Abdullah ibn Sebes thanë se ai është jehudi. Pastaj, krahas kësaj, ata stisën edhe thirrjen e tij, pastaj stisën edhe një grup që besonte në këtë thirrje. Pjesëtarët e këtij grupi i quajtën sebij.

Për ju lexues të nderuar është e mjaftueshme të kuptoni se autori e planifikuesi i legjendës Abdullah ibn Sebe është Sejfi ibn Omer Et’Temijmij, për të cilin transmetuesit e hadithit dhe dijetarët që kanë shkruar jetëshkrimin e përcjellësve, ndajnë një fjalë të përbashkët, të gjithë thonë se Sejfi ishte gënjeshtar.

Përcjellësit e hadithit dhe dijetarët që kanë shkruar jetëshkrimin e këtyre përcjellësve, janë shumë konsekuentë për vërtetësinë e njoftimeve të përcjella dhe, në këtë kuadër, ata shpjeguan qartë se cili është Sejfi ibn Omeri dhe kanë argumentuar se njoftimi i përcjellë prej tij është shpifje në ligjin e fesë. Prandaj të gjithë dijetarët kanë bërë thirrje që njoftimet e përcjella prej tij të mos merren parasysh. Por këtë mendim e kundërshtojnë historianët, të cilët, për përcjellësit e njoftimeve historike, thonë se tregimet historike, të përcjella prej tyre nuk janë burim për ligjin e fesë e nuk e prekin fenë. Me këto fjalë historianët

janë shprehur për lejimin e marrjes së tregimeve me natyrë historike. Pikërisht kështu e ka konsideruar të lejuar edhe historiani Taberij, kur ka cituar prej këtij gënjeshtari të quajtur Sejf ibn Omer.

Të gjithë autorët që kanë përmendur Abdullah ibn Seben, burimi i vetëm për ata ka qenë Taberiji, i cili, në tregimin për Abdullah ibn Seben është mbështetur vetëm në njoftimin e përcjellë prej Sejf ibn Omerit. Nuk është vetëm ky tregim që Taberiji transmeton sipas përcjelljes së Sejf ibn Omerit. Në të vërtetë, në “Historinë” e Taberijit gjenden edhe shumë ngjarje e tregime të tjera historike, që s’kanë përcjellës tjetër përveç Sejf ibn Omerit.

Që të njohim masën sa është përzier Taberiji me njoftimet e përcjella prej Sejfit dhe masën e çoroditjes së brezave me këtë argument të stisur prej Sejfit, detyra jonë mbetet që të dëgjojmë opinionin e autorëve të librave të hadithit dhe të dijetarëve që kanë shkruar jetëshkrimet e përcjellësve të njoftimeve.

Shumë autorë të njohur, që kanë shkruar për Sejfin, e kanë cilësuar atë të gradës “*daijf*” – “*dobët*” dhe si përcjellës njoftimesh kanë thënë: Ai nuk vlen për asgjë, është i lënë, ka vënë hadithe. Hadithet e tregimet e përcjella prej tij nuk janë të besueshme, pasi ai i stiste nga vetja e tij, megjithëse pretendonte se i ka marrë prej përcjellësve të besueshëm. Por dijetarët e hadithit thonë se

përcjellësit për të cilët flet Sejfi, janë të panjohur dhe vetë Sejfi akuzohet si vënës hadithesh dhe për ateizëm.

Por, që të theksohet vërtetësia e asaj që u tha më sipër, ju lexues keni mundësi të lexoni librat e jetëshkrimit të përcjellësve të hadithit prej autorëve të Ehli Syneetit, të cilët kanë shkruar për Sejfin.⁹⁴ Në shkrimet e tyre ata kanë cituar prej një grupi dijetarësh autorë librash të hadithit, si Ibn Muijnin, Ebu Hatemin, Ebu Daudin, En'nesaijin, Ed'derakatani'jin, Ibn Adijin, Ibn Hib'banni, Ab'bas ibn Jahjan e të tjerë.

Në librat “El-Isàbetu” dhe “El-Istij'ab”, në memorien e shkruar prej Elkaëkàë ibn Omerit, lexojmë: “Përsa u përket njoftimeve të përcjella prej Sejfi ibn Omerit, prej Amr ibn Temamit, prej babait së tij, prej tij, thuhet qartë se Sejfi, si përcjellës hadithi është i lënë, por ne e kemi përmendur atë vetëm sa për të pasur njohuri.”

⁹⁴ Edh'dhehebij, “Mijzànul-iëtidâl”, vëll. 2, f. 200; Ibn Haxher, “Tehdhijbu-t'tehdhijb”, vëll. 3, f. 583; Ibn Nedijmi, “Elfihreset”, f. 106; varianti i dytë prej artikullit të dytë e libra të tjerë të shkruara për Abdullah ibn Seben, siç janë librat: “Ed'duafàul-kebijr” i El-ukajlijit, vëll. 2, f. 175; Ibn Hib'bàn, “El-mexhruhijne”, vëll. 1, f. 34; Ebù Nejm El-Isbehànij, “Ed'duafàu”, f. 91; Ibn Adij, “Et'te'em'mulu fij duafair-r'rixhàl”, vëll. 3, f. 435.

Në librin “El-Isàbetu”, në një vend tjetër të këtij libri, ai ka thënë: “Sejf ibn Omeri është i gradës “daijf” – “dobët”.⁹⁵

Kurse Xhelàlu-d’dijn Es’seljùtij, në librin e tij “El’leàlij elmasnùatu fil-ehàdijthil-meudùati” – “Perla të rreme në hadithet e vëna”, ka transmetuar prej Sejfit vetëm një hadith. Menjëherë për atë hadith ka thënë: “I vënë. Në të ka përcjellës të gradës “daijf” – “dobët” dhe më i dobëti prej tyre është Sejfi.”⁹⁶

Këtë përcjellës njoftimesh e tregimesh, Sejf ibn Ymerin, dijetarë, autorë jetëshkrimesh të përcjellësve të hadithit dhe autorë të librave të hadithit, e kanë përshkruar me mangësi të papranueshme për një përcjellësh hadithesh. Të gjithë kanë thënë se Sejf ibn Omeri është ai që ka përcjellë tregimin e stisur Abdullah ibn Sebe. Veç kësaj, në këtë tregim, Sejfi ka stisur legjenda aq sa ka dashur.

Në të vërtetë, dijetarët, autorë të librave të hadithit dhe autorët e jetëshkrimeve të përcjellësve të hadithit e kuptonin shumë mirë të vërtetën e Sejfit. Me shkrimet e tyre ata e kanë bërë të qartë se kush është Sejfi. Ata e kanë

⁹⁵ “El-Isàbetu fii temjizi-s’sahàbeti”, vëll. 5, f. 343; “El-istij’ab”, vëll. 3, f. 1284.

⁹⁶ “El’leàlij Elmasnùatu”, vëll. 1, f. 157, f. 199 dhe f. 429.

cilësuar atë si vënës gënjeshtresh dhe kanë bërë thirrje për të mos marrë asgjë prej tregimeve të stisura prej tij.

Por, pavarësisht se autorët e librave të hadithit dhe autorët e jetëshkrimeve të përcjellësve të hadithit, i kanë paralajmëruar njerëzit që të mos marrin asgjë prej Sejfit, përsëri historianët ranë pre e stisjeve të Sejfit, ose thënë ndryshe, ra pre e stisjeve të Sejfit vetëm Taberiji dhe më pas, prej Taberijit morën të tjerët. Kështu janë përhapur legjendat e stisura prej Sejfit.⁹⁷

Realisht Sejfi ishte prej burrave më të rrezikshëm. Ai dinte si t' u shkonte njerëzve nga prapa e nga përpara, që t' i mashtronte me mendimet e tij, ashtu siç dëshironte. Për këtë ai thurte, në mënyrën më të kamufluar, intrigat më të frikshme.

Por, çfarë donte Sejfi ibn Omeri? Përse ai e futi veten dhe njerëzit në punë me kaq shumë legjenda, ndër të cilat edhe legjendën Abdullah ibn Sebe?

Sejfi, në thellësi të tij, kishte urrejtje të madhe ndaj dy gjërave: ndaj Islamit dhe ndaj tribuve jemenase, të quajtura kahtanë.

⁹⁷ Tàrijkhu-t'taberij'ji", vëll. 3, f. 378.

Shqetësimi i vetëm për Sejfin ishte deformimi i Islamit dhe poshtërimi i tribuve kahtane të Jemenit, që u bashkuan me Imamin Ali ibn Ebu Talibin.

Qëllimi i Sejfit, me stisjet e tij, ishte që ta paraqiste Islamin me fytyrë gjakatare dhe udhëheqësit islamë t'i paraqiste mendjelehtë e gjakderdhës, si njerëz që nuk i kushtonin rëndësi jetës së njeriut, si njerëz që nuk merakoseshin se do të derdhej gjaku i dhjetëra mijërave burrave vetëm me një urdhër që mund të nxirrte njëri prej komandantëve të myslimanëve. Gjithashtu, Sejfi kishte qëllim që Islamin ta cilësonte si një fe mitike, që ithtarët e kësaj feje besonin në mite dhe adhuronin mitet.

Më pas Sejfi i vuri vetes qëllim të deformonte besimin e armiqve të tij, të tribuve kahtane, të falsifikonte orientimet me të cilat ata ishin të kënaqur e me qëndrimet që ata mbanin. Për të realizuar këto qëllime, ai stisi tregimin Abdullah ibn Sebe.

Rruga që ai ndoqi për të arritur qëllimin e tij madhor ishte:

Sejfi stiste ngjarje tragjike, të shoqëruara me fjali të bukura mashtruese, thurte fjalë lavdëruese për komandantët. Të gjitha këto i thoshte njëherësh, pa u ndaluar. Me kalimin e kohës, fjalët e bukura, të thëna prej Sejfit, zunë vend në mendjet e përcjellësve të njoftimeve, të

cilët qenë krejtësisht të shkujdesur për të kuptuar në ato tregime qëllimet që Sejfi kishte kundër myslimanëve e kundër Islamit, por i morën fjalët e Sejfit si tregime të bukura.

Në vijim citojmë si shembull vetëm njërin prej tregimeve të shumta të ardhura prej Sejfit, kur ai përshkruan komandantin e shquar mysliman Halid ibn Veljedin, në njërin prej betejave që ai zhvilloi në Irak.

Sejfi tregon: “Halidi tha: ‘O Zoti im, për madhërinë Tënde, nëse na mundëson të hipim mbi qafat e atyre, unë nuk do të lë asnjërin prej tyre të kalojë para nesh, derisa të bëj që lumi të rrjedhë me gjakun e tyre!’”

Më pas Allahu i ndihmoi ata. Ndërkaq njëri prej korrierëve të Halidit thirri: “Kujdes robërit! Robërit, mos i vrisni, me përjashtim të atij që kundërshton të dorëzohet!” Kalorësit i shtynin robërit në grupe, pasi më parë kishin ngarkuar burra që t’u prisnin atyre kokat në breg të lumit. Puna për prerjen e kokave të robërve të luftës vazhdoi një ditë e një natë, vazhdoi të nesërmen dhe të pasnesërmen.”

Sipas tregimit të Sejfit, masakra vazhdoi që në lumë të rridhte gjaku i robërve. E gjithë kjo masakër bëhej me qëllim që të plotësohej betimi i Halidit. Natyrisht që gjaku i dhjetëra mijë njerëzve nuk mund të bëhej lumë që Halidi të

çlirohej prej betimit që kishte bërë. Prandaj, ashtu siç e tregon Sejfi, Elkaëkaë e të tjerë i thanë:

“Sikur të vrasësh të gjithë njerëzit që janë në tokë, gjaku i tyre nuk rrjedh si lumë, sepse gjaku pas vrasjes që bëri djali i Ademit, Habili, u ndalua të rrjedhë. Prandaj gjaku rrjedh vetëm aq sa të ftohet dhe, që të çlirohesh prej betimit, hidh ujë mbi gjakun. Më parë lumi ishte devijuar dhe, pasi e kthyen ujin, lumi rrodhi gjak të pastër. Për shkak të asaj ngjarjeje, ai lumë vazhdon të quhet Lumi i gjakut edhe në ditët e sotme. Thuhet se numri i të vrarëve në Elijs⁹⁸ ato ditë ishte shtatëdhjetë mijë vetë.”

Ky ishte vetën njëri prej tregimeve të Sejf ibn Omerit, i cituar prej Taberijit, përfshirë edhe tregimin Abdullah ibn Sebe, të trilluar prej tij dhe që më pas, këtë tregim e kanë marrë prej Taberijit, Ibn Ethijri dhe Ibn Halduni.

Pas këtij tregimi për Halidin, Sejfi shton edhe një tregim tjetër për të. Në këtë tregim të dytë ai thotë: “Pasi Halidi korri fitore mbi qytetin Emgashija, urdhëroi të shkatërrohej qyteti dhe çdo gjë rreth tij.

E habitshme, përpara këtyre tmerreve monsturose, krimet e Xhengiz Hanit e të Hulakut duken gjëra pa

⁹⁸ Emër vendi.

rëndësi, por ja që i ka pranuar Taberiji, i kanë pranuar edhe të tjerët që morën prej tij, madje deri në ditët e sotme, i pranuan dhe vazhdojnë t'i pranojnë, sepse Sejfi ibn Omeri diti si të gudulisë ndjenjat e tyre dhe të shtojë fjalë lavdëruese në adresë të Halid ibn Veljdit, pasi më parë ai i kishte zbukuruar shpifjet e tij me fjalët që kishte përhapur për cilësitë dhe virtytet e larta të sahabëve.

Gjithashtu Sejfi, me tregimet e tij, ka vënë në gojën e Ebu Bekrit, sikur ai, sipas pretendimit të atyre që i kanë përmendur tregimet e Sejfit, pas masakrës që u bë në Elijs, ku u masakruan shtatëdhjetë mijë burra dhe pas shkatërrimit të qytetit Emgashija, ka thënë: “O kurejshë, luani juaj është mbi luanin, ai e munda atë në sofrën e vet. A nuk paskan mundësi gratë të lindin djem si Halidi?!”

Me këto fjalë, sipas tregimit të Sejfi ibn Omer Et'Temijmijit, Ebu Bekri, i singerti, bëhet pjesëmarrës në masakrën që u bë në Elijs dhe në shembjen e qytetit të banuar Emgashija.

Ky ishte vetëm një shembull prej orvatjeve të Sejfit, për t'i veshur Islamit rrobën e përgjakshme tmerruese dhe t'u thotë myslimanëve se ata, me të vërtetë, sjellin shkatërrim e vdekje kudo që shkojnë.

Përsa i përket përpjekjes së Sejfit, për të paraqitur Islamin si fe mitike, po sjellim një model, ashtu si e tregon Taberiji:

“Gjatë luftërave çlirimtare, komandanti Ebu Sebreh zbriti në qytetin Sus, të cilin e rrethuan myslimanët. Sejfi thotë: “Murgjit e priftërinjtë që i vëzhgonin rrethuesit thanë: “O arabë, prej dijetarëve tanë kemi një garanci që thotë se qytetin tonë do ta pushtojë vetëm një mashtrues, ose ndër ta është një mashtrues. Nëse në mesin tuaj është mashtruesi, ju shumë shpejt do të na pushtoni, por, nëse në mesin tuaj nuk gjendet ai, mos e lodhni veten kot duke na mbajtur të rrethuar. Ndërkaq një burrë që ishte në mesin e myslimanëve, i quajtur Saf ibn Sajjad, për të cilin dyshohej se ishte mashtruesi, shkoi para portës së qytetit Sus, goditi portën me shkelm dhe tha: “Hapu!” Menjëherë u këputën zinxhirët, u thyen bravat e u hapën portat.

Gjithashtu, Taberiji transmeton, sipas përcjelljes së Sejfit, kur flet për çlirimin e qytetit Hams: “Shkak për çlirimin e qytetit ishte se myslimanët, në fillim thanë “All’llahu Ekber!”-“Allahu është më i madhi!” dhe menjëherë toka e qytetit u lëkund e muret u çanë. Kur myslimanët thanë “All’llahu Ekber” për herë të dytë, u shembën shumë porta e mure, për rrjedhojë ata që ishin brenda në qytet, panë se s’kishin rrugë tjetër veçse të dorëzoheshin.

Gjithashtu, Taberiji, sipas përcjelljes së Sejfit, tregon se El-esved El-anesij, që ka pretenduar se është profet, kishte një shejtan që e frymëzonte dhe e lajmëronte për të panjohurat. Taberiji, për El-esved El-anesijin, ka përmendur punë me të vërtetë të çuditshme, duke thënë se punët e tij ishin të frymëzuara prej shejtanit të tij.

Ky përcjellës, i quajtur Sejfi, që tregon të gjitha këto punë, madje edhe disa herë më shumë se kaq, është personi që ka përcjellë edhe tregimin Abdullah ibn Sebe.

Nëse ai është i vërtetë, vetëm në disa prej tregimeve që u përmendën këtu, është detyra jonë të themi se ai është i vërtetë edhe në tregimin Abdullah ibn Sebe dhe për sebijtë dhe, nëse ai është gënjeshtar, atëherë ai është gënjeshtar në të dyja gjendjet e në të dyja punët, sepse e vërteta nuk ndahet në pjesë.

Hasen El-Emijn

Bejrut

SUPLEMENTI I DYTË

NJË HAP NË RRUGËN E AFRIMIT

Shkruar prej autorit të librit

Janë të shumta dëshmitë e dokumentet që vërtetojnë se prania e përkrahësve të Aliut dhe të Ehli Bejtit është e hershme sa vetë thirrja islame dhe fillimet e veta i ka që me kohën e ngarkimit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me detyrën e mbajtjes së mesazhit. Këtë e vërtetojnë tekstet⁹⁹ e

⁹⁹ Prej këtyre teksteve është hadithi: “Unë po lë ndër ju dy gjëra me peshë të rëndë: Librin e Allahut dhe pasardhësit e mi, Ehli Bejtin. Kijeni frikë Allahun në të drejtën e Ehli Bejtit tim, kijeni frikë Allahun në të drejtën e Ehli Bejtit tim!”; Lexo “Sahijhun” e Muslimit, Librin: “Fedàilu-s’sahàbeti”- “Virtytet e sahabëve”, K. “Fadlu Ali ibn Ebù Tàlib”-“Virtyti i Ali ibn Ebu Tàlibit”;

Hadithi: “Shko o Ali, ty të do vetëm ai që është besimtar dhe të urren vetëm ai që është hipokrit!”, Lexo “Sahijun” e Muslimit, Librin “Fedàilu-s’sahàbeti”-“Virtytet e sahabëve”, K. “Hub’bul-ensâr”- “Dashuria për ensarët”;

ardhura prej fjalës së Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me të cilat janë të tejmbushura librat e “Suneneve” që flasin për virtytin e Imami Aliut dhe të Ehli Bejtit. Këto tekste, nga njëra anë, nënvizojnë një veçanti të rrallë për Imam Aliun dhe për Ehli Bejtin dhe, nga ana tjetër, kanë nxitur që shumë sahabë të jenë mbështetës e përkrahës të Imam Aliut e të Ehli Bejtit, të mblidhen rreth tyre dhe të kërkojnë të freskohen nën hijen e tyre.¹⁰⁰

Hadithi i Xhabir ibn Abdullahut: “Ne i njihim hipokritët në kohën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me dy gjëra: me urrejtjen ndaj Aliut dhe me lënien e namazit të xhumasë.”; Lexo “Musnedin” e Imam Ahmedit.

Ka edhe shumë tekste të ngjashme që mund t’i lexoni në librin e Nesàij’jit, “Khasàisul-imami Alij”- “Veçantitë e Imam Aliut”. Këtë libër e kemi botuar kohët e fundit në Kajro, si dhe libra të tjerë që flasin për Ehli Bejtin.

¹⁰⁰ Prej atyre përmendim si shembull, por që nuk janë vetëm kaq: Ebu Dherr Elgaf’fariji, Selman Elfàrisij, Am’màr ibn Jàser, Mikdàd ibn Amr ibn Thaëlebeh ibn Màlik En’nehrànij Elhadremij, Hudhejfeh ibn Eljemàn, Khuzejmeh ibn Thàbit, Fakiheh ibn Thaëlebeh El-ensàrij, Khab’bàb elkhuzàij, Ebù Seijð Elkhuderij, Ibnu-t’tejhàn Ebul-hejthem ibn Màlik ibn Atijk El-ensàrij El-eusij, Kajs ibn Saëd ibn Ubàdeh, Enes ibn Elharb ibn Nebijh, Ebù Ej’jüb El-ensàrij, Xhàbir ibn Abdullah ibn Amr ibn Kaëb ibn Ganem ibn Eslemeh El-ensàrij, Hàshim ibn Ebù Vek’kàs, Muham’mèd ibn Ebù Bekr ibn Ebù Kuhàfeh, Màlik ibn Elharth En’nekhaj, Màlik ibn Nuvejreh, Beràè ibn Àzib ibn Hàrith ibn Adij ibn Xheshem El-eusij El-ensàrij, Ubej ibn Kaëb ibn Kajs ibn Ubejd El-ensàrij, Ubàdeh ibn Sàmit ibn Kajs ibn Ahrem ibn Fehr ibn

Në mesin e sahabëve të të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) Imam Aliu dallohet për kapacitetin e tij në dituri e në luftën në rrugën e Allahut. Këtë dallim të tij e vërteton fakti se përkrahësit e mbështetësit e Imami Aliut kanë qenë jo vetëm që në kohën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), por edhe pas vdekjes së tij. Më pas, përkrahës e mbështetës të Imami Aliut e të Ehli Bejtit qenë bijtë e sahabëve dhe brezi tjetër i tyre prej tabi'inëve. Të gjithë ishin përkrahës e mbështetës të Imami Aliut e të Ehli Bejtit.

Historia dëshmon se përkrahësit e mbështetësit (shi'at) e Imami Aliut e të Ehli Bejtit, që prej fillimeve të Islamit, kurrë nuk janë shkëputur qoftë edhe për një çast prej shumicës së myslimanëve në punët praktike, shoqërore, në të kundërt kanë shkuar me seriozitetin më të madh e me vendosmëri të plotë në shërbim të Islamit. Ata kanë marrë pjesë në luftërat çliruese, ashtu siç kanë marrë pjesë edhe në kryengritjet kundër regjimeve despotike të kohëve të tyre. Në këtë rrugë ata shpenzuan pasuritë e veta, dhanë edhe jetën e nuk lanë asgjë mangët pa marrë parasysh sakrificat që duhej të bënin.

Thaëlebeh Ekhazrexhij El-ensàrij, Abdullah ibn Gàfil ibn Habijb Elhedhelij, Dhàlim ibn Amr ibn Sufjàn ibn Xhendel, Khàlid ibn Seijð ibn Ebù Àmir ibn Umej'jeh ibn Abdishems, Esed ibn Thaëlebeh El-ensàrij, Suvejd ibn Ijsà ibn Esmàë ibn Vehb dhe shumë e shumë të tjerë.

Në shoqëritë e asaj kohe, kontradikta mes të brendshmes e të jashtmes dhe dyzimit mes mendimit e punës, nuk ishte shfaqur aq shumë dhe në atë formë që është në ditët e sotme dhe ashtu siç e shohim me sytë e ballit në shoqëritë tona të sotme. Por krahas kësaj, është edhe padituria e disave, prej atyre që preferojnë të sakrifikojnë për llogari të interesave personale, kurse ata që ndjekin imamët me sinqeritet, nuk e shikojnë përkrahjen e dashurinë për Ehli Bejtin mjet për të fituar e për të siguruar mjetet e jetesës, sepse kjo rrugë sjell mbetjen prapa mësimëve të Imamit.

Imam Xhafer Sadiku u bëri thirrje shi'ave që të shkrihen e të bëhen një me myslimanët e tjerë, njëkohësisht kërkoi prej tyre të jepnin ndihmën e tyre në aktivitetet e përgjithshme dhe të mos mbeten prapa rrugëtimit në organizimin e të gjithëve myslimanëve, ndryshe mbetja prapa në këto punë dhe gjetja e pretekstit sipas dëshirave e kuptimit të devijuar, s'është gjë tjetër veçse kundërshtim i asaj që ka vendosur Allahu dhe i Dërguari i Tij.

Në transmetimet tregohet se dikush e ka pyetur Imam Xhafer Sadikun: "Si duhet të sillemi me njëri-tjetrin e me të tjerët, pasi jemi të përzier edhe me ata që s'janë në punën tonë?"

Imam Sadiku iu përgjigj: "Shikoni imamët tuaj, të cilët ju i ndiqni dhe veproni ashtu siç kanë vepruar ata.

Pasha Allahun, ata kanë vizituar të sëmuret e tyre, kanë marrë pjesë në varrimin e tyre, kanë dëshmuar në favor e kundër tyre dhe u kanë dorëzuar atyre sendet e lëna amanet.”¹⁰¹

Këtu kemi një dallim mes shi’ave në kuptimin e ndjekësve të Imam Aliut e të Ehli Bejtit dhe mes shi’ave që zgjedhin çdo profesion e që thonë se janë shi’a vetëm për të fituar.

Një shi’a i vërtetë, kurrë nuk bie pre e parimit për të fituar për llogari të interesit personal. Ai kurrë nuk e përdor rrugën e paligjshme për të arritur atë që ai dëshiron, pasi më parë mbi atë rrugë të paligjshme është derdhur një ngjyrë prej të ligjshmes.

Shi’a i sinqertë është vetëm ai që i ruan gjithmonë bazat e kulturës së vet, është ai që në sjelljen e tij pasqyrohet kujtimi i bukur i imamëve të tij dhe që i bën zemrat të pulsojnë me këtë kujtim, duke e ruajtur kujtimin e tyre të gjallë.

Një shi’a i vërtetë punon me qëllim që flamuri i përkrahësve të Aliut dhe i Ehli Bejtit të vazhdojë të valëvitet gjithmonë lart, derisa të dalë Imam Mehdiu, i cili

¹⁰¹ “Elkâfij”, vëll. 2, f. 636, prej dhjetë librave.

do të mbushë botën me drejtësi, pasi ajo është e mbushur me padrejtësi e dhunë.¹⁰²

Patjetër, një shi'a që përkrah me të vërtetë imamët e Ehli Bejtit, nuk e sakrifikon të vërtetën, edhe atëherë kur atij i duhet të notojë kundër rrymës. Ai e bën këtë pa pasur frikë se mund të mbytet, pasi për atë s'ka nderim më të lartë se vdekja në rrugën e ndjekjes së Imam Aliut dhe shkollës së tij.

Një shi'a i tillë, kurrë nuk i lejon vetes të rrokulliset në humnerat e moraleve të liga, të gjejë strehë në gjuhën e sharjeve e të mbrohet me shpifje e fjalë të urryera. Një shi'a i sinqertë nuk lëshon shpifje e akuza mbi ata që nuk ndjekin programin e Aliut e që nuk ecin në rrugën e tij të qartë. Njëkohësisht ai ngre lart ushtën e denoncimit, pa u trimëruar kundër atyre që në kohën tonë kërkojnë ndihmë prej Ebu Dherrit me rrugën e me sinqeritetin e tij dhe duan të parakalojnë të tjerët në specifikimin e në kuptimin e punëve, në një kohë kur lufta që përballojnë këta kërkes

¹⁰² Lexo librin "Akijdetu Ehli-s'sun'neti uel-etheru fil-Mehdij elmuntedhar"-*"Doktrina e Ehli Syneetit dhe transmetimet për Mehdiun e pritshëm"*, shejh Abdul-muhsin El-ab'bàd, zv/rektor i universitetit islam të Medines së ndritur, Botuar në shtypshkronjat "Erreshijd", në Medine, në vitin 1402 të Hixhretit. Këtë libër e kemi përkthyer në gjuhën perse dhe është botuar së bashku me një kumtesë tjetër, me titull "Reformatori botëror". Libri është botuar prej shoqatës "Itl'àt" në Teheran.

ndihme prej Aliut e prej Ebu Dherrit e prej rrugës së këtyre të dyve nuk është më e ashpër e më e egër se lufta që ata të dy bënë kundër adhuruesve të engjëjve dhe kundër khavarixhëve (pjesa e ushtrisë së Aliut që iu kundërvu Aliut në ngjarjet e Luftës së Sifijnit).

Le t'i rikthehemi gjendjes gjatë Betejës së Sifijnit. Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu, shejh që banorët e Shamit fillojnë të hedhin kundër tij fjalë fyese dhe e shajnë atë. Prijësi i besimtarëve, në atë gjendje, nuk bëri gjë tjetër vetëm se i ndaloi njerëzit e vet që t'i përgjigjeshin atyre me të njëjtën monedhë dhe u thoshte:

“Unë e urrej që ju të shani. Nëse ju do të cilësoni punët e tyre, ose kur të përmendni gjendjen e tyre, është shumë më mirë t'i justifikoni ata dhe, në vend të fjalëve sharëse, të thoni: “O Allah, o Zoti ynë, ruaje gjakun tonë e gjakun e tyre, fut paqe mes nesh e mes atyre! Udhëzoi ata që të dalin prej rrugës së tyre të gabuar, derisa çdo njëri prej tyre të mësojë të vërtetën për të cilën s'ka dijeni! Tregoni kujdes të mos ecni në rrugën e gabuar e të agresionit ndaj kujtdo që flet kundër jush!”¹⁰³

¹⁰³ “Nehxhul-Belàgah” e Imam Aliut, f. 323. Komenti i shejhut Muham’med Abdeh, myfti i trevave të Egjiptit, Botuar në Kajro. Së fundi, botuar në vitin 1425 të Hixhretit. Biblioteka ndërkombëtare “Shurùk”-“Lindja e diellit” e botoi këtë koment së bashku me një parathënie të veçantë, të shkruar prej meje. Libri është botuar nën

Ne kemi të drejtë të shtrojmë pyetjen: Si është puna? Cila është detyra që të ngrihen përkrahësit e mbështetësit e singertë të Aliut e të Ehli Bejtit, në një kohë kur armiqtë, ose kundërshtarët injorantë s'kanë gjuhë tjetër përveç gjuhës së sharjeve? Armiqtë, me sharjet e tyre, nxijnë faqet e librave që shkruajnë dhe e mbushin atmosferën me zhurmë. Këta kundërshtarë injorantë, duke ecur në rrugët e lëshimit të akuzave mjerane mbi përkrahësit e mbështetësit e Aliut e të Ehli Bejtit, i atribuojnë atyre shpifje, që quhen "isràilij'jâte" (thënie të huazuara prej stisjeve të jehudive) deri edhe legjendën Ibn Sebe.

Padyshim që gjuha e sharjeve nuk meriton e nuk ka vend për atë shtresë, të cilët Imam Aliu i urdhëroi të pastronin gjuhët e tyre dhe të bënë kujdes, që të mos binin në greminën e sharjeve e të shpifjeve. Gjithashtu, edhe imam Sadiku deshi që në sjelljet e në punët e ndjekësve të tij të pasqyrohej shembulli më i lartë për t'u ndjekur, derisa bota të dëshmojë e të thotë: "Shiko ç'njerëz janë ata që u edukuan në shkollën e Ehli Bejtit."

Në një transmetim tjetër, Imam Sadiku i porositi ndjekësit e tij dhe, pasi i përshëndet ata me selam, u thotë: "Mbani lidhje me njerëzit e tribusë suaj, merrni pjesë në varrimin e tyre, vizitoni të sëmurët e tyre, u jepni atyre të

mbikëqyrjen e plotë nga ana ime në Kajro, në vendin e quajtur Ird Elkenàneh.

drejtat që i takojnë. Në të vërtetë, burri prej jush, që është i përkushtuar në fenë e tij, vërteton hadithin, kryen porosinë që i është lënë në mirëbesim dhe ka moral të mirë me njerëzit. Për një të tillë thotë: “Ky është Xhaferi, kjo mua më gëzon, pasi prej tij mua më hyn gëzimi. Por kush vepron ndryshe nga kjo që u tha, te mua hyn e keqja e turpi i tij, pasi për sjelljen e tij të keqe do të thuhet: “Ky është morali i Xhaferit!”¹⁰⁴

Përballë kësaj rruge shtrohet pyetja: Nën hijen e kësaj rruge, në të cilën është mbizotëruese paqja, shpëtimi e humanizmi, cila është detyra jonë? Si duhet të veprojmë ndaj personave, si Ibrahim Elxhebhàn, Ibrahim Ali Shu’ùdh, Ihsàn Ilàhij Dhahijr, Dr. Abdullah Elgarijb, Muhib’bu-d’dijn Elkhatibij, Abdul-mun’im Elberij dhe të tjerëve të ngjashëm me këta?

S’ka dyshim se prania e tyre dhe të ngjashmëve me këta, në të kaluarën e në të tashmen, mendimet e tyre gjenden të botuara në librat e tyre dhe kjo është ajo që i ka bërë sipërfaqësorë disa prej njerëzve të Ehli Syneetit, që të hedhin mbi shi’at veset më të ulëta e më të liga, madje hedhin mbi ta deri punë të atilla, që i nxjerrin ata prej

¹⁰⁴ “Elkàfij”, vëll. 2, f. 600, prej librit të dhjetëve, K. “Çfarë është detyrë në bashkëjetesën me të tjerët?”

cilësive njerëzore¹⁰⁵, në një kohë që disa të tjerë prej tyre shkojnë deri atje sa t'i etiketojnë shi'at për idhujtari, ose për ekzagjerime. Natyrisht që kjo rrugë e ka zgjeruar gjithnjë e më shumë çarjen në shoqërinë islame, shi'a-syni, sa disa herë vihem para pyetjeve të llojit: A është Kur'ani i shi'ave si Kur'ani i Ehli Syneetit? A i shajnë shi'at sahabët e të Dërguarit?

Rezultati i kësaj çarjeje ishte kolonializmi dhe duart e kapitalizmit shfrytëzuan rastin për t'i fryrë gjithnjë e më shumë zjarrit të përçarjes mes myslimanëve, me qëllim që kolonializmi të ishte sundues përgjithmonë.

Natyrisht që nuk janë të pakët ata që dyshojnë për ekzistencën e të tilla gjendjeve. Por përsëri mbetet pyetja, që e shtron vetë gjendja: Si është puna?

Ne mendojmë se patjetër nuk duhet të ndiqet rruga e përgjigjes me të njëjtën monedhë dhe se është detyra jonë të mendojmë për punë të mirëfillta rrënjësore dhe të punojmë që të na jepet mundësia të botojmë historinë e shi'ave e doktrinat e tyre dhe t'i shpjegojmë ato me nivel shkencor edhe në gjuhë të ndryshme. Këtë patjetër duhet ta bëjmë duke u mbështetur në këndvështrimin shkencor

¹⁰⁵ Lexo parathënien e librit "Aslu-sh'shij'ati ue usùluhà" - "Origjina e shi'ave dhe bazat e tyre", Botuar në Kajro, autori, i ndjeri Kàshiful-Gitài, për të konstatuar disa prej thënieve e punëve që thuhën në adresë të shi'ave dhe ato që u atribuohen atyre.

të Shi'izmit nëpërmjet studimeve historike shkencore që pasqyrojnë të vërtetën e Shi'izmit ashtu siç është ajo, realisht dhe jo ashtu siç e servirin atë disa injorantë, ose ashtu siç e kuptojnë atë injorantët e disa agentë prej orientalistëve.

Ne besojmë se kjo rrugë na mundëson të pasqyrojmë Shi'izmin në dimensione që janë shumë larg kufirit që vënë sofistët qëllimkëqij, të cilët synojnë të ngulin pykën e përçarjes në radhët e Islamit.

Në të vërtetë, përse njeriu mbështetet në gjuhën e sharjeve, në një kohë që beson vërtetësinë e logjikës së tij dhe beson drejtësinë e fjalëve që thotë?

Përse njeriu mbështetet në një praktikë foshnjarake naive, që nuk është në përshtatje me pozitën e njeriut dhe me këtë u jep shkak kundërshtarëve të shi'ave, që të përmbysin të vërtetat dhe të thonë se të gjithë shi'at janë pjellë e Abdullah ibn Sebes, këtij personi të trilluar jehudi?¹⁰⁶

¹⁰⁶ Lexo studimin e thelluar të dijetarit të dëgjuar, Es'sej'jid Murtedà El-asferij, në librin e tij "Abdull'llah ibn Sebe ue esàtijre ukhrà"- "Abdullah ibn Sebe dhe legjenda të tjera", Botuar në Bagdad, Bejrut dhe Kajro. Gjithashtu, lexo librin tjetër të këtij autori, me titull "El-ustüertu-s'seb'ij'jetu"- "Legjenda e Seb'izmit", vëllimi i parë, Botuar në Kom, Iran.

Pjesëmarrja jonë në takimet islame dhe në nismat për mbajtjen e konferencave në nivel dijetarësh të mëdhenj të medh'hebeve islame, si dhe botimi i librave e i revistave dobisjellëse në gjuhë të ndryshme, na ndihmon të arrijmë në një formë akoma më të mirë. Në këtë kuadër luajnë një rol ndikues në rrugën e aktivizimit efektiv institucioni që e kemi emërtuar "Shtëpia e afrimit mes medh'hebeve islame" me qendër në Kajro, si dhe Kompleksi Ndërkombëtar për Afrimin mes Medh'hebeve islame, me qendër në Teheran.

Në këtë rrafsh, themelimi i "Shtëpisë së afrimit mes medh'hebeve islame" në Kajro, gjatë viteve dyzet, u bë me dorën e njërit prej dijetarëve e ideologëve të mëdhenj shi'a, shejhut Muahm'med Tekij Elkomij, me ndihmën që ai pati prej shejhëve të universitetit të Ez'herit sherifit. Themelimi i kësaj "Shtëpie" numërohet një prej projekteve bazë që mund të ketë një rol të rëndësishëm për njohjen me Shi'izmin në nivel botëror, duke nënvizuar në mënyrë të veçantë faktin që kjo "Shtëpi" u themelua pranë universitetit të Ez'herit sherifit, si një organizëm islam themelor në botë.

Afërsisht para pesëdhjetë vjetëve, madje edhe para daljes së sentencës ligjore (fetvësë) historike, që nxori shejhu Muham'med Sheltût për lejimin e adhurimit sipas medh'hebit shi'i, duke vërtetuar me këtë fetva rrugën tonë,

në mbrojtje të logjikës së fuqishme për afrimin mes medh'hebeve islame, ne vazhdojnë të jemi konsekuentë në thirrjen për afrimin. Këtë e dëshmojmë me botimet e shumta e të ndryshme fetare që kemi nxjerrë, si dhe me ndihmesën që japim në "Rrethin shkencor fetar" në qytetin Kom të Iranit.¹⁰⁷

Në këndvështrimin tonë, "afrim" do të thotë njohje e saktë e bazave të Shi'izmit dhe të doktrinave reale të Ehli Syneetit, por nuk do të thotë anim ndaj një medh'hebi tjetër. Me një shprehje akoma më të qartë, "afrim" do të thotë ruajtje e unitetit dhe e vëllazërimit islam. Por në asnjë rast nuk do të thotë heqje dorë prej doktrinave tona, pasi një mendim i tillë është fals dhe njëri prej shembujve të sofizmit. Në të vërtetë, "afrim" do të thotë qëndrueshmëri në doktrinat tona dhe ruajtje e këtyre doktrinave, do të thotë të punohet me vendosmëri për t'i shpjeguar doktrinat dhe thirrje për t'u kapur pas këtyre doktrinave me një mënyrë të saktë, larg prej provokimit të ndjenjave

¹⁰⁷ Gazetat e revistat javore e mujore: "Nidâu hak'kin"- "Thirrja e vërtetë", revista në gjuhën perse "Nûr Dànish", "Muslimijn"- "Muslimanët", "Mekteb Islam"- "Biblioteka e Islamit", "Mekteb teshej'jêi"- "Biblioteka e Shi'izmit", "Vedhijfetun"- "Detyra", revista në gjuhën perse "Estân Kuds ue meârif xhaferij", revista "Elhâdij"- "Udhëzuesi", që dilte në gjuhën arabe, në qytetin Kom të Iranit, prej "Qendrës Shkencore Fetare", nën mbikëqyrjen time dhe që ka vazhduar të dalë për shtatë vjet.

dhe nxitjes së reagimeve negative, sepse të gjithë ndajmë një fjalë të përbashkët për bazat e doktrinae.

Kur studiuesi s'ka dobësi e mangësi shkencore dhe është i përkushtuar të orientojë studimin drejt njohjes logjike, ky studiues kurrë nuk zgjedh dhe nuk shkon prapa parregullsive. Ai nuk kapet pas thënieve të quajtura "israëlilij'jate"- "stisje të jehudive", me të cilat janë të tejmbushura librat e medh'hebit që ai ndjek, sidomos kur dihet se të këtilla "israëlilij'jate" mund të gjenden në çdo medh'heb prej medh'hebeve islame. Dijetari i mirëfilltë patjetër ka zgjedhur t'i referohet edhe librave të grupit, që është ndryshe prej grupit të tij dhe jepet krejtësisht pas studimit të çështjeve përkatëse, që kanë lidhje me ato çështje nga një këndvështrim shkencor analitik i plotë, që e çon atë në një gjykim të drejtë.

Ky është koncepti real për afrimin. Por të vjen keq kur shejh se disa mbështeten në metodën e nxitjes së masës së njerëzve, ashtu siç ngjau në kohën e të ndjerit Ajetu-llah Es'sej'jid Muham'med Husejn Elburuxherdij (pika më e lartë e referimit fetar në Iran), kur disa prej të lartpërmendurve e cilësuan korrespondencën e të ndjerit Elbruuxherdij me shejhun Mahmud Sheltut si një prej shembujve të kthimit prapa. Këtë e thanë pa vënë në dukje se ajo korrespondencë dhe ai shkëmbim i ndërsjellë njohurish, në fund të fundit prodhoi fetvanë historike të

shejhut të Ez'herit sherifi për lejimin e kryerjes së adhurimit sipas medh'hebit shi'i.

Kuptohet se njerëz të tillë, të mveshur me frymën e nxitjes, janë prej atyre sipërfaqësorëve që vuajnë nga mungesa e pavarësisë ideore, prandaj përpiqen të shprehen kundër atyre që e mbrojnë afrimin në rrugën e logjikës dhe të thonë se ata pasqyrojnë një rrugë maskimi në qendrën e Shi'izmit.

Por prania e personaliteteve të mëdhenj të shi'ave, që janë në krye të procesit të afrimit, vunë pengesa mes suksesit të kësaj shpifjeje dhe e kanë rrëzuar atë poshtë me dorën e atyre që e stisën.

Prej personaliteteve të mëdhenj shi'a, në rrafshin e mbrojtjes së mendimit të afrimit mes medh'hebeve islame, dallohen emra dijetarësh:

* Ajetullah Es'sej'jid Muham'med Husejn Elburùxherdij

* Ajetullah Esh'sehjkh Muham'med Husejn Kàshiful-gitàë

* El-alàmeH Esh'shejkh Muham'med Tekij Elkamij.

* El-alàmeH Esh'shejkh Muham'med Ridà Elmudhaf'fer

* El-alàmeH Es'sej'jid Sherfefu-d' dijn El-àmiliH

* El-alàmeH Es'sej'jid Muhsin El-emij El-àmiliH

* Esh'shejkh Muham'med xhevàd muginjeh... e të tjerë.

Në këtë fushë mund të regjistrohet se çështja e afrimit mes medh'hebeve islame ka gjetur gjuhë të përbashkët në mbarë horizontet islame, sidomos pas lëvizjes përmirësuese unifikuese, në të cilën u gërshetua puna e madhe e luftëtarit në rrugën e Allahut, e dijetarit të vendosur, Xhemàlud'dijn Elhusejnij El-esed Àbàdij, i njohur me mbiemrin El-efgànij¹⁰⁸ dhe e dijetarit të civilizuar të Ez'heri sherifit, shejhut Muham'med Abdeh, myfti i trevave të Egjiptit. Kjo lëvizje, me mbështetjen e dijetarëve të mëdhenj shí'a dhe të personaliteteve mendjehapur prej Ehli Synetit, munda të bëjë realitet atë kthesë vendimtare në historinë e marrëdhënieve mes myslimanëve dhe të lëshojë valë goditjesh në thelbin e

¹⁰⁸ Lexo "El-àthàrul-kàmiletu", autor Xhemàlud'dijn Elhusejhij (El-efgànij), nëntë vëllime, përgatiti dhe e paraqiti Sej'jid Hàdij Khasrùshàhij, Botuar në Kajro, Biblioteka ndërkombëtare "Eshshurùk", viti 1422 i Hixhretit.

fanatizmit injorant, madje të arrijë edhe fitore në këtë rrugë.

Profesori ynë, i fushës së interpretimit të Kur'anit e të filozofisë, El-alameh Es'sej'jid Muham'med Husejn Et'tabàtài, autor i botimit me vlera të larta "El-mijzànu fij tefsijril-Kur'àn"- "Peshorja në interpretimin e Kur'anit", thotë: "Nga pikëpamja e logjikës s'ka asnjë dyshim se pesha anon kah bashkimi, ose afrimi islam dhe, natyrisht që elementët përçarës bënë ç'mundën për të shkaktuar ndarjen mes dy grupimeve të mëdha. Prandaj detyra jonë e vazhdueshme është të theksojmë se kundërshtimet mes dy grupimeve janë vetëm në degët dhe s'ka asnjë kundërshtim mes dy grupeve, përsa u përket bazave të tyre. Në të kundërt, të dy grupet ndajnë një fjalë të përbashkët për degët e fesë, që janë domosdoshmëri, si: namazi, agjërimi, Haxhi, lufta në rrugën e Allahut, etj. Të gjitha këto bashkohen në besimin në një Zot të vetëm, në një Profet të vetëm, në një Kur'an të vetëm dhe në një Kible të vetme."

Mbështetur mbi këtë bazë, gjejmë se shi'at e brezit të parë kurrë nuk u ndanë prej radhës së shumicës dhe kurrë nuk munguan të japin ndihmesën e tyre së bashku me masën e myslimanëve për ecurinë e përgjithshme islame dhe në këtë rrugë ata punuan dhe këshilluan shumë.

Gjithashtu, myslimanët kanë detyrë të kthejnë sytë në veten e tyre dhe të marrin parasysh se të gjithë ndajnë një fjalë të përbashkët për bazat e Islamit dhe të mos harrojnë presionet që u ushtruan mbi ta gjatë asaj periudhe, për shkak se ishin në një radhë të vetme dhe me këtë qëndrim praktikisht ata kishin hequr dorë prej ndarjes.

Në ditët e sotme myslimanët duhet ta dëshmojnë këtë të vërtetë me punë, para se të tjerët ta zbulojnë dhe të shkruajnë për ndarjen në librat e tyre dhe ta konsiderojnë ndarjen një të vërtetë historike.

Fatmirësisht bota islame pak e nga pak ka filluar të jetë e vëmendshme ndaj kësaj të vërtete. Përkrahja e mbështetja ndaj burimeve të shi'ave për idenë e afrimit mes medh'hebeve islame erdhi pikërisht si rezultat i këtij orientimi, ashtu siç rezultoi për vetë shejhun e Ez'heri sherifit, shejhun e respektuar, Mahmud Sheltut, i cili e shprehu këtë të vërtetë me qartësinë më të madhe dhe foli hapur për mbarë botën, për harmoninë fetare të plotë mes shi'ave dhe Ehli Syneetit. Prandaj për shi'at është detyrë ta përmendin këtë burrë të madh me fjalë lavdëruese dhe të vlerësojnë nismat e tij të pastra.

I lutemi Allahut të Lartësuar të udhëzojë në rrugën e drejtë qëllimkëqijtë, të përmirësojë ata që duan shkatërrimin, të bëjë mbarë bashkimin e myslimanëve dhe

atyre t'u kthehet lavdia e mëparshme e madhështia që ata e humbën.”¹⁰⁹

Ne s'kemi asgjë në dorë veçse të drejtohem me lutje për profesorin tonë, të ndjerin Es'sej'jid Et'tabàtâij, duke uruar prej thellësisë së zemrave tona për dritëshkurtërit, si dhe për ata që shikojnë interesat personale, lutemi që para tyre të jetë i qartë mjedisi që i rrethon dhe që ata të jenë të vëmendshëm ndaj kompleteve të mëdha që thurin armiqtë e Islamit, lutemi që para këtij realiteti ata të kapin me ndjenja të thella rreziqet e mëdha dhe të punojnë me ngulm në rrugën e unitetit e të afrimit.

Dijetari i madh, i ndjeri Es'sej'jid Abdul-muhsin El-Emijnij, gjithashtu e ka mbështetur unitetin islam dhe në librin e tij, me vlera të larta, ka shpallur me qartësi të plotë se studimi shkencor e teologjik nuk mund të jetë dhe nuk duhet të jetë pengesë në rrugën e unitetit. Prandaj shikojmë se, në parathënien e librit të tij me vlera të larta, me titull “Elgadijr”, ai tekstualisht thotë: “Opinionet, doktrinat e vlerësuara dhe medh'hebet janë të lira dhe nuk i prishin lidhjet e vëllazërimit për të cilin flet Libri i Allahut:

¹⁰⁹ El-alemeH Et'tabàtâij, “Eshij'atu uet'teshej'juë”. Përgatitja, paraqitja dhe komenti Sej'jid Hâdij Khasrûshâhij, botimi i dhjetë, Botues, “Qendra e Studimeve Islame”, Kom, Iran.

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ إِخْوَةٌ فَأَصْلَحُوا بَيْنَ أَخَوَيْكُمْ

“in’nemel-muëminùne ikhvetun feaslihù bejne ekhavejkum...”
“Padyshim që besimtarët janë vëllezër dhe bëni pajtim mes vëllezërve tuaj...”¹¹⁰ edhe atëherë kur dialogu mes vëllezërve besimtarë arrin në pikën më të ashpër dhe kundërshtimet vijnë me tone të shtuara e të larta, patjetër duhet të ndiqet mirësia e jetës së brezit të parë të myslimanëve. Në pararojë të të cilëve janë sahabët e tabi’inët.

Ne autorët e të gjitha vendeve e rajoneve të botës islame, pavarësisht nga opinionet tona të ndryshme dhe pavarësisht se ne ndryshojmë nga degët, të gjithëve na bashkon një bazë e drejtë, na bashkon besimi në Allahun e në të Dërguarin e Tij, na bashkon një frymë e vetme, një veçori fetare e pastër prej dëshirave të gabuara, na bashkon singjeriteti në besimin, në Njëtimin e Allahut. Të gjithë ne si autorë librash jetojmë nën flamurin e të Vërtetit dhe nën flamurin e Islamit, jetojmë nën udhëheqjen e Librit (Kur’anit) e të mesazhit të shenjtë të Profetit arab. Thirrja jonë është:

إِنَّ الدِّينَ عِنْدَ اللَّهِ الْإِسْلَامُ

¹¹⁰ Sure “El Huxhuràt”, ajeti 10.

“In’ne-d’dijne inde-ll’llàhil-islàmu...” “Feja te Allahu është Islami...”¹¹¹ Parulla jonë është: “ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ ” “lâ ilàhe il’le-ll’llàh, Muham’medun resùlu-ll’llàh”, “S’ka Zot tjetër përveç Allahut, Muhamedi është i Dërguari i Allahut”. Bëni kujdes, ne jemi “partia” e Allahut dhe mbrojtësit e fesë së Allahut.”¹¹²

¹¹¹ Sure “Al Imran”, ajeti 19.

¹¹² Enciklopedia “Elgadijr”, parathënia e vëllimit të pestë, Botuar në Bejrut.

NJË HAP NË RRUGËN E AFRIMIT

Pas njohjes me çështjet e shtruuara më sipër, arrijmë në librin që kemi në dorë¹¹³, për të cilin mendojmë se është një punë e singertë në rrugën e afrimit mes medh'hebeve islame. Gjithashtu, mendojmë se botimi i këtij libri nuk jep ndihmesë vetëm në shpjegimin e historisë së Shi'izmit për botën e Ehli Synetit, por ushqen edhe kërkesat e njeriut bashkëkohës dhe pasionin e tij për më shumë njohuri rreth kësaj teme, duke i dhënë një rast të gjithë atyre që karakterizohen për maturi, që të bëjnë dallimin mes nesh dhe mes atyre që bëjnë vetëm zhurmë dhe pastaj le të gjykojnë me argumente e me qartësi.

Kur ne duam të shtrijmë urat e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe të shkulum dëshirat e paragjykimet që nuk shërbejnë për asgjë dhe, kur punojmë që të ulim dallgët e propagandës kontradiktore, të mbështjellë me qëllime të

¹¹³ Ky suplement është botuar si parathënie e librit "Tariikhul-firekil-islamij'jeh"- "Historia e grupeve islame", vëll. 2, autori dr.prof. Muham'med Ibrähijm Elfijùmij, rektor i Fakultetit të Bazave të Fesë në universitetin Ez'heri sherijf, Botuar në Kajro, në vitin 1423 të Hixhrettit. Libri është botuar në gjashtë vëllime të mëdha.

degjeneruara, detyra jonë është të hapim portën e studimit e të vërtetimit shkencor, pasi vetëm me këtë punë nuk u lëmë rast atyre që rrinë në pritje për të përhapur gjëra të gabuara. Gjithashtu, në sajë të këtyre studimeve arrijmë unitetin islam dhe në të njëjtën kohë nuk lejojmë disa qëllimkëqij të vënë hadithe të stisura, që me ato të qëllojnë shi'at, madje ata edhe në shekullin e shkencës e të teknologjisë vazhdojnë të thonë se shi'at kanë lidhje me jehudinë e stisur Ibn Sebe, ose mashtrojnë kur pohojnë se Shi'izmi është stisje e sufistëve, ose është trillim i bohemëve, ose i akuzojnë shi'at për idhujtari, ngaqë shi'at bëjnë sexhde mbi tokën e pastër dhe i cilësojnë për të këqijat e ekzagjerimit e për mohim, për shkak të dashurisë që kanë shi'at ndaj Ehli Bejtit.

Në të vërtetë, mbështetja e dashuria e veçantë për Imam Aliun na bën thirrje të ecim në këtë rrugë, që cilësohet se është rrënjësore dhe numërohet prej rrugëve më dobisjellëse e më logjike. Madje është detyrë që këtë rrugë ta bëjmë vendkalim nëpër të cilin të ecin të gjithë, ta bëjmë një program të përgjithshëm dhe nën dritën e këtij programi të planifikojnë aktivitetin tonë të ardhshëm, të punojmë me sinqeritet, që në këtë rrugë të arrijmë punët që kemi qëllim, pa u merakosur për akuzat e për shpifjet e armiqve dhe pa u frikësuar prej miqve injorantë.

Është e domosdoshme të theksojnë se fusha e kulturës në Egjipt e në vende të tjera të botës islame ka nevojë të ngutshme për këto lloj studimesh objektive dhe larg ekzagjerimeve, ka nevojë për botime që hedhin dritë mbi historinë e shi'ave e të Shi'izmit, edhe kur jemi në një fjalë me autorin, ose edhe kur kemi kundërshtime me atë për disa çështje që kanë lidhje me shfaqjen e shi'ave, të Shi'izmit, siç ishte tregimi Abdullah ibn Sebe dhe ajo që e quajnë Seb'izëm. Gjithsesi, kundërshtimi për disa mendime nuk e prish dashamirësinë ndaj problemit, gjithashtu kundërshtim nuk do të thotë pakësim i vlerave e i rëndësisë së librit. Njëkohësit, kundërshtim për disa çështje nuk do të thotë aspak pakësim për personalitetin e prof.dr. Elfijùmij e i vlerave të mëdha shkencore që ai mbart, vlера që i mundësuan atij t'i futet studimit të një çështjeje kaq të rëndësishme, studim që jep ndihmesën e vyer për t'u njohur me historinë e shi'ave e të Shi'izmit dhe, jo vetëm kaq, por jep ndihmesën e vet edhe për afrimin mes Ehli Syneetit dhe shi'ave, në një kohë që afrimi, bazën e tij e mbështetet në njohjen e asaj që e mohon injoranca, kurse dyshimi është baza e ndarjes mes myslimanëve...¹¹⁴

¹¹⁴ Në fundin e artikullit, shkruesi flet me fjalë nderimi e vlerësimi për autorin e librit "Tàrijkhul-firekil-islàmij'jeh" - "Historia e grupeve islame", madje edhe lutet për autorin për mundin që ai ka derdhur për

SUPLEMENTI I TRETË

JO, O VËLLEZËRIT TANË NË FE!¹¹⁵

Të respektuarit, z. kryeredaktor i revistës
“Et’teuhijd”

Es’selami alejkum ue rahmetull’llàhi ue berekàtuhù
(Paqja, mëshira e begatitë e Allahut qofshin për ju!).

Më parë, në dy numrat, shtatë e tetë të revistës suaj,
keni botuar një artikull me titull “O thirrës të afrimit”. Më

realizimin e këtij libri dhe për frutat e mira që merren prej tij. Këtu kemi hequr pjesët që s’kanë lidhje me çështjen që kemi në trajtim.

¹¹⁵ Këtë artikull autori i librit që kemi në dorë e shkroi në Kajro, si përgjigje ndaj protestës së revistës “Et’teuhijd” dhe sulmeve që ndërmoi kjo revistë kundër Konferencës për afrimin, që u mbajt me rastin e përkujtimit të ditëlindjes së Profetit, në vitin 1422 të Hixhretit. Këtë artikull autori i librit ia dërgoi administratës së revistës së lartpërmendur, por ajo natyrisht nuk e botoi. Këtë revistë e boton forumi “Ndihmuesit e praktikës muhamedane”. Anëtarët e këtij forumi janë të njohur në Egjipt për përkatësinë e tyre në rrymën ekstreme selefiste, madje ata kanë edhe xhami të veçanta dhe libra e botime të tjera.

pas, në numrin dhjetë keni botuar një artikull tjetër me titull “Grup prej të cilat dijetarët kanë paralajmëruar: “Ruhuni, shi’at e dymbëdhjetë imamëve!”

Në këto artikuj autori ka dalë jashtë kufijve të moralit e të edukatës, diturisë e devotshmërisë morale që Islami i ka bërë detyrim për myslimanët në sjelljen e tyre me të tjerët, sidomos në sjelljen e në bashkëpunimin me vëllezërit në fe. Prandaj autori të mos përhapë fjalë të kota, si ato nisur prej fanatizmit për medh’hebin e tij dhe të rrijë në përgjim të të tjerëve sipas mendësisë së kohës së kaluar dhe jo të kohës së tanishme.

Ne jetojmë në një shekull të hapur, jetojmë në një kohë kur njeriu ose grupi e ka të vështirë të fshejë doktrinat e veta dhe të adaptojë doktrina sekrete. Autori i artikujve të lartpërmendur, bazuar në burimet e armiqve, këto doktrina sekrete ia adreson shi’ave imamij, pa i vënë vetes detyrim të marrë mundimin e të studiojë edhe në burimet e shi’ave, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe me objektivitet të mirëfilltë.

Këtu do t’i përgjigjemi në përgjithësi e shkurtimisht atakimeve e dyshimeve që ka shkaktuar artikullshkruesi rreth grupit të shi’ave imamij, atakime e dyshime, që në brendinë e vet nuk janë të reja, pasi në të vërtetë ato janë pjellë e mendësisë së kohës së kaluar. Dihet se dijetarët e shi’ave e kanë kundërshtuar këtë mendësi, i kanë dhënë

përgjigje dhe e kanë bërë pa asnjë vlerë. Për artikullshkruesin do të ishte shumë më mirë sikur të stolisej me objektivitet, me maturi dhe të njihej me këto përgjigje të dijetarëve shí'a, para se të lëshonte shigjetën e tij të akuzave mbi fytyrën e shí'ave. Duket qartë se artikullshkruesi, me këtë shkrim, ka qëllim të pakësojë sa më shumë rëndësinë, kapacitetet dhe rolin e shí'ave, pavarësisht se shí'at përfaqësojnë një të tretën e myslimanëve në nivel botëror.

Sikur të ndiqnin rrugën e këtij artikullshkruesi përballë doktrinave të disa vëllezërve tanë prej Ehli Syneetit dhe, kam qëllim ata që e quajnë veten "selefij", patjetër që do të kishin të njëjtin rezultat. Trashëgimia e atyre që e emërtojnë veten "selefij", është e mbushur me të meta, por ata i hedhin mbi shí'at. Këtu nuk kemi qëllim të numërojmë të metat që ata hedhin mbi shí'at dhe që janë të shkruara në shumë libra. Por ata nuk kufizohen të flasin vetëm kundër shí'ave. Me të meta të tilla ata kanë sulmuar edhe armiqtë e tyre mutezilet e të tjerë.

ÇËSHTJA E AFRIMIT

Artikullshkruesi ka sulmuar çështjen e afrimit mes synive dhe shi'ave dhe e ka vënë këtë çështje në dyshim. Ky sulm i tij, në brendësinë e vet është sulm edhe kundër dijetarëve të mëdhenj të Ez'heri sherifit, të cilët e kanë adaptuar idenë e afrimit. Njëkohësisht ky sulm i këtij artikullshkruesi do të thotë edhe injorim ndaj atyre dijetarëve. Vetëkuptohet se qëndrimi i këtij artikullshkruesi, jo vetëm që nuk është i drejtë, por as nuk lejohet të shprehet.

Kur artikullshkruesi thotë se shi'at prapa afrimit mes medh'hebeve islame fshejhin një qëllim të keq. Kjo do të thotë se edhe dijetarët e Ez'heri sherifit, gjithashtu, kanë qëllime të këqija. Sipas pretendimit të artikullshkruesit, janë pjesëmarrës dhe bashkëpunojnë me shi'at në komplotin kundër Islamit. A është logjike një fjalë e tillë?!

Artikullshkruesi akuzon dijetarët e studiuesit e Ez'heri sherifit se janë sipërfaqësorë e naivë. Në krye të këtyre sipërfaqësorëve e naivëve qëndron dijetari i madh, shejhu Mahmud Sheltut, i cili nxori në vitin 1858 fetvanë e dëgjuar për lejimin e kryerjes së adhurimit sipas

medh'hebit shí'i. Këtë fetva ai nuk e ka nxjerrë në vitin 1961, ashtu siç thotë artikullshkruesi.

Ishte detyrë e kësaj reviste të nderuar që, në radhë të parë, të shpjegonte qartë për ne nivelin e diturive të artikullshkruesit. Vallë a është i barabartë ai me dijetarët e Ez'heri sherifit, apo ai është më i ditur dhe ka më shumë njohuri se ata edhe në fushën e së drejtës islame?

Vallë a ka botuar ky artikullshkrues libra shkencorë me vlerë, apo ai është thjesht njëri prej atyre të vegjëlve që lehin kundër shí'ave?

Si është e mundur që ky artikullshkrues pretendon se shí'at janë njerëzit më përcarës e më konfliktualë për Ehli Synetin, kur Ehli Syneti është sovran, i kudondodhur e triumfues gjatë gjithë historisë së myslimanëve?

Sikur ky artikullshkrues të njihte sado pak historinë, patjetër do të kishte kuptuar se shí'at janë dhunuar e janë sulmuar vazhdimisht, jo vetëm në të gjithë shekujt e historisë islame, por edhe në kohën e tanishme.

Moralisht, artikullshkruesi ka detyrimin të argumentojë vërtetësinë e pretendimeve të tij dhe të na paraqesë një pasqyrë historike me numrin e përcarjeve e të konflikteve të shkaktuara prej shí'ave në përballjet e tyre me të tjerët, pavarësisht se janë të tjerët ata që i kanë

rrethuar shi'at gjithmonë me format e ndryshme të dhunës, brutalitetit, madje edhe i kanë prangosur e i kanë eliminuar fizikisht, jo për ndonjë faj që kishin bërë, por vetëm për faktin se deklaroronin që ishin dashamirës e mbështetës të njerëzve të familjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe për shkak se shi'at ndjekin Ehli Bejtin në doktrinat e në çështjet e së drejtës islame.

Në këtë shkrim, artikullshkruesi ka përcaktuar se qëllimi i shi'ave, me afrimin mes medh'hebeve islame është pohimi i ekzistencës së kontradiktës, përmirësim i mendimit të kundërshtarit për ato që ai thotë kundër shi'ave dhe hapja e portave të propagandës në favor të medh'hebit shi'i.

Natyrisht që kjo është një fjalë pa peshë e pa asnjë rëndësi. Shi'at nuk e mohojnë se ka kontradikta në lidhje me degët e së drejtës islame dhe se këto kontradikta kanë qenë qysh prej shekujsh. Sikur ky artikullshkrues të kishte lexuar burimet e shi'ave, patjetër do ta kishte kuptuar këtë fakt dhe, përsa i përket kërkesës për “përmirësimin e mendimit” të të tjerëve për shi'at, është një kërkesë e ligjshme dhe një e drejtë e çdo myslimani. Por ky artikullshkrues ua mohon shi'ave këtë të drejtë, pa marrë mundimin të shpjegojë shkakun përse ua mohon.

Përgjigjja dihet si është: artikullshkruesi dëshiron që myslimanët të mendojnë keq për shi'at, të armiqësohen me shi'at dhe t'i shpallin shi'at mohues. E gjitha kjo në një kohë kur armiqtë janë në përgjim kundër të gjithë myslimanëve, pa përjashtim, shi'a e syni dhe kur ata, në të gjitha vendet, kanë shpërthyer kundër myslimanëve një luftë si të kohës së kryqëzatave.

Këtu del pyetja: A nuk mbjell qëndrimi i këtij artikullshkruesit farën e konfliktit e të përçarjes mes myslimanëve?

Nëse janë shi'at ata që e kërkojnë “afrimin” dhe, artikullshkruesi për këtë kërkesë të shi'ave zbraz ato që ka në brendësinë e vet, a nuk do të thotë kjo se me ato fjalë ai po mbjell farën e përçarjes e të konfliktit mes myslimanëve?

Është e qartë se këto punë nuk kanë qenë në llogari të artikullshkruesit, sepse ai shkruan kundër shi'ave nisur prej pozicionit të fanatizmit të tij të veçantë dhe nuk shkruan prej pozicionit të përgjithshëm islam. Me siguri që artikullshkruesi e di që Islami nuk e lejon që myslimanët të shpallen mohues në doktrinat e tyre, derisa ata janë në kuadrin e dy dëshmime.

Ishte pikërisht qëndrimi islam që e shtyu halifen e dytë, Omer ibn Elkhatt'abin, të kundërshtonte halifen e

parë, Ebu Bekrin, kur ai vendosi të luftonte me armë ata që nuk jepnin Zekatin.

Si është e mundur që artikullshkruesi gjykon për qëllimet e shi'ave, kur Islami e ka ndaluar në mënyrë të prerë këtë lloj gjykimi?! Ku e merr ai argumentin për këtë gjykim?

Ibn Abdulhadij ka thënë: “Kërkuesi i diturisë nuk zbukurohet me ndonjë gjë më të bukur se maturia dhe lënia e fanatizmit.”¹¹⁶

Sikur artikullshkruesi të kishte lexuar “Librat e burrave”, librat që flasin për jetëshkrimin e burrave të dalluar të brezit të parë të myslimanëve, me siguri që në ato libra do të gjente se brezi i parë i myslimanëve kanë përcjellë hadithe prej kundërshtarëve të tyre shi'a, madje edhe prej havarixhëve e prej të tjerëve... Detyra e këtij artikullshkruesi mbetet që të lexojë parathënien e librit “Fet'hul-Bàrij”, e autorit Ibn Haxherit, ku do të shohë se Bukhàrj'ji ka transmetuar edhe prej përcjellësve kundërshtarë të Ehli Synetit.

Edh'dhehebij'ji ka thënë: “Ndodh shpesh që zemërimi me shokun bëhet mjaft i mprehtë dhe shkon deri

¹¹⁶ “Nasbu-rr'rràjeh”, vëll. 1, f. 355, Botuar në Kajro.

në braktisjen e ndaluar, madje shkon deri në shpalljen e tjetrit mohues, kurse nxitimi arrin deri në sharje.”¹¹⁷

Ibn Tejmiç’jeh ka thënë: “Nëse ai që gjykon mes njerëzve për punë pasurish, vrasjesh e atakim në nder, nuk është dijetar e i drejtë, ai është në zjarr. Por, si është puna për atë që gjykon pa dituri e pa drejtësi për çështje të fesë, të besimit, të diturive hyjnore dhe për çështje të fushës së diturive?”¹¹⁸

Artikullshkrues i shtrenjtë, a nuk e di se Allahu i Lartësuar ka urdhëruar në Librin e Tij maturi e drejtësi edhe ndaj mohuesve?

وَلَا يَجْرِمَنَّكُمْ شَنَاٰنُ قَوْمٍۭ عَلٰٓى اَلَّا تَعْدِلُوْٓا ۚ اَعْدِلُوْٓا هُوَ اَقْرَبُ
لِلتَّقْوٰى

“...ue là jexhrimen’nekum sheneànu kaumin alà el’là taëdilù iëdilù huve akrebu lit’takovà...” “...dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një grupi njerëzish e t’i shmangeni

¹¹⁷ “Tehdhijbu sejru aëlamu-n’ nubelài”, vëll. 3, f. 1202.

¹¹⁸ “El-xhevàbu-s’sahijhu limen bed’dele dijnël-Mesijh”-“Përgjigje e drejtë për atë që tjetërsoi fenë e Mesijhut”, vëll. 1, f. 22.

drejtësisë, bëhuni të drejtë, sepse ajo (drejtësia) është më afër devotshmërisë...”¹¹⁹

Atëherë, si është puna me ata që falin namaz në drejtim të Kibles dhe me ata që thonë:

“أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ”

“Esh’hedu en là ilàhe il’le-ll’llàh ue esh’hedu en’ne Muham’meden resùlu-ll’llàh” “Dëshmoj se s’ka Zot tjetër përveç Allahut dhe dëshmoj se Muahm’medi është i Dërguari i Allahut?”

¹¹⁹ Sure “El Maide”, ajeti 8.

PROPAGANDA PËR SHI'AT DHE REVOLUCIONI ISLAMIK

Artikullshkruesi kur flet për hapjen e “portave” të propagandës për medh’heibn shi’i dhe Iranin, duhet ta ketë të qartë se shi’at në Iran s’kanë nevojë për propagandë. Ata bënë Revolucionin Islamik historik, ndërtuan një shtet që i përmbysi balancat e logjikës së kohës së kaluar dhe u bënë një botë e re.

Shi’at ndërmorën aksione martirizuese dhe rezistuan me vendosmëri të palëkundur para armikut zionist në Libanin e jugut, derisa e detyruan armikun pushtues të largohet me vrap prej asaj toke islame, që ai kishte pushtuar. A ka nevojë ky fakt për propagandë?

Pastaj, ku qëndron problemi në fjalën që tha dijetari i madh, shejhu Et’teskhijrij, në mbledhjen e Asamblesë së Afrimit, në Kajro: “Qëllimi me afrimin nuk është realizimi i shkrirjes mes medh’hebeve, por zgjerimi i mirëkuptimit.” Kjo fjalë e singertë dhe ky deklaram i hapur prej këtij dijetari, shpreh qartë se qëllimi me “afrimin mes medh’hebeve” nuk është inkludimi i medh’hebeve në

njëri-tjetrin, ose përzierja e medh'hebeve. Në të vërtetë, qëllimi me "afrimin mes medh'hebeve islame" është vetëm afrimi i bazuar mbi mirëkuptimin e ndërgjegjen.¹²⁰

Unë nuk e di nëse ky artikullshkrues ka qëllim të ekspozojë fjalën e shejhut Et'teskhirij për të argumentuar se shi'at e duan "afrimin me medh'hebet e tjera", pa bërë asnjë lëshim prej medh'hebit e prej doktrineve të tyre?

Ku qëndron dëmi prej kësaj? A kanë kërkuar shi'at prej Ehli Syneetit që të bëjnë ndonjë lëshim në bazat e në doktrinat e tyre për hir të afrimit?

¹²⁰ Në ceremoninë e përvitshme, organizuar në Kajro, 1422 të Hixhreti, me rastin ditëlindjes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) morën pjesë në Asamblenë e Afrimit mes Medh'hebeve Islame: shejhu i nderuar Muahm'ed Sej'jid Tantàvij (shejhu i Ez'herit), shejhu Naser Ferijd Vàsil (myfti i trevave të Egjiptit), Dr. Mahmùd Hamdij Zakzùk (ministër i vakëfeve të Egjiptit), Dr. Ahmed Omer Hàshim (rektori i universitetit të Ez'herit), si dhe dijetarët e shquar: shejh Muham'ed Vàidh Zàdeh, shejh Muam'ed Ali Et'teskhirij, Sej'jid Hàdij Khasrùshàhij (prej Irani), shejh Mahmùd Ferhàd (drejtor i përgjithshëm i këshillit të lart shi'i në Liban), shejh Ahmed ibn Mes'ud Es'sejàbij (sekretar i përgjithshëm i zyrës së fetvave në Oman), Prof. Abdullah Muham'ed Tekijul-kamij (sekretar i përgjithshëm i "Shtëpisë së afrimit mes medh'hebeve islame", Egjipt) dhe Prof. Mahmùd Muràd. Këta dijetarë diskutuan problemet e botës islame dhe nënvizuan domosdoshmërinë e afrimit në mes medh'hebeve islame për bashkimin e myslimanëve.

Artikullshkrues i shtrenjtë, “afrimi” s’ka ndonjë qëllim të tillë. Natyrisht që është e drejta jote të thuash se ne nuk na shqetëson asnjë dyshim për vërtetësinë e medh’hebit tonë, gjithashtu është e drejta jote të dyshosh në medh’hebet e të tjerëve, madje dhe të pretendosh që shi’at dyshojnë në medh’hebin e tyre.

Prej nga erdhi artikullshkruesi me këto fjalë? Dhe si është argumenti i tij?

A nuk është kjo shpifje dhe prej fjalëve të gabuara, kur artikullshkruesi i trajton shi’at me logjikën se për atë lejohet të thotë ç’të dëshirojë?

I ngjashëm me këtë pretendim, është edhe pretendimi tjetër i tij në lidhje me Revolucionin Islamik që u bë në Iran, për të cilin artikullshkruesi thotë se ai nuk është revolucion islamik, por është thjesht revolucion persian. Patjetër që kjo është vetëm shpifje. Që Revolucioni në Iran është Revolucion Islamik, këtë e vërtetojnë ngjarjet, realiteti dhe regjimi qeverisës që u vendos në Iran pas revolucionit, si dhe përkeqësimi i gjendjes në shtetet e tjera, që pretendojnë se ngrenë lart flamurin e Islamit, siç veprojnë talebanët. Por artikullshkruesi e të ngjashmit me të, nuk guxojnë t’i kritikojnë e t’i heqin maskën dhe, për këtë mosveprim nga na e tij, shkaqet janë të njohura. Ne nuk kemi qëllim të futemi në ato shkaqe.

Në të vërtetë, artikullshkruesit i ka shpëtuar pa lexuar se shumica e burimeve të medh'hebit të Ehli Syneetit, në origjinal, janë në gjuhën perse. Artikullshkruesi duhet të dijë se transmetimet, hadithet e doktrinat, të gjitha kanë ardhur prej juristëve të ligjit të fesë islame dhe prej dijetarëve e autorëve të librave të haditheve, të cilët janë persë. Në krye të këtyre dijetarëve, autorë të librave madhorë të hadithit, janë: Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu, Ibn Maxheh, Ibn Rahujeh, En'nesaij'ji, Elxhuvejni'ji, Elgazàliu, Abdullah ibn Elmubarek, Hasan Basriu, Rebi'atu-rr'rreëji, Shejherstanij, Maturijdiu, Taus ibn Kijani, Ebu Hanijfeh, Raziu, Zemahsheriu e shumë e shumë të tjerë...

A ka te këta ndonjë të metë?

Sikur artikullshkruesi të kishte lexuar mirë historinë, ashtu siç pretendon, patjetër do ta njihte këtë të vërtetë, gjithashtu do të dinte se shi'at që ai i shpall armiq dhe flet me kaq mllef kundër tyre, medh'hebin e tyre dhe ligjin e fesë e kanë marrë prej shtëpisë më të pastër të arabëve, e kanë marrë prej shtëpisë së të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Por kjo e vërtetë do të mbetet e panjohur për artikullshkruesin, për shkak se ai punon shumë për të shkaktuar konflikte raciste, kur orvatet të hedhë hijen e dyshimit mbi Revolucionin Islamik në Iran, duke thënë se

ata që mundësuan shpërthimin e këtij revolucioni, ishin iranianë. Por artikullshkruesi bën sikur harron se arabët e grupit të Ehli Syneetit e kanë marrë medh'hebin e tyre dhe ligjin e fesë prej dijetarëve me origjinë perse, por edhe shi'at persë e kanë marrë medh'hebin e tyre prej arabëve, e kanë marrë prej pasardhësve të të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Edhe Imam Homejnij është përballur me lloje të ndryshme goditjesh prej mendjemëdhenjve në rrafsh botëror dhe jo vetëm prej sionizmit, por edhe prej disa vëllezërve të vetëquajtur "selefij", megjithëse Homejnij është me origjinë arabe Hashimite dhe rrënjët e trungut të tij gjenealogjik përfundojnë te Imam Hasani.

LUFTA DHE XHIHADI

Përsa u përket fjalëve që thotë artikullshkruesi për luftën e Irakut kundër Iranit mysliman, është e mjaftueshme të thuhet se Iraku, nën udhëheqjen e Partisë “Baëth” (Ringjallja arabe socialiste laike), e filloi luftën me qëllim pushtimin e tokave të Iranit dhe se ata që e mbështetën Irakun në atë luftë dhe që i jepnin atij bekimet, ishin perëndimorët, lindorët dhe injorantët e rinj arabë, agjentë të dy superfuqive, të Perëndimit e të Lindjes, por që ishin armiq të shi’ave e të synive. Këtë të vërtetë e dinë jo vetëm ata që jetojnë afër, por edhe ata që jetojnë larg. Megjithëkëtë artikullshkruesi merr përsipër të bëjë vlerësimin e asaj lufte, pa ditur asgjë se si ishte e vërteta e saj.

Më pas, artikullshkruesi i vazhdon shpifjet e lajthitjet e tij dhe mashtron kur pretendon se shi’at luftuan vetëm për të ruajtur tokën e për fanatizëm dhe, përsa i përket luftës në rrugën e Allahut, sipas këtij artikullshkruesi, shi’at thonë se lufta në rrugën e Allahut (xhihadi) do të shtyhet për më vonë, atëherë kur do të shfaqet Imam Mehdiu.

Në përgjigje të kësaj fjale të gabuar, mjafton të themi se juristët e ligjit të fesë islame (fukahatë) të Ehli Syneetit dhe institucionet e tyre qëndruan në një radhë të vetme përkrah Kuvajtit, që punonte me të gjitha rrugët për rikthimin e tokave të veta të pushtuara prej partisë sunduese “Baëth” të Irakut pushtues, madje pati edhe disa prej dijetarëve të Gadishullit Arabik që nxorën fetva të veçanta, me të cilat argumentonin se, për të çliruar Kuvajtin, lejohet të kërkohej ndihmë edhe prej idhujtarëve dhe, e gjitha kjo bëhej për tokën.

Nëse lufta e Hizbu-ll’llàut në Libanin e Jugut kundër armikut sionist bëhet në emër të fanatizmit dhe jo në rrugën e Allahut, si do të ishte gjykimi i këtij artikullshkruesi për kryengritjen e për luftën që zhvillohet brenda Palestinës së pushtuar me mbështetjen e myslimanëve të sinqertë? Mos vallë edhe kjo luftë bëhet në emër të tokës?

Realisht, në këndvështrimin e artikullshkruesit, lufta për të mbrojtur tokën islame është çështje fanatizmi e çështje medh’hebi si të kohës së injorancës para Islamit dhe ka për qëllim përcarjen e myslimanëve. Por kjo do të thotë se artikullshkruesi as në këtë luftë nuk e njeh pjesëmarrjen e shi’ave, pavarësisht nga sa kanë bërë e sa kanë sakrifikuar shi’at në rrugën e Allahut e në të gjithë botën.

Nëse lufta në rrugën e Allahut te shi'at do të ishte braktisur, përse shi'at luftuan në Libanin e jugut dhe përse shi'at bënë revolucionin në Iran?

Si duhet ta emërtojmë luftën që u zhvillua në Afganistan kundër rusëve pushtues? A nuk ishte ajo luftë për tokën? Në të vërtetë, dijetarët e fesë e të fushës të së drejtës islame (fukahatë) prej Ehli Syneetit dhe institucionet që ishin prapa tyre, e mbështetën dhe e bekuan atë luftë.

Ky këndvështrim i artikullshkruesit tregon qartë se ai nuk ka qenë i vëmendshëm ndaj faktit që në luftën e zhvilluar në Afganistan nuk luftuan kundër rusëve vetëm synitë, pasi në atë luftë kanë marrë pjesë edhe shi'at e Heratit.

Në përfytyrimin e artikullshkruesit lufta e zhvilluar në Afganistan nuk ishte luftë në rrugën e Allahut (xhihad), sepse e gjithë lufta u bë për të çliruar tokat.

Ku është ky artikullshkrues ndaj fjalës së të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Kush vritet për të mbrojtur pasurinë ose tokën e vet, ai është dëshmor.”?!

Artikullshkruesi ka nxjerrë rezultate dhe ka mbajtur qëndrime që nuk përputhen as me fenë, as me moralin dhe as me shkencën. Nga e di artikullshkruesi, kur shpall

hapur se shi'at, në të vërtetë, e duan unitetin për të zhdukur Islamin? Dhe pastaj me mendjemadhësi deklarën: "Bazuar mbi këtë që u tha, edhe sikur shi'at të bëjnë betimin më të madh se ata e duan unitetin për të eliminuar armiqtë e Islamit, kjo nuk do të ndodhë. Historia e tyre dihet, dihet se me kë kanë bashkëpunuar shi'at." Allahu na ruajtprej këtij fanatizmi të verbër të kohës së injorancës para Islamit.

Artikullshkruesi flet sikur ai ka në dorë të ndalojë arritjen e unitetit e afrimin mes shi'ave e synive. Atë e ka verbuar fanatizmi i vet dhe në rrugën e fanatizmit ka arritur deri aty sa të harrojë edhe fuqinë e mundësinë e tij.

Do të ishte shumë më mirë për këtë artikullshkrues sikur në artikujt që ka shkruar për të bindur të tjerët të nisej nga baza të mirëfillta shkencore dhe fjalëve të tij t'i bashkëngjiste argumente e dokumente që shpjegojnë qartë historinë e shi'ave dhe të nënvizonte dyshimet që e shqetësojnë atë. Dihet se rruga e lëshimit të fjalëve e pretendimeve të pambështetura me argumente e me dokumente, s'ka asgjë të përbashkët as me diturinë, as me të vërtetën e as me kuptimin.

PYETJE E THJESHTË

Pyetja që vjen vetvetiu këtu është: Në emrin e kujt flet ky artikullshkrues?

Nëse pretendon se flet në emër të Ehli Synetit, gënjen ditën për diell, sepse Ehli Syneti ka disa medh'hebe dhe shumica e medh'heebve të Ehli Synetit janë bashkuar nën flamurin e afrimit. Nëse ai pretendon se flet në emër të një medh'hebi të caktuar që e kundërshton afrimin dhe ka dyshim te shi'at, kjo është puna e tij. Por nuk mund të pranohet që artikullshkruesi të thotë se flet në emër të Ehli Synetit, për faktin konkret se juristët e së drejtës islame (fukahatë) e medh'hebeve të Ehli Synetit, në të gjithat trevat e botës islame, jetojnë në fqinjësi me shi'at në Irak, Azerbajxhan, në vendet e Gjirit, në Gadishullin Arabik, Indi, Pakistan, Jemen, Liban, Siri, Iran, Afganistan dhe në vende të tjera. Ata kurrë nuk e kanë thënë një fjalë të tillë, siç e thotë artikullshkruesi, i cili, në të vërtetë, përfaqëson vetëm grupin e vetëquajtur "selefij", të cilët shpallin mohues edhe Ehli Synetin, ashtu siç shpallin mohues edhe shi'at.

PËRFUNDIM I HABITSHËM

Artikullshkruesi e përfundoi serinë e parë të artikujve dhe artikullin e tij të dytë e fillon me këto fjalë: “Serinë e parë të artikujve e mbyllëm duke shpjeguar se qëllimi i shi’ave me afrimin kristalizohet në disa pika:

E para: dakortësia për një grup doktrinash të përbashkëta mes dy grupeve...

E dyta: shi’at synojnë realizimin e studimit me rrugë praktike, politike e shoqërore dhe me këto rrugë t’i japin afrimit formë konkrete...

E treta: shi’at dëshirojnë dhe këmbëngulin se duhet të mbyllen sytë para të gjitha gjërave që shkaktojnë përleshje, përçarje e konflikt...

Këtu shtrohet pyetja: Ku qëndron e habitshmja në këto qëllime të shi’ave, sipas këtij artikullshkruesi? Si është forma e dëmit që vjen prej rënies dakord në lidhje me doktrinat e përbashkëta?

Kur shi'at studiojnë rrugët për kristalizimin e afrimit dhe shprehen se duhet të lihen mënjanë shkaqet që sjellin përçarje, përleshje e konflikt, a e justifikon ky qëndrim i shi'ave sulmin mbi doktrinat e shi'ave, ngjalljen e dyshimeve te ata që janë rreth shi'ave dhe përhapjen e gënjeshtreve kundër tyre?!

Realisht, artikullshkruesi, me këto fjalë, dënon veten e tij dhe duket qartë se ndjenjat e tij vuajnë nga anomalia. Janë pikërisht këto ndjenja që e kanë çuar atë të shpërthejë në këtë fanatizëm të verbër, ashtu siç ndodhi edhe me shembullin e ministrit Ibn El-Alkamij dhe vrasjen e halifit të fundit të abacive, Mustaësimit, me dorën e luftëtarëve tatarë. Gjithashtu, artikullshkruesi nuk ngurron të përsërisë edhe shpifjet që thuhet në disa burime të dyshimta se shi'at kanë komplotuar me kryqtarët kundër myslimanëve.

Derisa ky artikullshkrues ka adaptuar rrugën e armiqësisë dhe të vajtjes pas të tjerëve, ai kapërdin edhe çështjen El-Alkamijit dhe dyshime të tjera që kanë përhapur armiqtë e shi'ave, përfshirë edhe orientalistët prej jehudive, pa i vënë detyrë vetes të marrë mundimin e të studiojë burimet e ndryshme historike, në të cilat të gjejë origjinën e dyshimeve të përhapura dhe motivet e këtyre dyshimeve. Nëse me të vërtetë ai ka qëllim punën për hir

të Allahut, kjo është më e pakta që kërkon prej këtij artikullshkruesi drejtësia e maturia.

Në përgjigje kundër dyshimit të bashkëpunimit të Ibn El-Alkamij me tatarët dhe qëllimit të tij për të ndërtuar një shtet alevian mbi gërmadhat e shtetit të hilafetit të abasive, është e mjaftueshme të nënvizojnë faktin e njohur se, kur Hulaku hyri në Bagdad, nuk bëri asnjë dallim mes synive e shi'ave, por e konsideroi të lejuar të vriteshin e t'i merrej pasuria të gjithëve, duke përjashtuar prej këtij lejimi vetëm kristianët. Nga një anë tjetër, historia tregon se tatarët e kishin kërcënuar Bagdadin para se Mustaësimi të dorëzonte hilafetin. Më të vërtetë, Mustaësimi u dorëzua për shkak se ushtria e shtetit të hilafetit ishte e dobët, s'kishte fuqi të sprapste rrezikun e tatarëve dhe para kohës kur Ibn El-Alkamij mori postin e ministrit.

Ibn Xheuzij'jeh për Ibn El-Alkamij ka thënë: "Ishte burrë i virtytshëm, burrë i mirë e i turpshëm, ishte lexues i Kur'anit..."¹²¹

¹²¹ Lexo: "Mir'ātu-z' zemàn"- "Pasqyra e kohës", vëll. 8, f. 747, Pjesa e shtatë; Elkhazrexhij, "Elmexhdul-mesbùk" - "Lavdia e derdhur në kallëp", vëll. 2, f. 194; "Tabekātu-sh'shâfi'ij'j" - "Shtresat e medh'hebit Shafifi'j", vëll. 5, f. 110 dhe "Et'tàriykh", autori Ibn Et'taktakij, f. 337 e më pas.

Edhe Ibn Kethiri në “Historinë” e tij, pasi akuzon Ibn El-Alkamij, thotë: “Kalifi Mustaësim mban përgjegjësi për rënien e Bagdadit, sepse nuk i kushtoi rëndësi këshillave të ministrit El-Alkamij.”¹²²

¹²² Ibn Kethijr, “Et’ tãriykh” - “Historia”, vëll. 8, f. 200.

DOKTRINAT E SHI'AVE

Artikullshkruesi pretendon që shi'at besojnë se Mehdiu është i mbyllur në një bodrum të nëndheshëm. Gjithashtu, ai pretendon se shi'at luten me shprehjen: "Allahu e shpejtoftë daljen e tij!", sepse ai është i mbyllur në një bodrum nën tokë. Për më tepër, artikullshkruesi thotë se shi'at janë në pritje të Mehdiut, që të luftojnë Ehli Synetin.

Në të vërtetë, kjo fjalë është çmenduri në kokë e përçartje në shpirt. Në këtë fjalë s'ka asgjë nga e vërteta dhe kjo shpifje e artikullshkruesit s'ka asnjë gjurmë në çdo burim të shi'ave. Por artikullshkruesi edhe me këtë shpifje përsërit fjalët e armiqve, citon prej atyre dhe asgjë më shumë. Doktrina e shi'ave, në lidhje me shfaqjen e Mehdiut në fundin e kohës, në origjinë është e njëjtë me doktrinën e Ehli Synetit. Hadithet e ardhura me varg të pashkëputur përcjellësish gjenden në librat e të dyja grupimeve.¹²³

¹²³ Shiko librin: "Akijdetu Ehli-s'sun'neti uel-etheru fijl-Mehdij Elmuntedhar"- "Doktrina e Ehli Synetit në lidhje me Mehdiun e pritshëm", autori shejhu Abdulmuhsin Abadij, zv/rektor i universitetit islam në Medinën e ndritur, shtypur në shtypshkronjën

Ndërsa çështjet: Cili është Mehdiu? Kur do të ndodhë shfaqja e tij?, janë çështje dytësore. Për rrjedhojë, diskutimi rreth këtyre çështjeve nuk është domosdoshmëri, përderisa ndajmë një fjalë të përbashkët në lidhje me origjinën e subjektit.

Nuk mund të kërkohet prej shi'ave që doktrinat e tyre të përputhen në të gjitha gjërat me doktrinat e Ehli Syneetit, por edhe kundërta është e drejtë. Çdo medh'heb ka komponentët, parimet e burimet e veta mbi të cilat ai mbështetet.

Më pas, artikullshkruesi thotë: "Në të vërtetë, kundërshtimi mes nesh e mes shi'ave është për bazat e fesë dhe për këtë s'ka asnjë dyshim." Edhe me këtë shprehje ai gënjen sheshit, sepse bazat e fesë janë të njohura e të përhapura në të gjitha medh'hebet islame. Përveç kësaj, në lidhje me bazat, s'ka asnjë kundërshtim dhe vetëkuptohet që edhe shi'at nuk mund të jenë besimtarë myslimanë pa këto baza të njohura prej të gjithëve.

Këto fjalë të parregullta, nga ana e artikullshkruesit, në fakt dënojnë vetë të vetëquajturit selefij. Me këto fjalë ai

"Err'rreshijd", në Medine, në vitin 1402 të Hixhretit; lexo edhe librin e dytë me titull: "Err'rrd' du alà men kedh'dhebe bil-ehàdijthi-s'sahijhatil-vàrideti fil-Mehdij"-Përgjigje për atë që përgënjeshtrohet hadithet e gradës "Sahijh" që kanë ardhur për Mehdiun".

tregon sikur të vetëquajturit selefij kanë baza ndryshe prej bazave të medh'hebeve të tjera dhe sikur mbi bazat e tyre është ngritur ekzistenca e një feje tjetër, ndryshe prej fesë që kanë medh'hebet e tjera islame. Është e qartë se për këtë fjalë s'ka justifikues tjetër përveç faktit se artikullshkruesi beson se Islam ka vetëm te të vetëquajturit selefij dhe se vetëm ata e përfaqësojnë Islamin. Pikërisht kjo na çon në rezultatin e sipërm. Nëse artikullshkruesi, me të vërtetë do të ishte prej dijetarëve të devotshëm, që thonë të vërtetën dhe prej burrave të drejtë, ai duhet patjetër të bënte dallimin mes bazave e degëve, mes teksteve e ixhtihadit (arritja e së drejtës për të arsyetuar në mënyrë të pavarur mbi statusin juridiko-fetar të disa problemeve) dhe pastaj, bazuar mbi degët e mbi arsyetimin e pavarur juridiko-fetar, le të adaptojë qëndrimin ndaj shi'ave. Këtë parregullsi të artikullshkruesit ne e shohim qartë kur ai thotë: "Në të vërtetë, kundërshtimi mes nesh e mes shi'ave është për bazat e fesë dhe për këtë s'ka asnjë dyshim."

Me këtë frazë ai thotë se shi'at mohojnë cilësitë e Allahut të Lartësuar, nuk besojnë se njerëzit do të shohin Allahun e Lartësuar në Botën Tjetër. Shi'at besojnë në pagabueshmërinë e Imamëve, besojnë se imamët kanë kompetencë strukturale në grimcat e gjithësisë dhe se Imamët kanë një pozitë më të lartë se Profetët. Gjithashtu, ai thotë se shi'at e urrejnë Xhibrilin ashtu siç e urrejnë atë jehuditët dhe se shi'at nuk besojnë as në dy "Sahihët" (në

“Sahihun” e Buhariut e në “Sahihun” e Muslimit) e as në ndonjë libër prej librave të Ehli Syneetit.”

Më poshtë, për secilën prej këtyre punëve, do të flasim shkurtimisht, me qëllim që për ne të bëhet e qartë sa larg shkon neglizhenca e mosnjohja e të vërtetave të ky artikullshkrues, sa shumë i është dorëzuar ai mendësisë së kohës së kaluar dhe deri ku arrin mosnjohja që ai ka për doktrinat e për burimet e shi’ave.

Përsa i përket fjalës së artikullshkruesit që shi’at mohojnë cilësitë e Allahut të Gjithëfuqishëm, padyshim që kjo fjalë është krejtësisht e gabuar. Dihet se lëshimi i akuzave prej disave kundër të tjerëve për shkak se ata kanë adaptuar një pikëpamje ndryshe nga pikëpamja e tyre për cilësitë e Allahut, ka qenë dhe është një e akuzë e përhershme.

Pikëpamja e shi’ave për cilësitë e Allahut, në mënyrë të përmbledhur, është si vijon: Për Allahun e Lartësuar s’ka vend të veçantë, ashtu siç besojnë disa se Allahu është në qiell. Shi’at thonë se nuk është e mundur që Allahu të shihet me sy, sepse kjo është prej gjërave të pamundura. Këtë pamundësi e lexojmë në fjalën e të Lartit:

لَا تُدْرِكُهُ الْأَبْصَارُ وَهُوَ يُدْرِكُ الْأَبْصَارَ وَهُوَ اللَّطِيفُ الْخَبِيرُ

*“La tudrikukul-ebşaru ue huve judrikul-ebşare ue huve-
l’letijful-khabijru”*

**“Atë (Allahun) nuk e shohin sytë, kurse Ai i përfshinë
sytë, Ai është i Buti, Njohësi i çdo hollësie.”¹²⁴**

Shi’at besojnë se cilësitë e Allahut, si: dituria, fuqia, përhershmëria e të tjera cilësi të ngjashme, janë të mbledhura në vetë Qenien e Allahut të Lartësuar. Gjithashtu, shi’at besojnë se cilësitë e Allahut nuk janë si cilësitë e krijesave që janë të pavarura njëra prej tjetrës dhe të ndara prej qenies së krijesave. Kjo pikëpamje është në kundërshtim me pikëpamjen e disa vëllezërve tanë prej Ehli Syneetit.

Rezultati i luftërave dhe i përplasjeve ideore e doktrinare që kanë ndodhur mes disave prej vëllezërve tanë e mes armiqve të tyre gjatë kohës së sundimit të abacive, që përkon me kohën e daljes së medh’hebit e të doktrinave të tyre, ishte një kundërpërgjigje e ashpër nga ana e tyre ndaj armiqve e kundërshtarëve të tyre, prandaj ata gjykuan, për shembull, se është mohues ai që thotë se

¹²⁴ Sure “En’am”, ajeti 103.

Kur’ani është i krijuar dhe se kjo është doktrinë e shi’ave dhe e muëtezileve.

Gjithashtu, ata interpretojnë cilësitë e Allahut si metaforë, pa u mbështetur në transmetimet që flasin për cilësitë e Allahut të Lartësuar. Kushdo që i kundërshtonte ata në doktrinat e tyre për këto çështje, ata i konsideruan mohues të cilësive të Allahut të Lartësuar dhe, sipas thënies së tyre, ndër këta kundërshtues janë edhe shi’at.

Përsa i përket çështjes se Imamët e Ehli Bejtit janë të pagabueshëm, shi’at besojnë në pagabueshmërinë e dymbëdhjetë Imamëve. Këtë besim për Imamët e tyre shi’at e mbështesin në argumente të shumta prej Librit dhe prej hadithit. Në krye të këtyre argumenteve patjetër qëndron fjala e Allahut të Lartësuar, që e lexojmë në suren “El Ahzab”:

إِنَّمَا يُرِيدُ اللَّهُ لِيُذْهِبَ عَنْكُمُ الرِّجْسَ أَهْلَ الْبَيْتِ وَيُطَهِّرَكُمْ تَطْهِيرًا ﴿٣٣﴾

“...in’nemà jurijdu-ll’llàhu lijedh’hibe ankumu-rr’rixhze ehlel-bejti ue jutah’hirekum tathijren” “...në të vërtetë, Allahu ka

qëllim të largojë ndyrësirën prej jush, njerëzve të shtëpisë (së Profetit) dhe t’u pastrojë ju plotësisht.”¹²⁵

Si dhe fjala e të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Unë jam njeri dhe pres të më vijë i ngarkuari i Zotit tim, që unë të përgjigjem. Unë kam lënë te ju dy gjëra me peshë të rëndë: e para është Libri i Allahut, në të cilin ka udhëzim në rrugën e drejtë dhe dritë, prandaj merreni Librin e Allahut dhe kapuni mirë pas tij.” Dhe, pasi nxiti për Librin e Allahut, që të kishin dëshirë për të, tha: “Kam lënë edhe njerëzit e familjes sime. Ju kujtoj Allahun në të drejtën e familjes sime, ju kujtoj Allahun në të drejtën e familjes sime, ju kujtoj Allahun në të drejtën e familjes sime.”¹²⁶

Derisa doktrina është në kuadrin e tekstit, nuk lejohet që rreth asaj doktrine të ngjallen dyshime, edhe pse disa mund të kenë një këndvështrim të kundërt për këto dy tekste. Gjithsesi, ky kundërshtim është thjesht çështje hulumtimi nga ana e tyre.

* * *

Gjithashtu, artikullshkruesi, kur flet për imamët thotë se shi’at e urrejnë Xhibrilin (*Paqja e shpëtimiti i Allahut*

¹²⁵ Sure “El Ahzab”, ajeti 33.

¹²⁶ “Sahiju” i Muslimit, vëll. 4, f. 1873, prej librit “Virtytet e sahabëve”, K. “Virtytet e Ali ibn Ebu Talibit”, Paragrafi 36, nr. 2408.

qoftë për të!). Ashtu siç u tha edhe më sipër, kjo është një fjalë krejtësisht e gabuar, që tregon se artikullshkruesi nuk i ka lexuar burimet e shi'ave. Gjithashtu, kjo fjalë e tij tregon se këto akuza ai i ka marrë prej librave të armiqve të kohës së kaluar.

Ndër burimet e shi'ave, në lidhje me fushën e doktrinave, nuk gjendet as edhe një burim i vetëm, ku të thuhet për hyjnizimin e Imamëve të Ehli Bejtit, ose për urrejtje ndaj Xhibrilit. Por armiqtë gjithmonë gjurmojnë në transmetimet e shpërndara nëpër disa libra dhe pastaj i interpretojnë ato sipas rrugës që u intereson atyre. Gjithashtu, ata thonë se jo gjithçka që tregohet në librat e shi'ave është e vërtetë, në një kohë kur ka një rregull që vendos saktësinë e transmetimeve të ardhura prej Imamëve të Ehli Bejtit. Rregulli, në mënyrë të prerë, thotë: Transmetimi që nuk përputhet me Kur'anin dhe me logjikën, hidhet poshtë.

* * *

Përsa i përket thënies së artikullshkruesit se shi'at nuk besojnë në "Sahihun" e Buhariut, në "Sahihun" e Muslimit e në librat e "Suneneve", nuk do të thotë mohim i Syneetit, ose kundërshtim i burimeve të Ehli Syneetit, pasi edhe shi'at kanë librat e tyre të haditheve, të cilat vazhdimisht i nënshtrohen shoshitjes, prandaj nuk është e logjikshme që Ehli Syneti të kërkojë prej shi'ave që të

besojnë në transmetimet e tyre. Gjithashtu, edhe shi'at, si bazë, nuk kërkojnë prej Ehli Synetit që të besojnë në transmetimet e shi'ave.

Ehli Syneti e trajton hadithin me disa rrugë, por edhe shi'at e trajtojnë hadithin me rrugë të tjera. Pikërisht këtu ka dalë kundërshtimi për hadithet, për faktin se hadithe të Ehli Synetit nuk gjenden te shi'at. Po kështu, hadithe të shi'ave nuk gjenden te Ehli Syneti. Por kjo nuk e ndalon që në shumë hadithe të gjenden të përbashkëta te të dyja grupimet,¹²⁷ siç është për shembull hadithi që u përmend më lart për Librin dhe për njerëzit e familjes Profetike.

¹²⁷ Qendra shkencore pranë kompleksit botëror për afrimin mes medh'hebeve islame, në kuadrin e botimit të një serie të gjatë librash, ka botuar edhe libra ku përmenden hadithe që janë të përbashkëta në të dyja grupimet, në të gjitha fushat: në kapitujt e së drejtës islame (fik'hut), adhurimet, shkëmbimet e ndërsjella, historinë, librat e jetëshkrimit të personaliteteve dhe në lidhje me shkencat kur'anore e të hadithit. Në kuadrin e kësaj serie të artë janë botuar libra të veçantë për namazin, agjërimin, faljen e namazit të Xhumasë, luftën në rrugën e Allahut, ndalimin e punës së keqe dhe urdhërimin e punës së mirë, zekatin, lutjen, hadithin kudsij, libra me ajete të Kur'anit e hadithe që flasin për ekonominë, libra me hadithe që trajtojnë moralin, hadithe që kanë ardhur për Ehli Bejtin e libra të tjerë. E gjitha kjo thekson fuqishëm praninë e të përbashkëtave të shumta e të llojeve të ndryshme mes shi'ave dhe Ehli Synetit, çka dëshmon për unitetin e bazave dhe pastërtinë e burimit ku janë marrë.

Gjithsesi, kundërshtimi për hadithet dhe dhënia e gjykimit rreth haditheve, nuk është në kundërshtim me bazat e fesë, pasi vetëm kundërshtimi i Kur'anit sjell përplasje në bazat e fesë.

Kur artikullshkruesi ynë thotë se besimi në cilësitë e Allahut sipas medh'hebit të Ehli Synetit dhe se besimi për shikimin e Allahut me sy është prej bazave, se besimi në librat e Buhariut, Muslimit dhe në librat e tjerë të hadithe të Ehli Synetit është prej bazave, kjo është vetë injoranca. Në këto fjalë të artikullshkruesit s'ka asgjë nga e vërteta, gjithashtu s'ka asgjë nga e vërteta, as pretendimi i tij se vetëm ai është brenda kufirit të fesë. Në të vërtetë, brenda kufirit të medh'hebit të Ehli Synetit janë edhe ata myslimanë për të cilët artikullshkruesi s'ka dijeni për qëndrimin e tyre të qartë, kur shpallin mohues kundërshtarit dhe, është e qartë se ky është qëndrim refuzues.

Ibn Tejmijeh ka thënë: "Prej stisjeve të urryera është shpallja mohues e grupeve të myslimanëve dhe lejimi që ata të vriten e t'u merret pasuria."¹²⁸

* * *

¹²⁸ "Mexhmû'ul-fetavâ" - "Tubë fetash", vëll. 7, f. 684.

Përsa i përket fillimit, kjo nuk është në kuptimin që t'i tregohet Allahut të Lartësuar një punë për të cilën Ai s'kishte dijeni. Padyshim që kjo thënie e artikullshkruesit është injoranca më e shëmtuar e mohim kategorik. Kjo shprehje e tij do të thotë se Allahu s'ka dituri, se Allahu kalon nëpër ngjarje e pëson ndryshime dhe, ajo që ka cituar artikullshkruesi prej librit Elkamij'jit nuk është e vërtetë, sepse artikullshkruesi nuk ka dijeni fare për librin e Elkamij'jit, por ka cituar fjalët e një armiku, i cili në të vërtetë i ka tjetërsuar fjalët e tij.

* * *

Edhe shpifja tjetër e artikullshkruesit që shi'at kanë revizionuar Kur'anin është thjesht rrenë. Shi'at s'kanë Kur'an tjetër përveç Kur'anit që është në dorën e të gjithë myslimanëve dhe, përsa i përket faktit që disa prej armiqve kanë cituar prej disa librave të shi'ave, në lidhje me Kur'anin, ato janë fjalë të marra në kundërshtim me qëllimin e autorit të librit. Por edhe nëse atje ka ndonjë transmetim të shkallës "*daijf*"-"*dobët*", dijetarët e shi'ave nuk punojnë sipas këtij transmetimi. Përveç kësaj, transmetime të tilla, që kanë lidhje me Kur'anin dhe njoftojnë se Kur'ani ishte më shumë ose është pakësuar, janë të shumta edhe në librat e Ehli Syneetit, kur flasin për sure që më parë janë lexuar e pastaj janë hequr e u ruajtën dhe më pas u fshejhën, ose u ngritën, siç thuhet për

shembull, në lidhje me ajetin e rexhmit (ekzekutimit me gjuajtje me gur) dhe me ajetin e mëkimit të fëmijës me gji.

Për më shumë shpjegime për këto çështje, shiko librin “El-itkàn”, librat e historisë, shiko librin “Fet’hul-Bàrij”,¹²⁹ “Sahihun” e Muslimit, lexo librin “Zekati”, K. “Sikur njeriu të kishte dy lugina, do të dëshironte të kishte edhe një të tretë”, lexo edhe librat e Taberaniut, Bejhekiut dhe “Musnedin” e Ahmedit.

* * *

Edhe akuza tjetër e artikullshkruesit për qëndrimin e shi’ave ndaj sahabëve, theksojmë se qëndrimi ndaj sahabëve nuk përbën mohim, ashtu siç deklaroi artikullshkruesi. Shi’at kurrë nuk thonë për sahabët e Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) se ata janë mohues. Por shi’at mbajnë qëndrim ndaj disa sahabëve. Gjithashtu, është e vërtetë që shi’at kanë transmetuar vetëm prej disa sahabëve, kanë transmetuar vetëm prej atyre, për të cilët ata mendojnë se ishin të përkushtuar në shoqërimin e të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe vetëm prej atyre që ishin më të vendosur për të ecur në rrugën e tij. Këto qëndrime shi’at i kanë mbështetur me tekste të shumta, të nxjerra prej ajeteve të

¹²⁹ “Fethul-Bàrij”, Komenti i “Sahihut” të Buhariut.

Kur'anit dhe prej librave të hadithe të Ehli Syneetit. Këtu s'është vendi të përmenden.

Lexo librin “Aslu-sh’shi’ati ue usùluhà” - “Origjina e shi’ave dhe bazat e tyre”, të autorit, shejhut Kàshiful-Gitài, botuar në Kajro prej shtëpisë botuese “Dàru-n’nexhàhi” - “Shtëpia e suksesit”, lexo edhe librin me titull “Meàlimul-medresetejni” - “Shenjat dalluese të dy shkollave” e autorit Murtedà El-askerij, botuar në Bejrut, si dhe libra të tjerë të shi’ave që janë në treg.

RUAJTJA DHE MARTESA ME KOHË TË CAKTUAR

Akuzë tjetër që artikullshkruesi hedh mbi shi'at është “ruajtja”, e cila, në mënyrë të përmbledhur, konsiston në zbatimin e parimit të sekretit për fshehjen e doktrinave përballë valëve të dhunës e të prangosjes me të cilat janë përballur shi'at gjatë shekujve të kaluar, siç ishin shekujt e sundimit të emeviteve e të abasiteve. Në të vërtetë, parimi i ruajtjes është parim i natyrshëm, është parim për të cilin nxit vetë Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nëpërmjet fjalës së të Lartit:

“...il’là en tet’tekù minhum tukàten...” إِلَّا أَنْ تَتَّقُوا مِنْهُمْ تُقَنَّةً

“...përveçse kur qëllimi është për t’u ruajtur prej të keqes së tyre...”¹³⁰ dhe fjala tjetër e Allahut të Lartësuar:

إِلَّا مَنْ أَكْرَهَ وَقَلْبُهُ مُطْمَئِنٌّ بِالْإِيمَانِ

¹³⁰ Sure “Ali Imran”, ajeti 28.

“...il’lâ men ukrihe ue kalbuhù mut,ein’nun bil-imjàni...”
“...me përjashtim të atij që imponohet (të mohojë), por zemra e tij është e bindur plotësisht në besimin...”¹³¹

Me ruajtjen nuk është qëllim fshejha e doktrineve ideore dhe shfaqja e Islamit, ashtu siç pandeh artikullshkruesi e të ngjashmit me këtë prej armiqve të shi’ave.

Pas Revolucionit Islamik në Iran, Imam Humejnij nxori fetvanë e tij në lidhje me përfundimin e kohës së ruajtjes dhe shpjegoi se ruajtja nuk është më e nevojshme në kohën tonë të hapur, në të cilën çdo njeri e ka shumë të vështirë të mbajë të fshejtë doktrinën që ai ndjek. Sot shi’at nuk i vret askush për shkak se deklarojnë se ata janë dashamirës të Ehli Bejt, kurse ajo që ndodhi me shi’at në Irak, me dorën e tiranit Sadam Husejn dhe ajo që ndodh tani në Pakistan me shi’at, është vetëm një qëndrim anormal, që nuk e bën detyrim ruajtjen.

Shumë prej ndjekësve të Ehli Syneetit kanë adaptuar pikëpamjet e doktrinat e veta në lidhje me çështjen e ruajtjes dhe, kjo bëhet shumë e qartë për cilindo që lexon librat e burimet e tyre të mbështetura në argumente.


* * *

¹³¹ Sure “En Nahl”, ajeti 106.

Edhe për martesën me kohë të caktuar, i gjithë ymeti islam me medh'hebet e veta të ndryshme ndajnë një fjalë të përbashkët për ligjshmërinë e kësaj martese. Madje e kanë konsideruar prej domosdoshmërive të vërtetuara prej Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në lidhje me martesën me kohë të caktuar, myslimanët padyshim ndajnë një fjalë të përbashkët se kundërshtimi në mesin e juristëve të së drejtës islame (fukahave) për martesën me kohë të caktuar është përqendruar nëse kjo dispozitë vazhdon të jetë vepruese, apo është anuluar.

Shi'at besojnë se dispozita ligjore për martesën me kohë të caktuar nuk është anuluar, se argumentet për këtë janë dhe punohet sipas këtyre argumenteve. Në lidhje me këtë çështje mund të lexoni librat e fik'hut që kanë në përdorim shi'at.

Është pa kuptim thënia e Ehli Syneetit se kjo lloj martese është e ndaluar në mënyrë të prerë (është haram) dhe se të tjerët janë të detyruar të ndjekin mendimin e tyre, që kjo lloj martese është e ndaluar rreptësisht. Në të vërtetë, secila prej dy palëve ka rrugën e pavarur të studimit të vet, në lidhje me statusin juridiko-fetar të këtij problemi. Për studiuesin që ka arritur të drejtën, ka dy shpërblime dhe për studiuesin që nuk ka arritur të drejtën, ka vetëm një shpërblim.



* * *

Përsa i përket “kthimit”, nuk është prej çështjeve që kanë të bëjnë me besimin. Prandaj nuk është problem që të gjithë shi’at duhet të ndajnë një fjalë të përbashkët për këtë çështje. Në të vërtetë, për këtë çështje janë shprehur disa që janë mbështetur në një numër hadithesh. Gjithsesi, çështja e kthimit të shi’at nuk është prej bazave të besimit dhe, për të njohur të vërtetën e kësaj pune, mund të lexoni në librat e besimit që qarkullojnë në mesin e shi’ave.

NJË KËSHILLË VËLLAZËRORE

Në fund i themi artikullshkruesit: Këto ishin doktrinat tona, të cilat ne po i shpallim qartë e hapur dhe për të cilat shumë shpejt do të takohemi me Allahun e Lartësuar. Nëse artikullshkruesit nuk i mungon morali e maturia, do të ishte më mirë për atë të lexojë rreth doktrinave të shi'ave në vetë burimet e njohura e të bazuara mbi argumente që janë të shi'at dhe të mos marrë prej burimeve e prej librave të armiqve e prej orientalistëve jehudi e kristianë, që rrinë vazhdimisht në përgjim kundër nesh, të gjithëve.

Nëse artikullshkruesi i përmbahet fjalës së Malikut: “Suneti është si varka e Nuhut. Kush hip në të, ka shpëtuar dhe kush nuk hip në të, mbytet.” Edhe ne i përmbahemi fjalës së të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Shembulli i Ehli Bejtit tim është si shembulli i varkës së Nuhut. Kush hipi në të, shpëtoi dhe kush nuk hipi, u mbyt.” Këtë hadith e kanë cituar dhe e kanë transmetuar me disa rrugë dijetarët dhe autorët e librave të hadithit më të dëgjuar prej Ehli Syneetit.

Shiko librat e “Suneneve”, lexo “Khasàisu emijril-muëminijne Ali ibn Ebù Tàlib”-“Veçoritë e Prijësit të besimtarëve, Ali ibn Ebu Tàlib) e autorit En’nsàij, botuar në Kajro.

Përsa i përket termit “një rresht”, që artikullshkruesi e hedh si akuzë kundër shi’ave, është pjellë e fantazisë së tij, sepse “një rresht” mund të ketë vetëm atëherë kur myslimanët, syni e shi’a, të shkrihen në kallëpin e vetëquajturve “selefij”, për të cilët artikullshkruesi beson se vetëm ata të jenë përfaqësues të myslimanëve. Por kjo do të thotë ngurtësim kategorik i mendjeve të ymetit dhe i së drejtës për të arsyetuar në mënyrë të pavarur mbi statusin juridiko-fetar të problemeve që ka ymeti.

Por Islami mbështet lirinë e mendjes, lirinë e mendimit dhe lirinë e së drejtës për të arsyetuar në mënyrë të pavarur mbi statusin juridiko-fetar të problemeve, prandaj do të vazhdojë të ketë mendime ndryshe, por që janë të gjykuara të jenë në kuadrin e Islamit dhe janë në përputhje me Librin e Allahut dhe në hadithet e gradës “sahijh”-“të vërteta”. Është prej aksiomave të Islamit që as Libri i Allahut e as fjalët e praktika e të Dërguarit nuk janë pronë vetëm për njërin medh’heb dhe nuk janë për një medh’heb tjetër. Libri i Allahut, fjalët e praktika e të Dërguarit nuk janë monopol i ndonjë njeriu.

Kjo është baza mbi të cilën shi'at u bëjnë thirrje myslimanëve për unitet e për afrim dhe jo mbi bazën e kontradiktave që gjenden mes medh'hebeve, mendimeve e doktrinave. Gjithashtu, shi'at nuk bëjnë thirrje të hiqet dorë prej medh'hebeve e prej doktrinave përkatëse, por kërkojnë vetëm bashkimin e myslimanëve për çështje rreth të cilave ndajnë një mendim të përbashkët. Gjithashtu, shi'at bëjnë thirrje që myslimanët t'i kërkojnë ndjesë njëri-tjetrit për çështjet rreth të cilave kanë kundërshtime dhe të gjithë të kapen fuqishëm pas litarit të Allahut.

NË LIDHJE ME ARTIKULLIN E TRETË

Ato që përmendëm më sipër janë të mjaftueshme si kundërpërgjigje edhe ndaj gjërave që pretendon shkruesi i artikullit tjetër, botuar në një numër tjetër të revistës, me ngjyrën e të vetëquajturve “selefij”. Është fjala gjithnjë për revistën “Et’teuhjd”, në të cilën u botua artikulli me titull “Grupe për të cilat kanë paralajmëruar dijetarët”. Falënderimi i takon vetëm Allahut, që autori i këtij artikulli thotë: “Kanë paralajmëruar dijetarët...” dhe nuk thotë: “Ka paralajmëruar Islami...” Natyrisht që dijetarët për të cilët flet autori i artikullit janë prej grupit të vetëquajturve “selefij”. Vetëkuptohet që këta dijetarë flasin me gjuhën e grupit të tyre dhe mbajnë qëndrime në përputhje me doktrinat e tyre dhe, dihet se ata shpallin mohues jo vetëm shí’at, por edhe Ehli Synetin. Këtë fakt e shikojmë në librat e tyre.

Por, edhe ne kemi të drejtë të flasim me gjuhën e medh’hebit tonë dhe të mbajmë qëndrime që janë në përputhje me doktrinat tona, gjithashtu edhe ne kemi të drejtë të paralajmërojmë ruajtje prej akuzave që kanë lëshuar kundër nesh grupet e rëna në rrugën e humbjes e të devijuara prej rrugës së drejtë, historianët e mbretërve,

agjentët e sundimtarëve tiranë dhe fukahatë e mbretërve... Natyrisht që shi'at janë krejtësisht të pastër prej akuzave të hedhura mbi ata dhe s'mbajnë asnjë përgjegjësi ndaj atyre që i lëshojnë këto akuza.

Tregimi i "Mus'hafit të Fatimes", për të cilin flet me aq vrull autori i artikullit, ashtu siç kanë folur gjithmonë armiqtë me vrull për këtë "Mus'haf të Fatimes", që prej kohëve të kaluara e deri në ditët e sotme. Kjo në mënyrë absolute s'ka asgjë të përbashkët me të vërtetën dhe ajo që gjendet prej Fatime Zehrasë është një tubë me lutje të veçanta e meditime. Gjithashtu, te shi'at ka edhe libra të tjerë prej Imamëve dhe që njerëzit duan e i quajnë "Mus'hafet e Imamëve". Gjithsesi, të gjitha këto libra, në mënyrë absolute, s'kanë asnjë lidhje me Kur'anin Famëlartë.

Shi'at besojnë se Allahu i Lartësuar e ka marrë detyrim mbi veten e Tij ruajtjen e Kur'anit Famëlartë prej devijimeve, reformimeve e prej ndërrimit të fjalëve. Këtë të vërtetë e lexojmë në fjalën e Allahut të Lartësuar:

إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ

"in'nà nahnu nez'zelne-dh'dhikre ue in'nà lehù lehàfidhùne"

"Ne e shpallëm Kur'anin dhe Ne patjetër do ta ruajmë atë."¹³²

¹³² Sure "El Hixhr", ajeti 9.

Mbështetja në fjalët e gabuara e në fjalët jonormale që gjenden në trashëgiminë e shi'ave e të sunive, ose në fjalët e orientalistëve në lidhje me pikëpamjen e shi'ave rreth Kur'anit, s'kanë asgjë nga e drejta dhe maturia, nuk përbëjnë as argument dhe janë e kundërta e studimit të mirëfilltë shkencor. Më sipër kemi nënvizuar se edhe te Ehli Syneti ka shumë fjalë e thënie të gabuara jonormale, ka thënie e fjalë të habitshme, me të cilat janë të tejmbushura librat e "Suneneve", librat e grupeve dhe librat e fik'hut. Por shi'at këto thënie kurrë nuk i marrin si argument kundër Ehli Synetit. Në të vërtetë, shi'at marrin për argument prej Ehli Synetit vetëm tekstet e tyre të vërtetuara për saktësinë, siç janë hadithet e transmetuara në dy sahihët, në "Sahijhun" e Buhariut dhe në "Sahijhun" e Muslimit.

Një punë e tillë, si ajo për të cilën flet artikullshkruesi, është në përputhje të plotë me mendimet e Ibn Sebes. Këto mendime orvaten t'ua ngjisin shi'ave, në një kohë që Ibn Sebe, në këndvështrimin e shi'ave është pjellë e fantazisë dhe legjendë e stisur prej përcjellësve të njoftimeve armiq të shi'ave. Nëse në disa libra gjen diçka të këtillë. Ato libra janë prej librave të kategorisë "daijf"- "dobët", janë të mbushura me mite, me fantazi e me hadithe të vëna, që qarkullojnë në mesin e myslimanëve syni e shi'i. Por këto hadithe të vëna e të stisura, dijetarët i kanë parë me syrin e diagnostikuesit e të studiuesit dhe

janë shprehur qartë për vërtetësinë e kësaj kategorie hadithesh.

Lutja jonë e fundit është:

أَنْ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

“enil-hamdu lil'lâhi rab'âlemijn”

“Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve!”

Përmbajtja

FJALA E QENDRËS.....	5
PARATHËNIA E AUTORIT.....	16
AFRIMI DHE UNITETI.....	21
CILI ËSHTË QËLLIMI I AFRIMIT TË MEDH'HEBEVE?.....	30
SHERIATI DHE THIRRJA PËR UNITET.....	32
UNITETI ËSHTË DOMOSDOSHMËRI NJERËZORE.....	35
KY LIBËR.....	41
KAPITULLI I PARË.....	45
KUSH ËSHTË ABDULLAH IBN SEBE?.....	49
TREGIMI RRETH ISLAMIT TË TIJ.....	51
Ç'THUHET PËR DOKTRINAT E IBN SEBES DHE PËR AKTIVTETIN E TIJ?.....	57
RRËNJËT HISTORIKE TË LEGJENDËS IBN SEBE.....	69
PIKËPAMJET E STUDIUESIT ES'SEJ'JID MURTEDA EL- ASKERIJ.....	69
TABERIJË DHE KU ËSHTË MBËSHTETUR AI.....	71
CILI ËSHTË SEJFI?.....	74
VARGU I PËRCJELLËSVE TË LEGJENDËS SË SEBIVE DHE STISËSIT E SAJ.....	77

KAPITULLI I DYTË.....	78
ABDULLAH IBN SEBE NË MENDIMIN SYNI.....	78
MENDIMI I PROF. DR. TAHA HUSEJNIT.....	81
MENDIMI I PROF. HAMID DAUD ELHANEFIJ.....	92
MENDIMI I DR. ABDUL-AZIJZ ELHILALIJ.....	99
MENDIMI I PROF. AHMED AB'BAS SALIH:.....	100
KAPITULLI I TRETË.....	102
QËNDRIMI I DIJETARËVE SHI'I NDAJ ABDULLAH IBN SEBES.....	102
AUTORËT QË E MOHOJNË EKZISTENCËN E TIJ.....	123
A ËSHTË AMAR IBN JASERI IBN SEUDA?.....	132
KAPITULLI I KATËRT.....	149
SHI'AT DHE EKZAGJERUESIT.....	149
EGZAGJERUESIT DHE EKZAGJERIMI TE SHI'AT.....	149
MBYLLJE.....	157
SUPLEMENTET E LIBRIT.....	161
SUPLEMENTI I PARË.....	162
SEBIJTË.....	162
SUPLEMENTI I DYTË.....	181
NJË HAP NË RRUGËN E AFRIMIT.....	181
NJË HAP NË RRUGËN E AFRIMIT.....	202
SUPLEMENTI I TRETË.....	205
JO, O VËLLEZËRIT TANË NË FE!.....	205
ÇËSHTJA E AFRIMIT.....	208
PROPAGANDA PËR SHI'AT DHE REVOLUCIONI ISLAMIK.....	215
LUFTA DHE XHIHADI.....	220

PYETJE E THJESHTË.....	224
PËRFUNDIM I HABITSHËM.....	225
DOKTRINAT E SHI'AVE.....	229
RUAJTJA DHE MARTESA ME KOHË TË CAKTUAR....	242
NJË KËSHILLË VËLLAZËRORE.....	246
NË LIDHJE ME ARTIKULLIN E TRETË.....	249

اسم الكتاب: عبدالله بن سبأ بين الواقع و الخيال

المؤلف: سيد هادي خسروشاهي

المترجم: الحاج سليم اصطفى (٥)

التدقيق: الحاج ولنت مريا

التصحيح الأدبي: يريدا كولا

التصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

الاخراج النهائي و تصميم الغلاف: صبريه فزا

ناشر: جمعية النسيم - تيرانا - ألبانيا - 2018